

RAPORT

MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË, SI DHE ADMINISTRIMIT
TË DHJETË GJYKATAVE ME NGARKESËN MË TË LARTË NË VEND

PËR PERIUDHËN E MONITORIMIT
DHJETOR 2020 – TETOR 2021



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Hartimi i këtij raporti realizohet në kuadër të nismës “Drejt një efijçence dhe integriteti më të mirë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Përgatiti:

Znj. Blerta Ngucaj, Eksperte Ligjore e Jashtme, KShH
Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH

Kontribuan në hartimin e raportit:

Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Menaxhere Projektesh, KShH
Z. Armand Sokoli, Ekspert Ligjor i Jashtëm, KShH
Znj. Aulona Bode, Eksperte Ligjore e Jashtme, KShH
Z. Emidio Tedeschini, Ekspert Ligjor i Jashtëm, KShH
Z. Erdion Maçolli, Avokat, KShH
Znj. Malvina Dani, Eksperte Ligjore e Jashtme, KShH
Znj. Migena Kondo, Eksperte Ligjore e Jashtme, KShH
Znj. Mirela Bogdani, Eksperte Ligjore e Jashtme, KShH
Znj. Servete Çeka, Juriste/Paraligjore, KShH

Rishikoi:

I. Z. Njazi Jaho, Ekspert Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10,
Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752; Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;
E-mail:office@ahc.org.al;
Web site: www.ahc.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESA	6
HYRJE	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E MONITORIMIT TË 10 GJYKATAVE ME NGARKESËN MË TË LARTË NË VENDIN TONË	14
PJESA E PARË	21
1.1. AKTIVITETI VENDIMMARRËS I KËSHILLAVE	21
1.1.1. Të dhëna sasiore	21
1.1.2 Aktet Nënligjore dhe Rregullatore të Këshillave	22
1.1.3 Aktet Administrative të Këshillave	27
1.1.4 Harta e re Gjyqësore	29
1.1.5 Trajnimet e Magjistratëve	31
1.1.6 Ngritjet në Detyrë	32
1.1.7 Vlerësimi Etiko – Profesional	36
1.1.8 Çështjet Disiplinore	36
1.1.9 Pavarësia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve	38
1.2. TRANSPARENCA	39
1.2.1 Parashikimet ligjore	39
1.2.2 Aksesimi nga Publiku në Faqet e Internetit të Këshillave	39
1.2.3 Arsytimi dhe Publikimi i Vendimeve të Këshillave	41
1.2.4 Transparenca karshi publikut në drejtim të prioriteteve	43

1.3 Parimi i përgjegjshmërisë (Pjesëmarrja, Kuorumi dhe Debati i Brendshëm)	44
1.3.1 Pjesëmarrja e Anëtarëve në Mbledhjet e Këshillave	44
1.3.2 Debati në mbledhje– Indikator i Demokracisë së Brendshme	44
1.3.3 Monitorimi i kuorunit dhe aspekteve të lidhura me premisat e korporatizmit, bazuar në ndasitë midis anëtarëve nga gjyqësori dhe jashtë gjyqësorit në vendimmarrjet e KLGJ-së	46
1.3.3.1 Akte administrative individuale dhe kolektive	46
1.3.3.2 Aktet Normative	52
1.3.3.3 Aktet Rregullatorë	53
1.3.4 Monitorimi i kuorunit dhe aspekteve të lidhura me premisat e korporatizmit, bazuar në ndasitë midis anëtarëve nga prokuroria dhe jashtë prokurorisë, në vendimmarrjet e KLP-së	54

PJESA E DYTË **59**

2.1 ADMINISTRIMI I DHJETË GJYKATAVE ME NGARKESËN MË TË LARTË NË VEND	59
2.1.1 Gjykata e Lartë e RSH	59
2.1.1.1 Vakancat dhe Stoku i dosjeve	59
2.1.1.2 Njësia e Shërbimit Ligjor (NjShL)	60
2.1.1.3 Masat për rritjen e efencës në këtë gjykatë	61
2.1.1.4 Drejtësia pa Vonesa	63
2.1.1.5 Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve	64
2.1.2. Gjykatat e Apelit	65
2.1.2.1. Vakancat dhe Stoku i Dosjeve (përfshi situatën gjatë pandemisë)	65
2.1.2.2 Njësitë e Shërbimit Ligjor (NJSHL)	69

2.1.2.3 Drejtësia pa vonesa	71
2.1.2.4. Masat e tjera për rritjen e eficiencës në këto Gjykata	72
2.1.2.5 Bashkëpunimi i Gjykatave të Apelit me KLGJ-në	76
2.1.2.6 Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve	77
2.1.3. Gjykatat e Shkallës së Parë	77
2.1.3.1. Vakancat dhe Stoku i Dosjeve (përfshi situatën gjatë pandemisë)	78
2.1.3.2 Njësitë e Shërbimit Ligjor	85
2.1.3.3 Masat e tjera për rritjen e eficiencës në këto Gjykata	85
2.1.3.1 Mbledhjet e Përgjithshme të Gjyqtarëve	88
REKOMANDIME KYÇE	90

SHKURTESA

ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
Këshillat	Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
Ligji Nr. 115/ 2016	Ligji Nr. 115/ 2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar
Ligji Nr. 96/ 2016	Ligji Nr. 96/ 2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ligji Nr. 98/ 2016	Ligji Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ligji Nr. 97/2016	Ligji Nr. 97/ 2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ligji Nr. 84/ 2016	Ligji Nr. “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
Ligji nr. 49/2012	“Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative”, i ndryshuar
NJSHL	Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatave
GJKKO Shkalla e Parë	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GJKKO e Apelit	Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GjL	Gjykata e Lartë
Vetting	Ri-vlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve

HYRJE

Në përmbushje të misionit të tij për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe shtetin e së drejtës, që prej miratimit të reformës në sistemin e drejtësisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) vijon të ketë në fokus të veprimtarisë së tij, monitorimin e ngritjes dhe funksionimit të organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë si dhe funksionimin për-kohësisht të institucioneve të sistemit të kaluar të drejtësisë gjatë fazës tranzitore, deri në ngritjen e institucioneve të reja.

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), të njohur ndryshe si Këshillat apo dy nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë përkatësisht të gjyqësorit dhe prokurorisë, u krijuan me një vonesë gati 2 vjeçare, në Dhjetor të vitit 2018. Gjatë periudhës së parë të funksionimit të tyre, Këshillat, kanë patur prioritet rregullimin e veprimtarisë së tyre përmes akteve normative, por edhe përshpejtimin e reformave dhe mbështetjen e gjykatave dhe prokurorive me kapacitete, në kushtet e vakancave të krijuara prej procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (Vetting). Disa nga prioritetet

kyç që rezultojnë të përmbushura janë emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm, plotësimi i 9 nga 19 vakancave në Gjykatën e Lartë, krijimi i SPAK-ut dhe Gjykatave të Posaçme.

Në Ditën Ndërkombëtare Anti-Korrupsion më 15 Dhjetor 2021, ky raport në formatin e tij draft, u bë pjesë e konsultimit në një tryezë teknike me aktorë të sistemit të drejtësisë si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe gjykatave me ngarkesën më të lartë në vend, si dhe partnerë e ekspertë të shoqërisë civile.

Gjithashtu, në funksion të bashkëpunimit konstruktiv reciprok me institucionet e monitoruara, më dt. 23.03.2022, sërisht është përcjellë në rrugë elektronike Raporti i Monitorimit, në formatin draft të tij. Kërkesës elektronike për përcjellje për mendime dhe sugjerime, i është përgjigjur vetëm KLGJ.

Në respektim të parimit të pavarësisë së brendshme dhe të jashtme, KShH ka reflektuar në raport ato komente apo vërejtje të cilat janë vlerësuar relevante nga ekipi hartues i tij. Çdo mendim, qëndrim apo opinion i ndryshëm me to është përgjegjësi e plotë e organizatës zbatuese, KShH-së.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo përmbledhje ekzekutive reflekton vetëm disa nga gjetjet dhe konkluzionet kryesore të monitorimit sistematik të veprimtarisë së Këshillave gjatë periudhës, afro 1 vjeçare, Dhjetor 2020 – Tetor 2021. Në mënyrë të shtjelluar në seksionet respektive të këtij raporti analizohet në përputhje me ligjin, veprimtaria e Këshillave në aspektin material dhe procedural, prioritetet e vendosura nga Këshillat në raport me rekomandimet e dhëna për Shqipërinë nga Komisioni Evropian (në raportin e fundit), si edhe transparenca e Këshillave, duke marrë në konsideratë në vazhdimësi pandeminë Covid-19. Në mënyrë të veçantë, ekspertët ligjorë të angazhuar nga KShH kanë analizuar dhe përpunuar të dhëna kryesisht cilësore, dhe sipas rastit edhe sasiore, duke u fokusuar në aktet nënligjore normative, vendimet, rregulloret, aktet administrative kolektive dhe individuale, procesverbale me shkrim dhe audio, njoftimet, mbledhje plenare të Këshillave.

• Vendimmarrjet e Këshillave

Gjatë periudhës së analizuar, pjesa më e madhe e vendimmarrjes së Këshillave lidhet me miratimin e akteve administrative individuale dhe kolektive, ku tërheqin vëmendjen aktet që kanë të bëjnë me caktimet e përkohshme në detyrë. Kjo është e kuptueshme, duke patur në konsideratë vakancat e krijuara si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar por edhe përfundimit të mandatit të magjistratëve për shkaqe të tjera ligjore, për shmangien e të cilave, Këshillat i janë drejtuar këtyre “zgjidhjeve të shpejta”. Siç do të analizohet në seksionet e mëposhtme, në terma afatgjata, është e nevojshme të identifikohen instrumente ligjorë apo praktikë më të qëndrueshme, në kuptim të efiçencës dhe ekonomisë gjyqësore, por edhe reduktimit të kostove financiare, bazuar në ndryshimet e fundit ligjore.

• Qasje sistematike për plotësimin e kuadrit nënligjor

Këshillat, në bazë të ligjeve të posaçme, kanë detyrimin për të miratuar një sërë aktesh nënligjore, që nuk janë miratuar, siç janë rregulloret e brendshme por edhe rregullat standarte për funksionimin e brendshëm të gjykatave nga ana e KLGJ-së si dhe Kodi Etik, dhe rregullorja për vlerësimin profesional dhe etik të prokurorëve, nga ana e KLP-së. Vlen të përmendet se KLGJ-ja ka patur aktivitet më të lartë normues dhe rregullues në krahasim me KLP-në, e cila gjatë gjithë periudhës së monitorimit ka miratuar vetëm një rregullore.

KShH vlerëson faktin që KLGJ-ja gjatë periudhës së monitorimit ka miratuar Kodin e Etikës Gjyqësore, si edhe i është përgjigjur me efikasitet ndryshimeve në paketën ligjore të reformës në drejtësi, duke ndryshuar një

sërë aktesh nënligjore që lidhen me gjyqtarët si edhe nëpunësit gjyqësorë civilë. Nga ana tjetër, vlerësojmë se KLP duhet të reagojë me prioritet në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore.

Pavarësisht se përparësitë e Këshillave janë sfiduese, KShH vlerëson se hartimi dhe miratimi i të gjitha akteve normative të parashikuara në legjislacionin në fuqi prej të dy Këshillave kërkon një angazhim më sistematik dhe të shtuar, për të kompletuar kornizën ligjore në të cilën ato vepronë, si dhe për të shmangur çdo ekuivok apo paqartësi në përmbushjen e kompetencave të tyre.

• **Bashkëpunimi me shoqërinë civile për hartën e re gjyqësore**

Harta e re e propozuar nga Këshilli gati një vit më parë sjell ndryshime thelbësore në konfigurimin e sistemit, ku duket se propozimi më i guximshëm është ai i të paturit një gjykatë apeli të vetme në rang kombëtar. Më herët, ky propozim ka hasur në kundërshtinë edhe nga ana e Ministrisë së Drejtësisë¹. KShH ka reaguar publikisht duke vendosur theksin tek fakti se përparësi në organizimin e ri të gjykatave duhet të ketë aksesin efektiv i qytetarëve, i cili përbën një objektiv kyç të reformës në drejtësi. KShH vëren se për këtë proces, KLGJ nuk ka reflektuar një qasje të hapur, transparente si dhe bashkëpunimi efektiv me organizatat e shoqërisë civile. Prej kohësh, KShH ka sugjeruar marrjen e masave nga ana e KLGJ-së dhe MD për përfshirjen e grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në procesin e konsultimit në një fazë sa më të hershme të procesit hartues, me qëllim shmangien e një procesi formal konsultimi dhe garantimin e ofrimit të mendimeve/sugjerimeve cilësore që mund të përmirësojnë dhe konsolidojnë hartën e re gjyqësore. Duke qenë se sesione informuese dhe konsultuese janë ndërmarrë me grupet e interesit, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe disa organizata të shoqërisë civile, përfshirë KShH-në, duke i qëndruar opionencës dhe rekomandimeve të bëra publike²³, kemi vërejtur mungesë transparence prej KLGJ-së, për të publikuar një material përmbledhës që reflekton komentet/sugjerimet e marra në konsideratë në mënyrë të plotë, të pjesshme dhe ato të refuzuara.

1 <https://gazetasi.al/harta-e-re-gjyqesore-per-plas-ministrine-e-drejtise-dhe-klgj-ne/>
<https://www.balkanweb.com/mosdakordesite-me-klgj-per-harten-e-re-e-gjyqesorit-gjonaj-reduktimi-i-gjykatave-per-momentin-nuk-eshte-i-vlefshem-do-vijjme-konsultimet-per-variantin-me-te-mire/>

2 <https://ahc.org.al/deklarate-publike-oponence-ndaj-propozimeve-per-harten-e-re-gjyqesore-per-shqiperine/>

3 Nga informacioni i përcjellë nga KLGJ, nëpërmjet shkresës nr. 2145 prot., dt. 08.04.2022, bëhet me dije se: "KLGJ ne bashkëpunim me MD perfunduan me 11 Mars 2022, ciklin e konsultimeve publike mbi propozimin per Harten e Re Gjyqesore. Ky cikël prej 8 takimesh konsultative u zhvillua gjate periudhes janar-mars 2022 dhe konsistoi ne 6 konsultime me grupet e interesit qe ushtrone veprimtarine e tyre ne juridiksionet e gjykatave te apelit Vlore, Gjirokastr, Korce, Durres, Shkoder dhe Tirane, si dhe 2 takime me perfaqesues te shoqerise civile dhe komunitetit te biznesit. Ne keto takime moren pjese perfaqesues nga dhomat vendore te avokatisë, perfaqesues nga Prokuroria e Pergjithshme, gjyqtare dhe nenpunes civile gjyqesore. Nisur nga interesi i larte i organizatave te shoqerise civile dhe i komunitetit te biznesit, KLGJ-ja dhe Ministria e Drejtësisë organizuan edhe 2 konsultime te tjera, respektivisht me keto grupe, per te pasur nje tablo te plote mbi opinionet, sugjerimet e rekomandimet e tyre."

KShH i ka sugjeruar KLGJ-së të bëjë publik në faqen zyrtare të tij, proces-verbalet e transkriptuara të diskutimeve të grupit të punës për hartën e re gjyqësore dhe dokumenteve apo drafteve të diskutuara në çdo mbledhje, por ky rekomandim nuk ka gjetur reflektim edhe pse grupi i punës është mbledhur afro 10 herë, për një periudhë tre vjeçare.

• Vakancat në sistemin gjyqësor

Deri më dt. 4 Nëntor 2021, në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor në vendin tonë, janë gjithsej 76 vende vakante.⁴ Në lidhje me plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë, aktualisht rezultojnë 5 vende vakante në këtë Gjykatë. KLGJ-ja ka hedhur disa hapa të rëndësishëm në plotësimin e pjesshëm të tyre, megjithatë Këshilli inkurajohet të ndërmarrë hapa të tjerë më pro aktiv në plotësimin e të gjithë vakancave të Gjykatës së Lartë⁵. Kjo gjykatë ka ende një numër shumë të lartë çështjesh për t'u evaduar dhe emërimi i çdo gjyqtari, në secilën nga kolegjet e saj do të sillte një ndryshim të prekshëm në funksionimin e kësaj gjykate.

Vlen të përmendet se gjatë periudhës objekt monitorimi ende nuk është plotësuar kuorumi kushtetues i numrit të gjyqtarëve pranë kësaj gjykate, për propozimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Një nga prioritetet e punës së KLGJ-së për vitin 2021 është përfundimi i plotësimin të organikës së apeleve me 35 gjyqtarë dhe të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore me 32 gjyqtarë. Në lidhje me vakancat në këto gjykata, KShH ri konfirmon qëndrimin se nevojitet një koordinim dhe bashkëpunim reciprok më i mirë midis Këshillave dhe institucioneve të vettingut, si edhe mbajtja e një linje të unifikuar dhe harmonizuar nga ana e tyre në lidhje me ngritjen e magistratëve në detyrë, për sa i përket procesit të rivlerësimit kalimtar. KLGJ rezulton se ka ngritur në detyrë magistratët, bazuar mbi kalimin me sukses dhe me formë të prerë të këtij procesi, ndërsa KLP-ja ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm. KShH vëren se Këshillat kanë reflektuar pozitivisht lidhur me rekomandimin e adresuar më herët mbi domosdoshmërinë e mbajtjes së mbledhjeve të përbashkëta mes tyre, ku takimi më i fundit rezultoi i mbajtur më 1 Nëntor 2021, në bashkëpunim me ILD dhe drejtuesin e institucioneve të vettingut, gjatë të cilit është diskutuar mbi procedimet disiplinore të magistratëve. Me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për konsultimin dhe konsolidimin e qëndrimeve të ndryshme, KShH rekomandon ndërmarrjen e takimeve të përbashkëta mbi baza periodike.

Për shkak të dorëheqjeve apo shkarkimeve në kuadër të procesit të vettingut dhe emërimeve në Gjykatën e Lartë, gjatë periudhës objekt moni-

⁴ Sipas të dhënave të referuara nga KLGJ.

⁵ Plotësimi i vakancave të Gjykatës së Lartë, është edhe një nga rekomandimet e dhëna nga Komisioni European në Raportin e fundit për Shqipërinë të miratuar në tetor të këtij viti.

torimi, Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJKKO) për të dyja shkallët e gjyimit numëron 14 vende vakante, përkatësisht 6 gjyqtarë ushtrojnë funksionin pranë kësaj Gjykate nga 11 që parashikon ligji dhe 7 gjyqtarë pranë instancës së shkallës së parë nga 16 që parashikon ligji. Tre prej gjyqtarëve pranë GJKKO-së në shkallë të parë janë të caktuar nga skema e delegimit, ndërkohë që pranë GJKKO-së së Apelit aktualisht janë emëruar 2 gjyqtarë nga KLGJ. Vlen të theksohet se, GJKKO si pjesë e institucioneve të specializuara kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ka nevojë të plotësohet me të gjithë numrin e nevojshëm të gjyqtarëve, pasi numri i hetimeve në këtë fushë nga prokuroria e posaçme është voluminoz. KShH vëren se KLGJ ka qenë aktive në nxitjen e gjyqtarëve për të qenë pjesë e këtyre gjykatave, por ka munguar interesi i prituri për aplikime. Nisur nga kjo situatë, në të ardhmen duhen konsideruar strategji më efektive dhe të bashkë koordinuara me institucione të tjera të reja të sistemit të drejtësisë, me qëllim plotësimin e vakancave. Një element tjetër që ka vështirësuar emërimin e kandidatëve që kanë shprehur interes është fakti që ata nuk kanë përfunduar procesin e vettingut me vendim të formës së prerë.

• Vakancat në sistemin e prokurorisë

Vakancat në magjistratët prokurorë kanë prekur edhe sistemin e prokurorisë në vendin tonë. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga KLP, rezultoi se 57 vende vakante numërohen në të gjitha shkallët e prokurorisë, 6 prej të cilëve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, 5 pranë SPAK, 6 pranë Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit dhe numrin më të lartë e konstatojmë pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore përkatësisht 40.

Deri në fund të periudhës objekt monitorimi rezultoi se 151 prokurorë i janë nënshtruar procesit të vettingut, gjatë të cilit 40 prej tyre janë shkarkuar, 40 pezulluar dhe vetëm 71 janë konfirmuar. Duke qenë se vettingut pritet t'i nënshtrohen edhe 174 prokurorë, si dhe duke marrë parasysh faktin se numri i vakancave është më i lartë në këtë sistem në raport me sistemin gjyqësor, KShH sugjeron marrjen e masave paraprake nga KLP-së për zhbllokimin e ngërçit që mund të vijë si rrjedhojë e rritjes së numrit të vakancave.

• Procedimet Disiplinore

Gjatë periudhës së monitorimit është për t'u vlerësuar që Këshillat kanë vepruar bazuar në parashikimet e ligjit në lidhje me çështjet disiplinore të trajtuara. Po ashtu është konstatuar me shqetësim se ka vendime në lidhje me procese disiplinore me impakt domethënës në publik, të cilat nuk mund të aksesohen në faqen e internetit të KLGJ-së. Në vlerësimin tonë, KLGJ duhet të tregojë kujdes maksimal ndaj transparencës karshi

publikut lidhur me këto vendime dhe procesverbaleve të transkriptuara të mbledhjeve për procedimet disiplinore. Gjithashtu, KShH vëren se ka nevojë të unifikohet standarti që secili prej Këshillave ka patur, lidhur me procedimet disiplinore ndaj magjistratëve që nuk e kanë kaluar ende procesin e vettingut.

- **Reagimet publike të Këshillave për mbrojtjen e pavarësisë së sistemit**

KLP-ja ka qenë më aktive në mbrojtje të figurës dhe integritetit të prokurorëve, duke reaguar në kohë, në krahasim me KLGJ-në, e cila duhet të jetë më aktive në lidhje me deklaratat politike publike për proceset disiplinore të gjyqtarëve, aq më tepër kur bëhet fjalë për deklarata që vijnë nga përfaqësues të pushtetit ekzekutiv.

- **Transparenca ndaj publikut**

Këshillat përmes faqeve zyrtare të internetit kanë ofruar informacion të strukturuar dhe përgjithësisht të përditësuar. Megjithatë, përpjekjet më të menjshme nevojiten që ky informacion të përpunohet me kujdes me qëllim që të kuptohet më mirë nga publiku i gjerë. KShH vëren se KLGJ respekton detyrimin e saj për publikimin brenda 24 orëve të regjistrimit audio të mbledhjes plenare⁶. Nga ana tjetër, KLGJ-ja duhet të vijojë përmirësimin e disa aspekteve të transparencës me publikun, duke njoftuar në kohë mbledhjet e saj, si edhe duke miratuar dhe publikuar në raport me aktualitetin procesverbale të përkatëse, të cilat reflektojnë përmbledhje të diskutimeve të mbajtura nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Vlen të theksohet në këtë raport, shqetësimi i ngritur në disa raste nga BIRN Shqipëri, për zhvillimin me dyer të mbyllura të disa prej mbledhjeve të KLGJ-së. Lidhur me këtë qëndrim të KLGJ-së, në referim të Nenit 69(2) dhe 69(3) të Ligjit Nr. 115/2016, nuk rezulton që ligjvënësi të ketë parashikuar ndonjë rast përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm i publikimit të regjistrimeve audio dhe procesverbaleve të mbledhjeve. Pavarësisht se KLGJ është përpjekur të garantojë mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe atij personal të personave në fjalë, duket se mbrojtja dhe garantimi i transparencës në këtë rast është një parim mbizotëruar. Në mungesë të parashikimeve të ligjit konkret për përjashtime nga publikimi i regjistrimeve audio dhe procesverbaleve të mbledhjeve, KShH vëren se KLGJ ka bazuar këtë vendimmarrje duke iu referuar një *lex generali*, dhe jo një *lex specialis*, si Ligji Nr. 115/2016.

6 Në këtë publikim audio përfshihen edhe emrat e anetarëve të Këshillit të cilët kanë qenë të pranishëm në mbledhje dhe që kanë votuar, pro ose kundër.

• **Prioritetet Strategjike**

KLP-ja ka publikuar prioritetet e saj përmes Planit Strategjik për periudhën 2021 – 2024, ndërsa KLGJ-ja nuk e ka finalizuar dhe as publikuar ende këtë dokument gjatë periudhës objekt monitorimi. KLGJ ka shpalosur objektivat kyç të tij për t'u përmbushur gjatë vitit 2021, në raportimin vjetor që ka patur në Kuvend në seancë plenare, në muajin qershor të të njëjtit vit. KShH sugjeron që këto objektiva të përpunohen më tej dhe të plotësohen në një hark më të gjatë kohor, duke u shpalosur në planin strategjik 2 ose 3 vjeçar të Këshillit. Kjo do të kontribuonte në drejtim të ndjekjes sistematike të prioritetëve si dhe transparencës që Këshilli duhet të ketë ndaj publikut dhe aktorëve të interesuar për objektivat strategjike të kësaj periudhe.

• **Transparenca e veprimtarisë së Komisioneve të Përhershme të Këshillave**

Gjatë periudhës së monitorimit, KShH ka konstatuar se KLGJ ka publikuar raportimin e aktiviteteve të Komisioneve të përhershme, ndërsa nga KLP-ja mungon ky publikim. Gjithashtu, të dy Këshillat duhet të publikojnë në mënyrë më të qartë dhe të strukturuar në rubrika të posaçme, aktivitetin dhe vendimmarrjet e Komisioneve të Përhershme në faqet e tyre zyrtare. Kjo do të ndihmonte publikun dhe aktorët e interesuar për të kuptuar dhe analizuar veprimtarinë konkrete të secilit komision, nivelin e diskutimit si dhe efikasitetin e tyre.

• **Demokracia e brendshme, vendimmarrjet dhe transparenca e Këshillave**

KShH vlerëson se debati i larmishëm dhe konstruktiv kontribuon pozitivisht në drejtim të demokracisë së brendshme të Këshillave, sidomos në diskutimin e çështjeve me rëndësi, siç janë ngritjet në detyrë. Ndërhyrjeve pa mikrofon nga anëtarët (në raste të caktuara) përgjatë mbledhjeve të Këshillave duhet t'i jepet fund dhe nëse është nevoja të propozohet fillimi i procedimit disiplinor në rast të përsëritjeve. Nga procesverbalet audio, rezulton se terminologjia e përdorur nga anëtarët ka qenë e kuptueshme nga media dhe publiku. KShH vëren se në mbledhjet e KLP-së ka më shumë debat të brendshëm në krahasim me KLGJ-në.

Gjatë periudhës së monitorimit, mbledhjet e Këshillave janë mbajtur në praninë fizike të anëtarëve apo virtualisht, si edhe në kombinim të këtyre dy mënyrave. Sa i përket publikimit të vendimmarrjeve, në analizë të monitorimit online të faqes zyrtare të KLGJ-së rezulton se në ndryshim nga mënyra e reflektimit të vendimmarrjeve nga KLP, në faqen zyrtare pasqyrohen të kategorizuara vendimmarrjet sipas nenit 97 të ligjit nr. 115/2016,

në akte administrative kolektive, individuale, akte normative nënligjore, si dhe akte për miratimin e rregullave të brendshme etj. KShH i rekomandon KLP të ndjekë të njëjtën praktikë pozitive si KLGJ, në publikimin e vendimmarrjeve të kategorizuara, përkatësisht në këtë rast vendimmarrje të disponuara në mbledhje plenare dhe në komisione. Gjithashtu, nga faqja zyrtare e KLP-së është e vështirë që të evidentohen se cilat nga aktet administrative janë të natyrës kolektive, akte për miratimin e brendshëm të rregullave procedurale dhe udhëzime jodetyruese.

Në dallim nga praktika e ndjekur nga ana e KLP-së, KLGJ nuk ka publikuar në faqen e tij zyrtare vendimmarrje të nënshkruar nga anëtarët. KShH vlerëson se në kuadër të transparencës për publikun e gjerë kjo formë publikimi nuk ofron akses efektiv në informacionin zyrtar. Për të kuptuar mënyrën e votimit të secilit anëtar, publiku duhet të lexojë përmbajtjen e procesverbalit të seancës plenare, proces i cili merr shumë kohë, duke krijuar barriera në drejtim të aksesit⁷.

Referuar nenit 66/9 të ligjit nr. 115/2016, KShH ka konstatuar se në asnjë prej procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillave nuk është evidentuar opinioni i anëtarit në pakicë. Pavarësisht se dispozita e sipërpërmendur lë në diskrecionin e anëtarit në pakicë hartimin e opinionit kundër për t'ja bashkëlidhur vendimmarrjes përkatëse, KShH vlerëson se mospublikimi i tyre është tregues që vështirëson transparencën ndaj publikut.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E MONITORIMIT TË 10 GJYKATAVE ME NGARKESËN MË TË LARTË NË VENDIN TONË

• Aksesit në drejtësi dhe vonesat në proceset gjyqësore

Referuar raportit të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, kohëzgjatja mesatare për një çështje në nivelin e apelit është 998 ditë për çështjet penale (ose afro 3 vjet), dhe 1742 ditë për çështjet civile (afro 5 vjet). Nisur nga shqetësimet që avokatët ngrenë në mënyrë të vazhdueshme në media për vonesat e gjykimit në apel, është e rëndësishme të ndërmerret një analizë e kujdesshme statistikore dhe cilësore e çështjeve që janë në proces gjykimi ose listë pritje deri në fund të këtij viti, për të ri-vlerësuar impaktin e të gjithë kësaj situatë e drejta për akses në drejtësi dhe drejtësi pa vonesa. Kjo do të kërkonte një bashkëpunim të mirë-koordinuar midis institucioneve të sistemit të drejtësisë për të vlerësuar mënyrat alternative që mund të zhblllokojnë disi këtë situatë, të cilat jo detyrimisht mund të sjellin ndryshime në legjislacion.

⁷ Ndërkohë që publikimi i emrave të anëtarëve të Këshillit vlerësohet i domosdoshëm në përmbajtjen e procesverbalit, është e paqartë përse emrat dhe nënshkrimet respektive nuk reflektohen në vendimmarrjet e publikuara.

• Monitorimi i 10 gjykatave me ngarkesën më të lartë në vend

Duke iu referuar disa nga kompetencave që KLGJ ka të parashikuara në nenet 88 e në vijim të ligjit nr.115/2016, KSHH identifikoi gjithashtu nevojën për monitorimin e 10 Gjykatave me ngarkesën më të lartë në vend⁸. Ky monitorim u realizua sipas një metodologjie të hartuar specifikisht për këtë qëllim, duke siguruar informacionin me anë të shkresave zyrtare drejtuar këtyre gjykatave. Informacioni dhe dokumentacioni i vendosur në dispozicion i është nënshtruar një analize ligjore, konform legjisllacionit në fuqi dhe standarteve të njohura të aksesit në drejtësi.

• Bashkëpunimi midis KLGJ dhe Gjykatave

Bashkëpunimi i Gjykatave me KLGJ-në vlerësohet nga to si shumë i mirë. Megjithatë, KSHH ka identifikuar momente ku bashkëpunimi mes KLGJ-së dhe gjykatave mund të ishte më eficient, si në rastin e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila është drejtuar KLGJ me kërkesë për delegim gjyqtarësh, por ende pas 9 muajsh nuk ka marrë përgjigje.

• Tre problematikat Kyc

Vakancat e gjyqtarëve reflektojnë problematikën më të madhe në funksionimin normal të gjykatave të monitoruara. Kjo situatë sjell pamundësi për respektimin e afateve të arsyeshme në gjykimin e çështjeve, duke krijuar vonesa të konsiderueshme në dhënien e drejtësisë. Gjithashtu, një problem tjetër i konstatuar ka të bëjë me mungesën e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të çështjeve, për hedhjen, administrimin dhe përpunimin e statistikave që mundësojnë një vlerësim më impaktues të ngarkesës së gjykatave dhe gjyqtarëve. Nevoja për të patur pozicionin e këshilltarit në gjykatat e shkallës së parë si dhe trajnimi dhe kualifikimi vazhdues i këshilltarëve pranë gjykatave të apelit, mund të kontribuonte pozitivisht në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe zvogëlimit të stokut të dosjeve (*backlog*) të këtyre gjykatave.

• Gjykata e Lartë

Sipas kësaj gjykate, respektimi i afateve të arsyeshme, nuk është e mundur të garantohet në situatën aktuale në të cilën ndodhet GjL⁹. Deri më datë 31.10.2021 kjo Gjykatë ka raportuar një numër prej 36,140 (tri-

8 Përkatesisht Gjykatës së Lartë, Gjykatave të Apelit, Tiranë, Durrës, Shkodër të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe Gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë, Elbasan dhe Shkodër të juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës

9 Në Gjykatën e Lartë, gjatë periudhës së monitorimit nga KSHH kanë ushtruar detyrën 9 gjyqtarë nga 19 gjyqtarë që duhet të ketë trupa gjyqësore, duke rritur kohëzgjatjen e çështjeve që presin të gjykoen.

dhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet) çështjesh në pritje për t'u gjykuar. Plotësimi i çdo vakance në GjL do sillte një impakt pozitiv në rritjen e ritmeve për evadimin e çështjeve dhe eficiencën e kësaj gjykate.

Megjithatë, vlen të përmendet si nga Gjykata e Lartë dhe nga KLGJ rezultojnë të jenë marrë disa masa të cilat kanë kontribuar pozitivisht në përshejtimin e shqyrtimit dhe gjykimit të çështjeve, tashmë të evaduara, duke maksimizuar përdorimin e burimeve njerëzore dhe shtimin e ndihmësive ligjore apo personelit administrativ.

• Vakancat në Gjykatat e Apelit dhe efektet në ngarkesën e tyre

Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit, janë gjykatat të cilat për shkak të ngarkesës, referojnë se e kanë të pamundur respektimin e afateve të arsyeshme ligjore për gjykimin e çështjeve. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata dhe Apelit Durrës nuk reflektojnë shqetësime në këtë drejtim. Shqetësues është fakti që Gjykata Administrative e Apelit aktualisht është duke shqyrtuar çështjet gjyqësore të regjistruara pranë gjykatës në vitin 2016, pra më shumë se 4 vite më parë. Kjo gjykatë reflekton gjithashtu shqetësimin e mungesës së të dhënave të përpunuara, për shkak të periudhës së shkurtër kohore nga miratimi i tyre. Në Gjykatën e Apelit Tiranë (juridiksioni i përgjithshëm) rezulton se janë duke u gjykuar çështjet e vitit 2017, pra më shumë se 4 vite më parë, me përjashtim të çështjeve të natyrës urgjente.

Në gjykatat e apelit objekt monitorimi, nga pikëpamja statistikore rezultojnë se i janë nënshtruar vettingut me vendim të formës së prerë duke kaluar me sukses këtë proces, rreth 30% të numrit të gjyqtarëve. Ndërkohë, vakancat e krijuara për shkak të dorëheqjeve, shkarkimeve, pezullimeve apo shkaqe të tjera të ndërprerjes apo pushimit të statusit të magjistratëve janë të konsiderueshme. Të dhënat e vendosura në dispozicion nga vetë gjykatat e apelit, objekt monitorimi, deri në Tetor të 2021-ëshit reflektojnë këtë situatë:

Gjykata e Apelit Shkodër ka patur 10 gjyqtarë, ndërkohë që kanë kaluar procesin e vettingut me vendim përfundimtar vetëm 4 gjyqtarë.

Gjykata e Apelit Durrës ka në organikë 13 gjyqtarë, por 5 vende janë vakante. Nga 8 gjyqtarë, rezulton se kaluar procesin e vettingut me vendim të formës së prerë vetëm 1 gjyqtar.

Gjykata e Apelit Tiranë ka një organikë të miratuar prej 31 gjyqtarësh. Rezulton se kanë kaluar procesin e vettingut me vendim të formës së prerë 6 gjyqtarë.

Gjykata Administrative e Apelit ka në organikën e saj të miratuar 13 gjyqtarë. Rezulton se kanë kaluar vettingun me vendim të formës së prerë 4 gjyqtarë.

• Vonesat në gjykime për shkak të pandemisë

Situata e krijuar nga pandemia e Covid-19, rezulton se ka pasur gjithashtu ndikim negativ në drejtim të stokut të çështjeve dhe vonesave në proceset gjyqësore, kryesisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër. Nga gjykatat e monitoruara të apelit, vetëm Gjykata e Apelit Shkodër ka përcjellë të dhëna statistiko-re, e cila referon se gjatë pandemisë është përballur me rritjen e stokut të çështjeve, të cilat kanë arritur në shifrën 1852 çështje, ndërkohë gjykatat e tjera nuk kanë mbajtur të dhëna/evidenca statistikore gjatë pandemisë, të cilat mund të ndikojnë pozitivisht në hartimin e studimeve dhe analizave mbi menaxhimin e risqeve që mund të shkaktohen nga situata epidemike të ngjashme në të ardhmen.

Vlen të përmendet si standart pozitiv, ai i Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan, pranë të cilës janë krijuar salla të gjykimeve online që kanë kontribuar pozitivisht në mos ndërprerjen e proceseve gjyqësore dhe respektimin e afateve.

• Nevoja për një sistemi elektronik me standarte të unifikuara dhe bashkëkohore të teknologjisë së informacionit

Sipas nenit 289, pika 5 të ligjit nr.115/2016, Këshilli i Ministrave nuk rezulton të ketë respektuar afatin 6 mujor që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë. VKM¹⁰ përkatëse është miratuar në 2 Dhjetor të vitit 2020, afro 4 vite nga hyrja në fuqi e ligjit nr.115/2016, ose 2 vjet nga ngritja e KLGJ-së. Kjo vonesë është e pajustificuar, në kushtet dhe sfidat me të cilat janë përballur gjykatat në vendin tonë. Krijimi i Qendrës rezulton të jetë bërë në dt. 19.10.2021, që përkon edhe me takimin e parë të Bordit të saj Drejtues.

Në nenin 92 të ligjit nr.115/2016 parashikohen disa detyrime të lidhura me sistemin elektronik të teknologjisë së informacionit, ngarkuar specifikisht ndaj Këshillit të Ministrave dhe KLGJ-së. KShH mbështet nevojën e identifikuar nga KLGJ për një sistem të ri të menaxhimit të çështjeve, i cili do të kontribuojë për rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore ndaj publikut. Ndërtimi dhe vënia në zbatim e këtij sistemi duhet të shoqërohet me alokimin e buxhetit të nevojshëm financiar nga Këshilli i Ministrave.

10 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë"

• **Impakti dhe sfidat e ndryshimeve të reja ligjore që synuan rritjen e efikasitetit gjyqësor**

Me qëllim rritjen e efikasitetit gjyqësor, rezultoi se në dt.31 Mars 2021 janë bërë shtesa dhe ndryshime me anën e ligjit nr.46/2021 në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për gjykimin e një kategorie çështjesh me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar. Të dhënat e monitorimit evidentojnë se këto parashikime nuk rezultojnë të zbatohen në mënyrë të njëjlojtë nga gjykatat e monitoruara.

Kështu, Gjykata e Apelit Administrativ evidenton si të nevojshme miratimin e ndryshimeve të tjera, të cilat do të bëjnë të mundur gjykimin e çështjeve me një gjyqtar të vetëm, kjo duke u reflektuar në parashikimet e ligjit 49/2012. I njëjti konstatim vlen edhe për gjykatat e shkallës së parë. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës nuk ka pasur raste të tilla, ndërkohë që Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka gjykuar me trup gjykues të përbërë me një ose tre gjyqtarë. Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan referon se, pavarësisht respektimit të parashikimeve të reja procedurale, nuk ka pasur asnjë impakt pozitiv, për shkak të uljes së menjëhershme të numrit të gjyqtarëve pranë saj, si rrjedhojë kryesisht e vettingut.

Gjykatat vlerësojnë legjislacionin e ri të sistemit të drejtësisë dhe tregohen të hapura për ndryshime të tjera ligjore, ndërkohë që KSHH vëren një qasje hezituese ose pasive në identifikimin e problematikave specifike dhe mjetet ligjore procedurale me të cilat mund të ndërhyhet në aspektin e ndryshimeve ligjore që mund të rrisin efikasitetin dhe administrimin gjyqësor.

• **Aktivizimi i organit të “Mbledhjes së Gjyqtarëve” dhe formalizimi i regjistrimeve audio dhe procesverbaleve**

Referuar nenit 40 të ligjit nr.98/2016, një organ i rëndësishëm i administrimit gjyqësor të secilës gjykatë në vendin tonë është mbledhja e gjyqtarëve të saj. Të dhënat e përcjella, evidentojnë se ky organ nuk mbledhet rregullisht. Konkretisht, Gjykata e Apelit Durrës nuk ka mbajtur rregullisht mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve¹¹. Gjykata e Apelit Tiranë, referon se mbledhjet e kësaj gjykate zhvillohen shpesh, për problematika të ndryshme por dokumentacioni i tyre nuk është i formalizuar, çka bie ndesh me nenin 29/1 të ligjit nr.98/2016¹². Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Apelit Shkodër referojnë se mbledhjet i mbajnë rregullisht. Të njëjtin qëndrim kanë edhe tre Gjykatat

11 Ato janë mbajtur në janar të vitit 2019 dhe në muajin shtator të vitit 2021.

12 Sipas të cilit “Regjistrimi audio dhe procesverbali i mbledhjes i zbardhur ruhet për të paktën dhjetë vjet dhe i vihet në dispozicion gjyqtarëve të gjykatës, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

e Shkallës së Parë që i janë përgjigjur kërkesës zyrtare për informacion. Megjithatë vlen të theksohet se për të arritur në një konkluzion më të saktë në raport me detyrimet që imponojnë nenet 29/1 dhe 40 të ligjit nr.98/2016, kërkohet një monitorim më sistematik nëse janë mbajtur regjistrimet audio dhe procesverballi i zbardhur i këtyre mbledhjeve, të cilat në shumicën e rasteve nuk janë vendosur në dispozicion të KShH-së.

• Ngritja e Njësive të Shërbimit Ligjor dhe plotësimi i organikës së ndihmësve ligjorë pranë Gjykatave të Apelit

Njësia e Shërbimit Ligjor nuk rezulton të jetë ngritur pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, ndërkohë që organika e ndihmësve ligjorë pranë gjykatave të tjera rezulton me vakanca të konsiderueshme, përafërsisht në më pak se gjysmën e tyre¹³. Në total, Gjykatat e Apelit të monitoruara reflektojnë një numër prej 14 ndihmësish ligjorë, ose gjysmën nga 26 të tillë që duhet të kishte sipas organikës. Plotësimi i vakancave për pozicionin e ndihmësve ligjorë, shtimi i numrit të tyre si dhe rritja e efikasitetit, vijon si rekomandime të vetë gjykatave të monitoruara. Sipas tyre, kjo do të kontribuonte pozitivisht në uljen e ngarkesës, me të cilën po përballen gjyqtarët në detyrë në këto gjykata. Për të rritur efikasitetin e ndihmësve ligjorë, nevojiten trajnime sistematike dhe kualifikime vazhduese. Referuar komunikimit zyrtar me gjykatat vërehen vonesa sa i përket trajnimeve vazhduese të nëpunësve civil të shërbimit gjyqësor nga ana e KLGJ.

• Vakancat në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe efektet në ngarkesën e tyre

Të dhënat statistikore të vendosura në dispozicion mbi numrin e çështjeve të stokut (backlog), evidentojnë për periudhën 2019 – 2021 një trend zbritës në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër¹⁴. Një trend rritjeje e stokut raportohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Megjithatë, të dhënat e vendosura në dispozicion prej tyre nuk paraqesin të njëjtin standard përpunimi në raport me gjykatën e Shkodrës.

Sa i takon vakancave të krijuara nga procesi i vettingut, të dhënat e vendosura në dispozicion nga vetë gjykatat e shkallës së parë, objekt monitorimi, deri në Tetor të vitit 2021 evidentojnë se:

13 Gjatë periudhës 2020-2021, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (juridiksioni i zakonshëm) janë emëruar përkohësisht 10 ndihmës ligjorë, nga 15 ndihmës që duhet të ketë kjo gjykatë. Gjykata e Apelit Durrës ka efektivisht 3 nga 6 ndihmës ligjorë që duhet të kishte sipas organikës. Gjykata e Apelit Shkodër ka 1 nga 5 ndihmës që duhet të kishte sipas organikës.

14 Në këtë gjykatë, numri më i lartë i çështjeve në shqyrtim (të papërfunduara) është në vitin 2019 me 1208 çështje, me një numër gjyqtarësh në total 12, ndërkohë që numri më i ulët është për këtë vit (i cili ende nuk ka përfunduar), përkatësisht me 1088 çështje, me një numër gjyqtarësh në total prej 13

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka 6 gjyqtarë që janë në proces vettingu dhe që ushtrojnë aktualisht funksionet e tyre. Pranë kësaj gjykate rezultojnë të pezulluar 4 gjyqtarë si pasojë e shkarkimit nga vetting në shkallë të parë, ndërkohë që 2 gjyqtarë janë dorëhequr.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës rezulton se kaluar procesin e vettingut 1 gjyqtar me vendim përfundimtar. Dy gjyqtarë të tjerë janë dorëhequr dhe 1 gjyqtar rezulton se nuk e ka kaluar vettingun në shkallë të parë dhe është në proces ankimi në KPA (me efekt pezullim). Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se kryetari i Gjykatës është shkarkuar me vendim të formës së prerë, 2 gjyqtarë të tjerë janë shkarkuar me vendim të shkallës së parë dhe janë në proces ankimi në KPA si dhe kanë kaluar procesin e vettingut 2 gjyqtarë.

• Mungesa e njësive të shërbimit ligjor dhe ndihmësve ligjorë në Gjykatat e Shkallës së Parë

Të dhënat zyrtare evidentojnë se nuk është krijuar Njësi e Shërbimit Ligjor në asnjë prej pesë gjykatave të shkallës së parë që i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion. Ndhimësit ligjorë, prej Dhjetorit të vitit 2020 nuk janë më pjesë e organikës në gjykatat administrative dhe ato të shkallës së parë. Duke mbajtur në konsideratë situatën aktuale me të cilën po përballen gjykatat e shkallës së parë, vakancat e vërejtura në radhët e magjistratëve, por edhe numrin e konsiderueshëm të stokut të çështjeve, KShH sugjeron marrjen e masave konkrete nga ana e KLGJ-së për garantimin e numrit të përshtatshëm të ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë, me synim menaxhimin e mbarëvajtjes së punës së gjykatave, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 46/2021.

• Mbikqyrja e impaktit të trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës

Një aspekt tjetër i monitoruar ka qenë trajnimi vazhdues për gjyqtarët që raportohet se është realizuar kryesisht nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohë që janë zhvilluar seminare dhe trajnime nga KLGJ me kancelarët. Për vitin 2020 evidentohet nga KLGJ, se 61.3% e gjyqtarëve kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës. Gjith, KShH sugjeron krijimin dhe zbatimin e një mekanizmi mentorues për matjen e efektivitetit të këtyre trajnimeve në performancën e gjyqtarëve, pasi ky përbën një nga detyrimet ligjore të ligjit nr.115/2016 që kërkon monitorim dhe raportim publik nga KLGJ.

PJESA E PARË

1.1. AKTIVITETI VENDIMMARRËS I KËSHILLAVE

1.1.1. Të dhëna sasiore

Gjatë periudhës së monitorimit, 1 Dhjetor 2020 – 31 Tetor 2021, në bazë të kategorizimit në përputhje me nenin 7 të ligjit Nr. 115/ 2016, KLGJ-ja ka miratuar në total 566 akte si dhe janë zhvilluar 90 mbledhje plenare, axhenda e të cilave nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të KLGJ-së nuk rezulton se është publikuar para zhvillimit të mbledhjes ashtu si e parashikon ligji¹⁵.

Gjatë së njëjtës periudhë kohore, KLP ka nxjerrë 423 akte si dhe janë zhvilluar 43 mbledhje plenare, agjenda e të cilave nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të KLP-së¹⁶ rezulton se është publikuar para zhvillimit të mbledhjes, konform ligjit.

Po ashtu vlen të citohet se gjatë muajit Gusht 2021, KLGJ-ja ka mbajtur tre seanca plenare më datat 4, 5 dhe 26 Gusht 2021. Nga ana tjetër nuk rezulton që KLP-ja të ketë mbajtur ndonjë mbledhje gjatë muajit Gusht 2021, çka bie ndesh me nenin 164, pika 1 të ligjit Nr. 115/ 2016. Duke qene se Ligji Nr. 97/ 2016 e ngarkon Këshillin me miratimin e një pakete aktesh nënligjore si edhe rregullatore, ky përbën gjithashtu një argument se përse KLP-ja, duhet të respektojë numrin minimal të mbledhjeve të parashikuara në ligj mbi baza mujore, me qëllim që t'i përgjigjet efektivisht nevojave së sistemit të prokurorisë në raport me kompetencat e saj ligjore.

Duket se peshën më të madhe të veprimtarisë së Këshillave e zë miratimi i akteve administrative për t'ju përgjigjur përkohësisht vakancave apo mbingarkesës së sistemit. Për KLGJ-në vëllim të rëndësishëm kanë patur aktet për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. KLGJ ka qenë aktive dhe në vendosjen në funksion të skemës së delegimit, si edhe ka patur vendimmarrje në ngritjet në detyrë për Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apelit dhe GJKKO. Në lidhje me ngritjet në detyrë ka patur dhe vendimmarrje në formën e veprimeve përgatitore. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë kriteret specifike ligjore që duhet të përmbushen nga kandidatët aplikantë për t'ju bashkuar trupave gjyqësore të GJKKO¹⁷, dhe mungesës së dukshme të burimeve njerëzore që ka ardhur si rezultat i

15 Neni 66 pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Në fakt, agjenda e këtyre mbledhjeve ose rendi i ditës lidhur me çështjet që do të trajtohen gjatë mbledhjes komunikohet në fillim të seancës nga ana e Kryetares së Këshillit, znj. Naureda Llagami.

16 <https://klp.al/>

17 Ndryshim i miratuar nëpërmjet ligjit nr. 50/2021 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' të ndryshuar", link: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/03/23/50/be63a008-c9b1-49ec-9425-570e0b1f9105>

procesit vettingut, pavaresisht shpalljes së vazhdueshme të thirrjeve për vende vakante në dy shkallet e gjykatave të posaçme, numri i aplikimeve ka mbetur shumë i ulët¹⁸.

KLGJ ka synuar që të nxisë përfshirjen e magjistratëve nëpërmjet garantimit të një shtese për 'vështirësi në punë' në masën 80% të pagës fillestare për kategorinë e gjyqtarëve të këtyre Gjykatave. Kjo dëshmon përpjekjet sistematike të Këshillit për të zbutur vakancat e krijuara pranë këtyre Gjykatave.

Edhe për vendimmarrjen e KLP-së, peshën kryesore e zënë çështje si caktimet e përkohshme në detyrë të prokurorëve por edhe vendimmarrje në raport me ndërprerjen e mandatit, komandimin, si edhe vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve. Ashtu si edhe në rastin e KLGJ-së, Këshilli ka patur vendimmarrje të formës përgatitore në lidhje me ngritjet në detyrë.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, rezulton që të dy Këshillat nuk kanë marrë vendime emërimi në detyrë të magjistratëve, pavarësisht vakancave shkaktuar nga Vetting-u, mbarimi i statusit apo dorëheqjet e magjistratëve gjyqtarë dhe prokurorë.

1.1.2 Aktet Nënligjore dhe Rregullatore të Këshillave

Miratimi i akteve nënligjore nga ana e Këshillave është një nga detyrimet e ngushtme sipas ligjeve përkatëse të reformës në drejtësi¹⁹. Kështu, neni 155 i ligjit nr. 97/2016, parashikon se KLP-ja harton dhe miraton aktet nënligjore në përputhje me këtë ligj. Ndërkohë, ligji nr. 98/2016, përmes nenit 91.1, i ka vendosur afate konkrete KLGJ-së, për miratimin e të gjitha akteve nënligjore që parashikon ligji në fjalë, jo më vonë se 6 muaj nga krijimi i këtij organi.

Gjatë fazës së konsultimit të realizuar, KLGJ ka bërë me dije se është në dijeni të detyrimit që buron nga legjislacioni në fuqi për miratimin e një sërë aktesh nënligjore, duke theksuar se "në kushtet e pamundësisë për t'i miratuar të gjitha aktet e nevojshme që parashikon ligji për shkak të ngarkesës që ka puna, fakt ky që vihet re nga numri i mbledhjeve plenare dhe reagimeve ndaj nevojave të sistemit në kohë reale, Këshilli ka paracaktuar në planin strategjik 2022-2024, i cili pritet të miratohet brenda muajit maj 2022, se cilat janë prioritetet e tij në këtë periudhë".

KShH vëren se mosmiratimi brenda afateve i akteve nënligjore, përveç se nuk është në pajtim me ligjet e cituara më sipër, sjell gjithashtu problema-

¹⁸ Për shkak të kërkesave ligjore për këto pozicione, KLGJ, gjatë periudhës së monitorimit ka patur vendimmarrje në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

¹⁹ Ligji Nr. 98/ 2016 dhe Ligji Nr. 97/ 2016

tika në drejtim të mirëfunksionimit të Këshillave të cilët veprimtarinë e tyre e bazojnë ndër të tjerash edhe tek aktet nënligjore që dalin bazuar dhe në zbatim të ligjeve. Këto akte detajojnë më tej rregulla të rëndësishme të punës së tyre, por mbi të gjitha për mirë funksionimin e sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë. Kjo vlen veçanërisht për KLP-në, e cila në krahasim me KLGJ ka qenë më pasive në aktivitetin e saj normativ dhe rregullues.

A Këshilli i Lartë Gjyqësor

Gjatë Periudhës së Monitorimit, KLGJ-ja ka miratuar një sërë aktesh nënligjore me rëndësi, nga të cilat mund të përmendim aktet në vijim:

- i. Vendimi nr. 643 datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standarde për organi gramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”

Është e kuptueshme se Këshilli ka filluar zbatimin e kësaj dispozite për shkak të rëndësisë së plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë dhe urgjencës së kthimit të saj në funksionalitet për përballimin e ngarkesës aktuale të çështjeve. Megjithatë, ligji 115/2016 (Neni 91) parashikon se Këshilli duhet të miratojë rregulla të brendshme standarte për funksionimin e brendshëm, cilësinë dhe efijencën për të gjitha gjykatat.

Po ashtu vlen të theksohet se KLGJ-ja nuk ka përfunduar ende hartimin dhe miratimin e rregullores së vet të brendshme, edhe pse Këshilli ka ngritur një komision të përkohshëm për miratimin e kësaj rregulloreje²⁰. Miratimi i këtij dokumenti duhet të jetë prioritet për Këshillin, pasi ky i fundit ushtron veprimtarinë prej gati 3 vitesh pa një prej akteve normuese më të rëndësishëm të tij.

- ii. Vendimi nr. 622 datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”
- iii. Vendimi Nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e “udhëzuesi “për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave”
- iv. Vendimi nr. 17, datë 171, datë 22.04.2021 “Për miratimin e Kodit të Etikës Gjyqësore”

Miratimi i tij përbën një detyrim kushtetues²¹ si edhe ligjor²². Ky akt mbështetet dhe vjen i harmonizuar me standardet ndërkombëtare me të mira, të cilat janë cituar në këtë dokument. Për t’u vlerësuar është fakti se

²⁰ Vendimi Nr.318, datë 19.12.2019

²¹ Neni 147/a pika 1, shkronja ç i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

²² Neni 83/1 i Ligjit 115/2016 dhe Neni 4. 3 i Ligjit 96/2016

rregullat e këtij Kodi shtrihen për sa është e mundur dhe mbi nëpunësit civilë gjyqësorë, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë.

- v. Vendimi nr.193, datë 12.05.2021 Për miratimin e “Metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë”
- vi. Vendimi nr.194, datë 12.05.2021 Për miratimin e “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë”
- vii. Vendimi nr. 214, datë 26.05.2021 “Për miratimin e formës standarde të akteve të vlerësimit të ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë”
- viii. Vendimi nr. 215, datë 26.05.2021 “Për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë”

Vendimet 194, 214 dhe 215, cituar më sipër janë pjesë e skemës së vlerësimit, të cilat zbatohen vetëm për gjyqtarët e komanduar në pozicionin e ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë. Është për t'u vlerësuar që KLGJ-ja është treguar e kujdesshme në plotësimin e skemës së vlerësimit me aktet rregullatorë që e bëjnë të zbatueshëm këtë proces.

Për sa i përket rregullave të brendshme, KLGJ ka miratuar vendimin nr. 176, datë 29.04.2021 për miratimin e “Raportit Vjetor të Sistemit Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020”. KSHH vëren se sipas ndarjes që bën ligji²³, ky raport nuk mund të kategorizohet si akt rregullator i brendshëm procedural, duke qenë vetëm pasqyrim i gjendjes dhe veprimtarisë së Këshillit për një periudhë kohe të caktuar. Gjithashtu, tërheq vëmendjen fakti se pavarësisht se ky vendim për miratimin e këtij raporti gjendet në faqen e internetit të KLGJ-së²⁴, vetë Raporti është publikuar më dt. 25 Qershor 2021²⁵.

Gjatë muajit Korrik 2021, KLGJ ka patur një aktivitet të ngjeshur në lidhje me rregullat e brendshme, në përgjigje të ndryshimeve të miratuara nga Kuvendi në fillim të vitit 2021, në ligjet organike kryesore të reformës në drejtësi. Si rrjedhojë duhet vlerësuar pro aktiviteti i treguar në këtë drejtim për funksionimin sa më efikas të gjykatave. Ndër këto akte, vlen të përmenden:

²³ Neni 97 i Ligjit 115/ 2016

²⁴ <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/04/VENDIM-Nr.-176-dat%C3%AB-29.04.2021-P%C3%8BR-MIRATIMIN-E-%E2%80%9CRAPORTI-VJETOR-I-SISTEMIT-GJYQ%C3%8BSOR-DHE-K%C3%8BSHILLIT-T%C3%8B-LART%C3%8B-GJYQ%C3%8B-SOR-P%C3%8BR-VITIN-2020%E2%80%9D.pdf>

²⁵ Gjatë procesit të konsultimit me shkrim të përbajtjes së draft-raportit të monitorimit, KLGJ ka bërë me dije se raporti gjendet në link: <http://klgj.al/raporti-vjetor-klgj-2020/>

- ix. Vendimi nr. 325, datë 22.07.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 643, datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standarde për organi gramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive punonjësve të Gjykatës së Lartë”²⁶
- x. Vendimi nr. 324, datë 22.07.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor 7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”, është bazuar në ligjin nr. 46/ 2021 që ka ndryshuar nenin 26/3 të ligjit 98/ 2016. Me anë të tij, KLGJ-ja ka reflektuar ndryshimet përkatëse në drejtim të procedurës së zgjedhjes së zëvendëskryetarit të gjykatës.
- xi. Vendimi nr. 323, datë 22.07.2021, „Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor 338, datë 24.09.2020 “Për caktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”²⁷.

A. Raportet Vjetore të Komisioneve të KLGJ-së

Gjatë muajveshkurt, mars dhe prill 2021, KLGJ-ja ka miratuar raportet vjetore mbi veprimtaritë e të katër komisioneve të saj të përhershme, për vitin 2020²⁸. Në bazë të nenit 62 pika 16 të ligjit Nr. 115/2016, raportet në fjalë duhet të paraqiten në mbledhje plenare të Këshillit, brenda muajit Janar të çdo viti kalendarik. Megjithatë vonesa mund të kuptohet nga ngarkesa e lartë dhe problematikat e ndryshme të trajtuara nga Komisionet, respektimi i afateve ligjore është i nevojshëm për t'u përmbushur në vijimësi nga ana e Këshillit.

Nga ana tjetër, është pozitiv fakti se raportet janë të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të Këshillit. Këtu mund të shtojmë se aktiviteti i Komisionit Disiplinor ka qenë disi i vonuar për shkak të kohës së plotësimit të organeve të reja si ILD, si edhe mungesat në kuadrin ligjor, në mënyrë më specifike përmendim impaktin e Vendimit nr. 34, datë 10.04.2017²⁹ i Gjykatës Kushtetuese, i cili shfuqizoi disa dispozita të Ligjit Nr. 96/2016.

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Gjatë periudhës së monitorimit rezultoi se veprimtaria e KLP-së për miratimin e akteve nënligjore dhe rregullatorë është më e ngadaltë, në

26 Ky vendim është miratuar nën prespektivën e ndryshimeve ligjore që erdhën si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligji nr. 46/2021 ndryshoi kriteret ligjore për pozicionin e punës këshilltar ligjor jomagjistrat, të parashikuara nga Vendimi nr. 643, datë 23.12.2020 i KLGJ-së, më saktësisht përvojën profesionale si edhe aftësitë e tjera.

27 Ky vendim vjen po ashtu në përgjigje të ndryshimeve bazuar në Ligjin nr. 46/2021 dhe lidhet me sekretarët gjyqësorë që janë në detyrë dhe nuk kanë arsim të lartë juridik por kanë mbi tre vite eksperiencë pune. Sipas ndryshimeve ligjore këta nëpunës civilë mund të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tyre.

28 Përkatësisht Vendimet nr. 39, datë 04.02.2021, nr. 74, 04.03.2021 dhe 86, 11.03.2021, Nr. 150, datë 08.04.2021

29 https://www.gjk.gov.al/ëeb/Vendime_perfundimtare_100_1.php

krahasim me KLGJ. Konkretisht, KLP ka miratuar vetëm 1 akt nënligjor, përkatësisht:

- i. Vendimin nr. 284, datë 17 Dhjetor 2020 “Për mënyrën e kompensimit për orët shtesë të punës të kryera nga nëpunësit civil të prokurorisë”.

Në Raportin Vjetor të KLP³⁰ përcaktohet se, gjatë vitit 2020 do të finalizohet dhe miratohet edhe rregullorja e rëndësishme e organizimit të brendshëm të Këshillit, e cila do të detajojë procesin vendimmarrës brenda Këshillit por edhe linjat e komunikimit dhe të veprimit administrativ në funksion të realizimit të detyrave dhe objektivave. Nga hulumtimi në faqen zyrtare të internetit të KLP-së, konstatohet se strategjia e komunikimit të këtij institucioni nuk është publikuar³¹, ndërkohë që rregullorja e brendshme u bë publike vetëm gjatë muajit Dhjetor³².

Në prioritetet e Këshillit për vitin 2021 kanë qenë dhe hartimi dhe miratimi i rregullores për ngritjen në detyrë të prokurorëve si edhe rregullores për vlerësimin e punës së prokurorëve, çfarë nuk rezulton të jenë miratuar ende.

Akt tjetër me rëndësi kyç, i munguar në veprimtarinë e KLP-së është Kodi i Etikës. Parashikimet e këtij akti kanë rëndësi sa i takon ushtrimit të kompetencave nga Këshilli, në sferën e vlerësimit etiko – profesional të prokurorëve dhe ato të lidhura me disiplinën për çështjet etike. Vonesa në miratimin e këtij akti, cenon mirë funksionimin e rregullt të organit dhe si rrjedhojë duhet të jenë prioritate absolut për Këshillin në periudhën vijuese.

Duhet shtuar se në faqen e internetit të KLP-së figuron dokumenti Projekt – Plani Strategjik për periudhën 2021 – 2024³³, i cili rezulton të jetë hartuar me ndihmën e misionit EURALIUS, megjithatë në këtë faqe nuk ofrohen shpjegime shtesë.

Raportet Vjetore të Komisioneve të KLP-së

Në ndryshim nga KLGJ, në faqen zyrtare të KLP-së mungojnë raportimet dhe publikimi i akteve që lidhen me 4 Komisionet e përhershme të KLP-së. Ky fakt vendos në pikëpyetje ekzistencën e këtyre raporteve dhe rrjedhimisht edhe përmbushjen e detyrimit ligjor për miratimin e tyre sipas nenit 16 të ligjit Nr. 115/2016.

30 https://klp.al/wp-content/uploads/2020/05/RAPORTI_KUVENDI_VJETOR_WEB.pdf

31 Edhe pse për strategjinë e komunikimit në faqen e Këshillit është publikuar mbajtja e një seminari për prezantimin e saj, mungesa e publikimit të strategjisë së komunikimit vlerësojmë se është element i mungesës së transparencës. <https://klp.al/2020/09/24/keshilli-i-larte-i-prokurorise-pergatit-strategjine-e-komunikimit-2021-2024/>

32 <https://klp.al/category/akte-nenligjore-te-klp/>

33 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/01/Plani-Strategjik-2021-2024.pdf>

1.1.3 Aktet Administrative të Këshillave

Në kushtet e vakancave në sistem si dhe të ngarkesës së çështjeve në disa gjykata dhe prokurori, ashtu siç është theksuar dhe më sipër, vep- rimitaria e Këshillave gjatë Periudhës së Monitorimit ka qenë e përqendru- ar tek miratimi i akteve administrative, kryesisht caktime të përkohshme gjyqarësh për shqyrtimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si edhe caktime të përkohshme prokurorësh.

Neni 15.2 i ligjit 96/2016 me ndryshimet e fundit parashikon se magjistrati në skemën e delegimit, magjistrati i transferuar përkohësisht ose mag- jistrati i caktuar përkohësisht, kur delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se 22 ditë pune, përfiton një kompensim mujore në masën e jo më shumë se 80 % të pagës referuese bazë. Ky parashikim ka shërbyer për të nxitur dhe mo- tivuar magjistratët drejt mobilitetit në mënyrë që të zbuten vakancat e krijuara në sistem.

A. Këshilli i Lartë Gjyqësor

Gjatë Periudhës së Monitorimit, KLGJ ka marrë një sërë vendimesh për caktimin e gjyqarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Numri më i madh i kërkesave për caktim të përkohshëm rezulton të kenë ardhur nga gjykatat e apelit, ku vakancat duket të jenë më shqetësuese (247 kërkesa), ndjekur nga gjykatat e shkallës së parë (155 kërkesa), gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar (35 kërkesa), gjykatat administrative (16 kërkesa). Ndër gjykatat në të cilat ka patur një numër më të lartë gjyqarësh të caktuar përkohësisht rezultojnë Gjykatat e Apelit Korçë, Vlorë dhe Gjirokastër si edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Sipas të dhënave të siguruara në rrugë zyrtare nga KShH³⁴ të përcjella nga KLGJ, rezulton se aktualisht në skemën e delegimit janë 13 magjistratë, të cilët janë të komanduar për një periudhë 1 vjeçare. Gjithashtu, për periu- dhën 1 Prill – 15 Tetor 2021, KLGJ ka transferuar në mënyrë të përkohshme gjithsej 9 magjistratë. Po gjatë kësaj periudhe, 107 magjistratë janë caktu- ar përkohësisht pranë Gjykatave të ndryshme të vendit, për të shqyrtuar në total rreth 524 çështje të veçanta.

Në lidhje me këtë pikë, duhet theksuar se pavarësisht se caktimet e përkohshme janë instrument deri diku efikas për zhbllokimin e situatës së

34 Shkresa nr. 5061/1 Prot. datë 15.11.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor

sistemit, në këndvështrimin e kostove financiare si edhe cilësisë së gjyqimit, nuk mund të shihen si zgjidhje e volitshme dhe e përdorshme, në terma afatmesëm.

Nga ana tjetër duhet përmendur se KLGJ-ja ka aktivizuar skemën e delegimit duke marrë rreth 22 vendime në lidhje me këtë skemë³⁵ si edhe duke vendosur për 3 komandime. Po ashtu Këshilli ka ndërmarë rreth 16 vendimmarrje që lidhen me transferimet e përkohshme³⁶, ashtu sikurse ka patur vendimmarrje për ndërprerjen e transferimit të përkohshëm, komandim gjyqtari në skemën apo caktim të gjyqtarit në skemë delegimi për të gjykuar paralelisht në dy gjykata, me ngarkesë 50% në secilën prej tyre³⁷.

Gjithashtu vlen të analizohet vendimi Nr. 249, datë 9 Qershor 2021³⁸, me të cilin KLGJ ka bërë komandimin e një gjyqtareje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në pozicionin “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”, në Këshillin e Lartë Gjyqësor. KSHH, në kushtet e gjendjes së rënduar të vakancave në sistem dhe numri i gjyqtarëve të caktuar përkohësisht në gjykata të ndryshme nga ajo ku gjykojnë, vlerëson se kontributi i një magjistrati do ishte më i vlefshëm në gjykatë, se sa në pozicionin e një drejtorie. Në lidhje me komandime të ngjashme, KSHH vlerëson të shikohet gjithashtu shmangia e riskut mbi premisat e qasjeve të korporatizimit për të afruar këta magjistratë në qytetin e Tiranës.

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Sipas informacionit të marrë nga KLP, nga fillimi i këtij procesi deri në fund të periudhës së Monitorimit, 40 prokurorë janë shkarkuar me vendim të formës së prerë në kuadër të procesit të vettingut dhe 40 janë të pezulluar, në pritje të një vendimi përfundimtar. Po ashtu nga fillimi i procesit të reformës në drejtësi, 15 prokurorë kanë dhënë dorëheqjen.³⁹

Në përgjigje të vakancave të krijuara, KLP ka marrë Vendimin nr. 38, datë 2 Shkurt 2021 “Për miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet e kandidimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”. Sipas këtij vendimi janë 56 kandidatë që plotësojnë kushtet për lëvizje paralele në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

35 Sipas informacionit të përcjellë në rrugë zyrtare nga KLGJ, sa i përket periudhës 01.04.2021 deri më 15.10.2021, janë caktuar nëpërmjet një skeme delegimi 13 magjistratë (gjyqtarë), të cilët janë komanduar për një periudhë 1 (një) vjeçare.

36 Sipas informacionit të përcjellë në rrugë zyrtare nga KLGJ, sa i përket periudhës 01.04.2021 deri më 15.10.2021, janë transferuar në mënyrë të përkohshme gjithsej 9 magjistratë (gjyqtarë) në funksion të përmbushjes së nevojave të gjykatave (shkresë nr. 5061/1 prot., dt. 15.11.2021 të KLGJ)

37 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/05/VENDIM-Nr.-190-dat%C3%AB-07.05.2021-P%C3%8BR-ND%C3%8BRPRERJEN-E-TRANSFERIMIT-T%C3%8B-P%C3%8BRKOHSH%C3%8BM-DHE-KOMANDIMIN-N%C3%8B-SKEM%C3%8BN-E-DELEGIMIT-T%C3%8B-GJYQTARIT.pdf>

38 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/06/VENDIM-Nr.-249-dat%C3%AB-09.06.2021-P%C3%8BR-KOMANDIMIN-E-GJYQTARES-ZNJ.-%E2%80%A6-N%C3%8B-K%C3%8BBSHILLIN-E-LART%C3%8B-GJYQ%C3%8BSOR.pdf>

39 Të dhëna të përcjella në rrugë zyrtare nga KLP, nëpërmjet shkresës nr. 2374/1 prot., dt. 04.11.2021 “Kthim përgjigje”

Më datë 31 Mars 2021⁴⁰, KLP ka marrë disa vendime për renditjen e kandidatëve për secilin pozicion vakant për secilën prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit ku është hapur kjo procedurë . Vlen të përmendet fakti se në këtë proces vendimmarrjeje, Këshilli vendosi me shumicë votash të miratojë vendimin e propozuar nga Komisioni i përhershëm i Karrierës për të konsideruar si përvojë specifike për nivelin e apelit, vetëm përvojën në këtë nivel dhe jo në Prokurorinë e Përgjithshme. Ky kriter është disi kufizues dhe i diskutueshëm në kuptim të frymës së ligjit, logjikës së zhvillimit të karrierës dhe meritokracisë.

Duke ju referuar parashikimeve të bëra në nenin 45 të ligjit nr. 96/2016⁴¹, sa i përket skemës së delegimit si një mekanizëm fleksibël për qeverisjen efektive të gjyqësorit dhe prokurorisë, vërehet se kjo skemë nuk është krijuar ende nga KLP, ndryshe nga KLGJ-ja që tashmë e ka miratuar. Në mungesë të kësaj skeme, KLP-ja ka përdorur mekanizmin e transferimit të përkohshëm sipas nenit 59 të Ligjit Nr. 96/ 2016 , duke miratuar 72 vendime transferime të përkohshme gjatë periudhës së monitorimit. Rezultoni se gjatë periudhës së monitorimit, Këshilli nuk ka ndërmarrë vendimmarrje në lidhje me procedurën e komandimit, ndërkohë që pas aprovimit të ligjeve të Reformës në Drejtësi (viti 2016) deri në Nëntor 2021, 19 magjistratë (prokurorë) janë emëruar në disa prej Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë në rang vendi.

1.1.4 Harta e re Gjyqësore

Ri-organizimi gjyqësor apo harta e re gjyqësore është një proces që vlerësohet me rëndësi në drejtim të përmirësimit të efikasitetit të gjyqësorit por edhe prokurorisë si dhe për reduktimin e vonesave dhe përmirësimin e cilësisë dhe ekonomisë gjyqësore.

Në bazë të informacionit që KShH disponon, KLGJ ka krijuar një grup ndër-institucional (GNP) përmes Urdhrit nr. 78, datë 18.02.2019 të Kryetares së Këshillit, me pjesëmarrjen e tre anëtarëve të KLGJ-së, dy përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësues nga të treja nivelet gjyqësore, asistuar nga partnerët ndërkombëtarë. Për një proces të tillë me rëndësi jetike për qytetarët, që zgjati afro 3 vite, GNP ka zhvilluar 10 mbledhje në total. Këto mbledhje nuk kanë qenë të hapura për publikun dhe për të interesuarit, përfshi këtu edhe organizatat e shoqërisë civile.

Teksa reforma në sistemin e drejtësisë, mundësoi reformim tërësor në përbërjen e Këshillave (KLGJ dhe KLP), me qëllim arritjen e ekuilibrave për të luftuar elementët korporatist të vërejtur nga organet e mëparshme, sa i takon karrierës dhe disiplinës së gjyqtarëve/prokurorëve, e njëjta qasje,

40 Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë, Prokuroria e Apelit Tiranë, Prokuroria e Shkallës së Parë Durrës, Prokuroria e Apelit Durrës, Prokuroria e Apelit Shkodër, Prokuroria e Apelit Vlorë, Prokuroria e Shkallës së Parë Lushnje, Prokuroria e Shkallës së Parë Krujë, Prokuroria e Shkallës së Parë Elbasan

41 Mbështetur në Rregulloren "Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të Prokurorit": <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/07/RREGULLORE-PER-TRANSFERIMIN-E-PERKOHSEM.pdf>

mund të ishte reflektuar në përbërjen e GNP për hartën e re gjyqësore. Përfaqësimi në këtë grup nuk garanton mjaftueshëm larmishmëri dhe gjithë përfshirje, ndërkohë që përfaqësimi në këtë Grup, me gjyqtarë nga gjykatat që propozohen të shkrihen, është i diskutueshëm në sytë e një vëzhguesi publik, objektiv dhe të paanshëm.

Harta e re e propozuar nga Këshilli parashikon që nga 35 gjykata të shkallës së parë dhe të apelit sa janë aktualisht në total të bëhen 16 të tilla⁴². Më konkretisht nga 22 gjykata të juridiksionit të përgjithshëm të bëhen 12, nga 6 gjykata administrative në shkallë të parë, të mbeten 2, të mbetet 1 gjykatë e apelit administrativ si edhe propozimi më i guximshëm duket të jetë ai i 1 gjykate apeli në rang kombëtar me seli në Tiranë. Ky propozim i fundit duket se ka hasur dhe në rezervën më të madhe fillimisht nga Ministria e Drejtësisë. Aktorëve të interesuar, ndër të cilët përfaqësuesit e shoqërisë civile, Raporti i Vlerësimit i hartuar nga ana e Grupit të Punës mbi Hartën e Re Gjyqësore është përcjellë në rrugë elektronike më dt. 28/12/2021.

Qysh në momentin kur u hodh për diskutim drafti i vlerësimi paraprak për hartën e re gjyqësore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) tërhoqi vëmendjen së bashku me 9 organizata të shoqërisë civile, për:

- Mungesën e transparencës dhe aksesit në mbledhjet e Grupit Ndërinstitucional të punës së ngritur nga KLGJ;
- Mungesën një procesi gjithëpërfshirës përgjatë fazës së hartimit të raportit të vlerësimit
- Mungesën e një studimi apo vlerësimi objektiv dhe të gjithanshëm, me pluset dhe minuset e ri-organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompecentave të tyre tokësore.

KShH vëren se metodologjia e ndjekur për vlerësimin e kryer nga GNP për hartën e re gjyqësore krijon premisa serioze për cenimin e aksesit në drejtësi, të njerëzve që i përkasin grupeve në nevojë në vendin tonë, i cili përbën një nga 3 objektivat që parashikohen për caktimin e kompetencave tokësore, në nenin 14/germa “a” e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor

Raporti i vlerësimit për hartën e re gjyqësore nuk përcakton cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, mjetet e munguara të transportit në disa prej zonave të thella rurale dhe aksesit i grupeve të disavantazuara ekonomikisht në përdorimin e rrugëve dhe mjeteve të transportit.

Nëse do të llogarisim kohën që i duhet një banori të zonës së Ceremit në Tropojë, për të shkuar në Gjykatën e Kukësit, i duhen ekzaktësisht 3 orë e 6 minuta, me automjet privat, ndërkohë që gjendja ekonomike për banorë të kësaj zone ose zonave të skajshme të Bashkisë Tropojë vështirëson apo pamundëson aksesin në drejtësi.

⁴² Pa llogaritur gjykatat e posaçme kunder korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ri-organizimi gjyqësor dhe caktimi i numrit të gjyqtarëve, duhej të ishin dy procese të realizuara në kohezion të plotë dhe paralelisht. Ri-organizimi gjyqësor sipas propozimit të KLGJ-së u kushtëzua nga një organikë e vjetër e 10 viteve më parë të miratuar me dekret të Presidentit të RSH, që nuk i përgjigjet nevojave për drejtësi të qytetarëve që banojnë në zonat ku gjykatat propozohen të shkrihen.

Vendosja apo ruajtja e një ekuilibri, midis shpërndarjes së ngarkesës së punës dhe shpërndarjes së gjyqtarëve ndërmjet gjykatave, sipas GNP-së është tregues i mungesës së efikasitetit të sistemit çka duhet të korrigojohet me hartën e re. Megjithatë, vërehet se një pjesë e gjykatave që propozohen të shkrihen, dhe me organikën e gjyqtarëve kanë ngarkesë më të lartë se mesatarja prej 429 çështjesh në vit (Kavaja 591, Kurbin 671, Kruja që ka në juridiksion edhe IEPV Krujë, ka një ngarkesë 593, dhe Lushnja 490).

1.1.5 Trajnimet e Magjistratëve

Nenet 88 dhe 186 të ligjit nr. 115/2016 parashikojnë bashkëpunimin e Këshillave me Shkollën e Magjistraturës, për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndër të tjera duke monitoruar dhe raportuar publikisht efikasitetin e trajnimeve.

Në lidhje me trajnimin e gjyqtarëve, KLGJ-ja ka miratuar dy vendime në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin 2021⁴³. Në lidhje me vitin akademik 2021 – 2022 nuk rezultoi të jetë publikuar një vendim i ngjashëm nga ana e Këshillit. Nga ana tjetër në faqen online⁴⁴ të Shkollës së Magjistraturës është publikuar Tabela e kurseve për vitin akademik 2021-2022.

KShH vlerëson se për të rritur efijencën e këshilltarëve, ndihmësve ligjorë, nevojiten trajnime sistematike dhe kualifikime vazhduese. Referuar komunikimit zyrtar me gjykatat vërejmë vonesa sa i përket trajnimeve vazhduese të nëpunësve civil të shërbimit gjyqësor, të cilët nuk kanë kryer trajnimet vazhduese nga ana e KLGJ. Gjithashtu, KShH sugjeron ndërtimin dhe zbatimin e një mekanizmi mentorues për matjen e efektivitetit të këtyre trajnimeve në performancën e gjyqtarëve, pasi ky përbën një nga detyrimet ligjore që kërkon monitorim dhe raportim publik nga KLGJ.

43 Vendimi nr. 647, datë 23 Dhjetor 2020, për periudhën Janar – Mars 2021 dhe Vendimi nr. 97, datë 17 Mars 2021, për periudhën Prill – Korrik 2021. Tematikat në fokus të këtyre trajnimeve kanë qenë e drejta kushtetuese, penale, tregtare, e drejta e detyrimeve, procedurë civile dhe e drejtë e tatimeve. Disa nga trajnimet në fjalë janë kryer në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtare dhe numri i trajnimeve të organizuara ka qenë rreth 15.

44 https://admin.magjistratura.edu.al/uploads/Kalendar_TV_2021_2022_d3664b26c1.docx

1.1.6 Ngritjet në Detyrë

Neni 47/1 i ligjit nr. 96/2016, ka parashikuar se ngritja në detyrë është kalimi nga: i) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë; ii) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme; iii) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie; iv) nga një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.

A. Këshilli i Lartë Gjyqësor

Gjatë periudhës objekt monitorimi, KLGJ-ja ka realizuar 10 ngritje në detyrë, nga të cilat 6 lidhen me Gjykatën e Lartë dhe 4 me Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar. Të dyja këto gjykata, por veçanërisht Gjykata e Lartë, kanë rëndësi të veçantë në sistemin tonë gjyqësor, si për shkak të nevojës për reduktimin e stokut të dosjeve dhe dhënies së drejtësisë në shkallën më të lartë, por edhe për shkak të kompetencës lëndore, sikurse është Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar. Këshilli në lidhje me ngritjet në detyrë, gjatë Periudhës së Monitorimit ka ndër marrë edhe veprime përgatitore në lidhje me ngritjet në detyrë, të lidhura kryesisht me gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm si edhe me gjykatat e posaçme për korrupsion dhe krim të organizuar.

Për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si edhe dorëheqjeve apo mbarimit të mandatit për shkaqe të tjera, Gjykata e Lartë gjatë periudhës 2019 -2020 mbeti me vetëm 1 nga 19 gjyqtarë që duhej të ishin sipas organikës saj. Për të zhbllokuar situatën, KLGJ komandoi pak kohë më parë gjyqtarë të Gjykatave të Apelit për të mundur shqyrtimin e disa çështjeve emergjente që lidhen me ekstradimet. Pavarësisht këtij mekanizmi të përkohshëm, vlen të përmendet se nga informacioni i marrë përmes faqes Facebook të Gjykatës së Lartë, deri në fund të Periudhës së Monitorimit, Gjykata e Lartë ka patur një ngarkesë prej 36 140 çështjesh në pritje për t'u gjykuar. Pra si rrjedhojë plotësimi i çdo vakance në këtë gjykatë ka sjellë dhe do vijojë të sjellë një ndryshim domethënës në funksionimin e këtij organi kyç të pushtetit gjyqësor.

Një nga problematikat e ndeshura në plotësimin e vakancave të Gjykatës së Lartë ka ardhur si rezultat i ushtrimit të së drejtës legjitime të ankimit nga kandidatët pjesë e procedurës së konkurimit. Gjatë periudhës së monitorimit është realizuar një ankim administrativ nga një kandidatë lidhur me vendimmarrjen e KLGJ mbi procedurën e verifikim-

it të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë⁴⁵. Gjykata Administrative e Apelit vendosi rikthimin në garë të kandidatës magjistrate (gjyqtare)⁴⁶, një vendim i cili nuk u mirëprit nga ana e KLGJ-së. Këshilli ushtroi të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë, e cila më dt. 18.01.2021 vendosi prishjen e vendimit të dhënë nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj⁴⁷.

KSHH në lidhje me situatën në Gjykatën e Lartë, gjen me vënd të theksojë se:

- Aktualisht gjykata ka 11 anëtarë nga 19 që është organika dhe vazhdon të ketë një numër shumë të lartë çështjesh për të evaduar⁴⁸.
- Mungon kuorumi prej 10 gjyqtarësh për të propozuar anëtarët e Gjykatës Kushtetuese në përputhje me detyrimet e veta kushtetuese⁴⁹;

Në lidhje me Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të cilat janë institucione të një rëndësie të posaçme, dhe duhet të jenë të pajisura me gjyqtarë të specializuar dhe me eksperiencë në profilin e çështjeve për shqyrtim, vihet re se aktualisht në shkallë të parë janë 7⁵⁰ nga 16 gjyqtarë që duhet të ketë, ndërkohë që në nivel apeli janë 6 nga 11⁵¹ që duhet të ketë sipas ligjit nr. 98/2016⁵². Numri i vendeve vakante në këto gjykata, përkatësisht 15 është i konsiderueshëm. Vlen të theksohet se, KLGJ është në procesin e verifikimit të kushteve dhe kritereve formale dhe ligjore dhe pasurisë për 5 kandidatë në lidhje me promovimin e tyre në GJKK si edhe 4 për GJKK Apel. Këto procedura janë të varura dhe nga përfundimi i procesit të Vetting-ut për këta kandidatë.

Ajo që konstatohet është mungesa e interesit të gjyqtarëve që përmbushin kushtet ligjore për të qenë pjesë e këtyrë gjykatave. Kjo mendohet të jetë e lidhur me përgjegjësinë dhe peshën e veprimtarisë që ato kanë në publik, si edhe me kriteret kufizuese kushtetuese dhe ligjore, të së drejtës së privatësisë së këtyrë gjyqtarëve (që është vlerësuar si proporcionale nga Komisioni i Venecias që ka marrë në shqyrtim).

Nga informacioni i disponuar, KLGJ-ja ka ndërmarrë disa përpjekje, në formën e aktiviteteve për të nxitur gjyqtarët të jenë pjesë e këtyrë gjykatave, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe ideve, megjithatë intere-

45 Vendim nr. 201/4, dt. 11.06.2020 të KLGJ

46 Vendim nr. 93, dt. 10.11.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

47 http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Informacion_mbi_perfundimin_e_ceshtjeve_administrative_ne_seance_gjyqesore_me_prani_te_paleve_date_18_Janar_2021_8132_1.php

48 6 prej anëtarëve janë emëruar nga radhët e gjyqësorit, gjatë muajve mars-korrik 2021. Ndërkaq në 3 muajt e parë të vitit 2022 janë emëruar 2 gjyqtarë.

49 Neni 125.1 i Kushtetutës.

50 Irena Gjoka, Etleva Deda, Daniela Shirka, Flora Hajredinaj, Iliriana Olldashi dhe Erjon Çela

51 Nertina Kosova, Saida Dollani, Dhimitër Lara dhe Miliana Muça

52 Neni 15. 4, c dhe ç i Ligjit 98/2016

si për këto evente ka qenë i vakët. Po ashtu masë nxitëse me rëndësi përmendet dhe ndryshimi në ligjin Nr. 96/ 2016, për sa i takon caktimit të shtesës për vështirësi në punë në masën 80% të pagës fillestare për gjyqtarët e këtyre gjykatave.

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Në Dhjetor të 2020-ës, KLP-ja ka marrë vendimin për miratimin e listës së 26 kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u ngritur në detyrë, në pozicionin e Drejtuesit të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Në të njëjtën ditë, KLP ka marrë një sërë vendimesh mbi emrat që ndalohen të kandidojnë për pozicionet e drejtuesve të prokurorive⁵³. Rezulton se nga 28 zyra prokurorie ku ka patur vakanca për pozicionin e Drejtuesit, për 10 prej tyre nuk ka patur interes, nuk janë plotësuar kushtet nga ana e kandidatëve ose aplikimet janë dorëzuar jashtë afatit. Mund të shtohet se në shumicën dërrmuese të 18 prokurorive ku ka aplikime ka vetëm një kandidat, çfarë ashtu siç pohohet dhe nga ana e Kryetarit të Këshillit, sjell mungesën e konkurrueshmërisë. Vlen po ashtu të përmendet se realizimi i këtij procesi me vonesë nga Këshilli pas solli qëndrimin përtej mandatit, të disa nga drejtuesve të prokurorive. Vonesa ka patur edhe procesi i rivlerësimit kalimtar.

Lidhur me këtë proces, vlen të analizohet vendimi nr.231, datë 27 Tetor 2020⁵⁴, me anë të të cilit, Këshilli, ka miratuar ndryshimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”. Me ndryshimet e bëra, Këshilli ka marrëtribute për të emëruar drejtues të prokurorive, edhe magjistratë që nuk kanë kaluar procesin e rivlerësimit. Kjo vendimmarrje është shoqëruar me një ndarje ndërmjet anëtarëve të KLGJ-së, konkretisht 6 pro dhe 3 kundër. Teksa, për prokurorët dhe gjyqtarët që emërohen në institucionet e specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kalimi i procesit të vettingut me sukses përbën një kriter të detyrueshëm ligjor, për promovimet e tjera, ligjet e posaçme⁵⁵ nuk e parashikojnë në mënyrë të qartë. Bashkërendimi i procedurave të karrierës me Vetting-un, në vlerësimin e KShH-së është një nevojë imediate që kërkon koordinim sistematik midis Këshillave dhe organeve të Vetting-ut. KShH vlerëson se në kushtet aktuale, duhet marrë në konsideratë rëndësia e kalimit me sukses të vettingut (si një proces i jashtëzakonshëm me natyrë kalimtare), pasi garanton më mirë integritetin etiko-profesional të kandidatëve. Vendimmarrje të diskutueshme janë ato të datës

53 <https://klp.al/2020/12/21/vendime-date-17-12-2020/>

54 <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendim-nr-231-27.10.2020..pdf>

55 Neni 48/8 i ligjit nr. 96/2016 parashikon se kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

26 Mars 2021, ditë në të cilën me vendimin nr. 71 është caktuar në detyrë drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe me vendimin nr. 74, është caktuar drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Pavarësisht diskutimeve, Këshilli ka vendosur vijimin e procesit të ngritjes në detyrë për prokuroritë ku ka patur vetëm një kandidat dhe të rihapë procesin për ato zyra prokurorie ku nuk ka patur kandidatura⁵⁶. Më datë 14 Janar 2021, KLP-ja ka marrë vendimin nr. 9 për kualifikimin e kandidatëve për 3 Prokuroritë, nga 10 për të cilat ishin ri-shpallur vakancat për ngritjen në detyrë si Drejtues Prokurorie.

Në lidhje me ngritjet në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, gjatë muajit Maj dhe Korrik 2021, Këshilli vendosi të emërojë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme z. S.K, z. D.P, z. V.M dhe znj. M.K për një mandat 9 vjeçar, pa të drejtë rriemërimi. Më 8 Tetor 2021, KLP-ja ka publikuar njoftimin për shprehjen e interesit për 2 pozicione vakante në Prokurorinë e Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar⁵⁷. KShH e konsideron pozitive veprimtarinë e Këshillit për plotësimin e një institucioni kaq me rëndësi siç është SPAK.

C. Standart jo i unifikuar

Sa i takon vendimmarrjeve të lidhura me ngritjen në detyrë, KShH vëren një standart të ndryshëm në praktikën e Këshillave. KLP ka vendosur të mos mbetet në pritje të vendimmarrjeve të organeve të vettingut, me qëllim ngritjen në detyrë të magjistratëve (prokurorë) duke i dhënë në këtë mënyrë prioritet të drejtës për karrierë të subjektit, ndërkohë që KLGJ e ka kushtëzuar këtë proces me vettingun e subjekteve magjistratë. Mbajtja e qëndrimeve të ndryshme nga dy organet përgjegjëse për sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë është një element që nuk i shërben besueshmërisë së publikut te organet e drejtësisë, duke qenë se karriera e një magjistrati duhet të ndërtohet mbi themele të forta dhe të konsoliduara nga ana e standardeve, sikurse është procesi i rivlerësimit kalimtar.

KShH vlerëson se procedurat e ngritjes në detyrë të magjistratëve (gjyqtarë) nga ana e KLGJ-së reflektojnë frymën dhe objektivat madhorë të reformës në drejtësi dhe përbën një nga aspektet për të cilat puna e Këshillit është për t'u vlerësuar.

⁵⁶ Për këtë të fundit, KLP ka marrë vendimin nr. 298, datë 23 Dhjetor 2020, për të përsëritur thirrjen për 10 Prokuroritë pa kandidatë.

⁵⁷ <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/10/Thirrje-per-SPAK-i-fundit.pdf>

1.1.7 Vlerësimi Etiko – Profesional

Ligji nr. 96/2016 parashikon dispozitat lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të magjistratit, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të etikës dhe aftësisë profesionale, vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së magjistratëve⁵⁸.

A. Këshilli i Lartë Gjyqësor

Gjatë periudhës së monitoruar KLGJ-ja ka marrë një sërë vendimesh për procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve. Vlen të përmendet si akt rregullator Vendimi Nr. 75, datë 4 Mars 2021 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.

KLJGJ është gjendur në situatë të disfavorshme për sa i përket mundësisë së vlerësimeve etiko-profesionale të gjyqtarëve nga institucioni pararendës, ish-KLD. Megjithatë, nga numri i akteve të miratuara duket se ritmi i këtij procesi, që pa dyshim është voluminoz, është i ngadaltë. Nëse Këshilli vazhdon me këtë ritëm, premiset për përfundimin e procesit të vlerësimit etik-profesional të 121 gjyqtarëve, sipas programit të miratuar të vlerësimit për vitin 2020-2021, duken të vështira⁵⁹. Për efekt të transparencës, në përgjithësi vendimet e Këshillit në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional nuk shoqërohen me relacionet respektive të arsyetuara.

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Gjatë periudhës së monitorimit, KLP ka dhënë 40 vendime për miratimin e raporteve të vlerësimit etiko-profesional, për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe për vlerësimin e magjistratëve në kuptim të Ligjit 96/2016. Shpesh ka ndodhur që këto raporte të jenë relatuar në mënyrë shumë të përmbledhur nga ana e Komisionit përkatës, pa përmendur gjetjet kryesore dhe si janë vlerësuar ato në raport me ligjin e zbatueshëm. Po ashtu, për efekt të transparencës, duhet përmendur si mangësi e Këshillit mospublikimi i tyre në faqen zyrtare të Këshillit.

1.1.8 Çështjet Disiplinore

Ligji nr. 96/2016 parashikon parimet dhe çfarë konsiderohet shkelje disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët⁶⁰ si dhe parashikon masat disiplinore nëse Këshillat konkludojnë se magjistrati ka kryer shkelje të tilla.

58 Neni 68 e vijues i Ligjit Nr. 96/2016

59 Gjatë periudhës së monitorimit, Këshilli ka ndërmarrë një sërë vendimesh në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional, megjithatë ritmet aktuale nuk janë të kënaqshme duke marrë në konsideratë vëllimin e vlerësimeve për t'u proceduar.

60 Neni 100 dhe vijues

A. Këshilli i Lartë Gjyqësor

Për efekt të transparencës së procedurave të disiplinës që Këshilli ndjek dhe zbaton, duhet theksuar se vendimmarrjet e Komisionit të përhershëm Disiplinor të Këshillit nuk publikohen në faqen zyrtare të internetit. Gjatë periudhës së raportimit, KLGJ-ja ka vendosur mbi disa çështje disiplinore nga të cilat mund të veçojmë:

- 1 procedim disiplinor për gjyqtarin e Rrethit Gjyqësor Korçe, M.K, i cili ka përfunduar me vendimin e KLGJ-së për shkarkimin e tij, nr 633 dt. 10 Dhjetor 2020.
- 1 procedim disiplinor që ka përfunduar nga KLGJ me shkarkimin nga detyra të gjyqtarës E.H, më datë 17 Mars 2021. Vendimi i zbardhur nuk është bërë publik. Më herët, KLGJ ka pezulluar magjistraten⁶¹, për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal “arrest me burg” nga Gjykata penale kompetente.
- 1 procedim disiplinor që ka rezultuar fillimisht me pezullimin nga detyra të magjistrates E.K, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në faqen e internetit të KLGJ-së nuk mund të aksesohet vendimi i pezullimit nga detyra të kësaj magjistrateje, ndërkohë që procesverbali audio i seancës në fjalë është i publikuar rregullisht dhe në mënyrë të plotë. Po ashtu në njoftimin për shtyp publikuar nga KLGJ-ja⁶², parashikohet pezullimi i magjistrates deri në përfundim të hetimit disiplinor nga ILD.

KSHH e konsideron shumë thelbësore rëndësinë e sjelljes etike të gjyqtarit si gjatë ushtrimit të funksionit ashtu edhe jashtë tij, një sjellje e cila duhet të reflektojë integritet dhe të ngjallë besim në publik. KSHH vlerëson reagimin e shpejtë të Këshillit në këto raste.

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

KLP-ja ka një rubrikë të dedikuar në faqen zyrtare të internetit për procedimet disiplinore, çfarë është pozitive në drejtimin e transparencës. Gjatë periudhës së monitorimit, çështjet disiplinore të shqyrtuara nga Këshilli janë kushtëzuar më së shumti nga procedimet penale të ndjekura nga SPAK dhe GJKKO ndaj disa prej magjistratëve prokurorë, si vijon:

- Më datë 31 Mars 2021 Këshilli vendosi pranimin e kërkesës së ILD dhe shkarkimin e prokurorit B.M.⁶³ Vendimi në fjalë është i publikuar në faqen e Këshillit, shoqëruar me arsyetimin përkatës.

61 Si masë e ndërmjetme sipas nenit 140 pika 3 “a” të Kushtetutës dhe nenit 151, pika 1 “a” e ligjit 96/2016.

62 <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-7-qershor-2021/>

63 <https://klp.al/epcontent/uploads/2021/04/Vendimi%20perfundimtar%20Bujar%20Memia%20per%20publikim.pdf>

- KLP ka vendosur në dt. 22 Qershor 2021 pezullimin nga detyra të prokurorit S. H, bazuar në vendimin nr. 40, datë 17 Qershor 2021 të GjKKO Shkalla e Parë, sipas të cilit është caktuar ndaj magjistratit në fjalë masa e sigurimit personal “arrest në burg”.
- Procesi disiplinor për prokurorin E.K, ku Këshilli vendosi pezullimin nga detyra, pasi në dt. 30 Qershor 2021, GjKKO Shkalla e Parë caktoi ndaj magjistratit në fjalë masën e sigurimit personal “arrest në burg” për veprën penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë.
- Pezullimi nga detyra i prokurorit M.S, u bazua gjithashtu në vendim-marrjen e dt. 30 Qershor 2021 të GjKKO Shkalla e Parë, sipas të cilës është caktuar ndaj magjistratit në fjalë masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, i akuzuar për veprën penale shpërdorim detyre.

KSHH i konsideron të drejta këto vendimmarrje dhe në përputhje me përcaktimet kushtetuese, Ligjin 96/2016 dhe Ligjin 115/2016.

1.1.9 Pavarësia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Këshillat nuk kanë mbajtur qëndrime të njëjta në lidhje me mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndaj retorikës së fortë politike në publik, e cila ka premisa për t’u cilësuar në sytë e opinionit publik si shfaqje mbizotëruese e ekzekutivit ndaj gjyqësorit. Në fakt, sistemi i qeverisjes në vendin tonë, bazohet në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ndërkohë që pushteti gjyqësor është i pavarur nga legjislativi dhe ekzekutivi.

A. Këshilli i Lartë Gjyqësor

Më datë 17 Mars 2021, KLGJ-ja ka përfunduar me shkarkimin nga detyra të gjyqtarës E.H. Më herët, më 15 Shkurt 2021, Këshilli kishte pezulluar magjistraten për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal “arrest me burg” nga Gjykata penale kompetente. Gjatë kohës së zbatimit të masës së pezullimit, ka patur retorikë të ashpër publike nga ana e ekzekutivit ndaj gjyqtarës në fjalë⁶⁴. KLGJ nuk ka reaguar lidhur me këto deklarata, në respektim edhe të parimit të prezumimit të pafajësisë të magjistrates, gjatë një procesi penal.

KLGJ ka reaguar në datë 15 Korrik 2021 për rastin e publikuar gjerësisht në media, në lidhje me dhunimin fizik të gjyqtarit A. B, në Gjykatën e Apelit Vlorë. KLGJ-ja ka reaguar me shpejtësi për rastin në fjalë duke dënuar veprimet dhe gjuhën fyese të përdorura ndaj gjyqtarit në fjalë si edhe duke shprehur angazhim për rikthimin e besimit të publikut te gjykatat⁶⁵.

64 <https://tvklan.al/arrestimi-i-gjyqtarës-hoxha-rama-cuarja-e-ketij-llumi-para-drejtësisë-te-vazhdoje/>

65 <http://klgj.al/deklarate-per-mediat-juridiksioni-i-apelit-vlore/>

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Nga ana tjetër, në mbledhjen plenare të datës 14 Prill 2021, KLP-ja ka diskutuar letrën e një grupi prej afërsisht 50 prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për të mbajtur një deklaratë mbrojtjeje ndaj sulmeve që i janë bërë drejtueses së kësaj prokurorie nga kreu i partisë opozitare. Kryetari dhe disa anëtarë mbajtën qëndrimin që kjo çështje duhej diskutuar në mënyrë jo publike në dhomë këshillimi, me qëllim evitimin e komentimit nga ana e medias. Diskutimi i çështjeve me peshë dhe rëndësi për opinionin publik në Dhomë Këshillimi, pa i dhënë akses medias dhe publikut për shkak të komenteve që mund të vijnë nga mediat, cenon nivelin e transparencës së këtij Këshilli. Nga ana tjetër duhet vlerësuar qasja e KLP-së për të reaguar në mbrojtje të figurës dhe pavarësisë së magjistrates prokurore.

1.2. TRANSPARENCA

1.2.1 Parashikimet ligjore

Ligji nr. 115/2016 parashikon transparencën e organeve të reja të qeverisjes së drejtësisë, duke theksuar se sistemi i drejtësisë bazohet parimin e llogaridhënies dhe transparencës. Publikimi i informacionit dhe veprimtarisë së dy Këshillave, parashikohet respektivisht nga neni 69 për KLGJ-në dhe neni 167 për KLP-në⁶⁶. Po ashtu, në përputhje me dy dispozita të tjera, përkatësisht nenin 82 për KLGJ-në dhe nenin 181 për KLP-në, Këshillat kanë detyrimin ligjor të raportojnë para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe prokurorial për vitin e mëparshëm kalendarik, të paktën 1 herë në vit dhe jo më vonë se data 1 Maj e çdo viti.

1.2.2 Aksesi nga Publiku në Faqet e Internetit të Këshillave

Faqet zyrtare të internetit të KLGJ dhe KLP janë lehtësisht të aksesueshme nga përdoruesit; adresat e tyre janë në trajtën e shkurtesave të tyre. Edhe nëse kërkohet në motorët e kërkimit në internet me termat ‘KLGJ’ apo ‘KLP’, të parat opsione që shfaqen janë pikërisht këto faqe. Faqet e Këshillave kanë në përmbajtjen e tyre një dritare të dedikuar “Programit të Transparencës”, ku publikohet informacion për mënyrën e paraqitjes së kërkesave për informacion, personat e kontaktit në lidhje me të drejtën e informimit, procedura ankimi, etj.

Pavarësisht se faqet e Këshillave ndryshojnë nga ana vizuale, ato ruajnë një

⁶⁶ Sipas këtyre dispozitave, Kryetari është përgjegjës për të siguruar se administrata merr të gjitha masat e nevojshme për dokumentimin e rregullt të mbledhjes plenare, përmes: a) regjistrimit audio i cili duhet të bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillave brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes; b) procesverbalit me mbledhjen e diskutimeve, i cili publikohet në faqen e internetit pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse, duke fshirë çdo referencë të emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillave dhe të gjyqtarëve ose prokurorëve mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore e pezullimit dhe shkarkimit.

strukturë të ngjashme për sa i përket informacionit të ofruar dhe përmbajtjes së tij. Mund të thuhet se në pamje të parë është më i lehtë aksesimi në vendimmarrjen e KLGJ-së duke qenë se nën rubrikën “Vendime” gjenden kategoritë e akteve që KLGJ miraton⁶⁷, të renditura në rend kohor. I njëjti konstatim vlen për informacionin e mbledhjeve të zhvilluara dhe regjistrimin audio të seancave plenare të KLGJ⁶⁸.

Në faqen e internetit të KLP-së, ka një hapësirë dedikuar seancave plenare, të ndara në dy nën – kategori që janë “Vendime/ Akte” dhe “Administrative”⁶⁹. Këtu janë të publikuara dhe njoftimet për mbledhje plenare si dhe seanca plenare. Është për t’u theksuar se njoftimet për mbledhje plenare ndodhen dhe te rubrika “Njoftime”⁷⁰. Po ashtu vlen të përmendet se përpara datës 16 Shkurt 2021, vendimmarrja e KLP-së kategorizohej në mënyrë specifike, duke përcaktuar nëse një akt lidhet me caktim të përkohshëm, komandim, verifikim, etj.

Në faqen zyrtare të KLGJ-së, në rubrikën “Njoftime” përfshihen njoftimet për shtyp, publikimet, njoftimet për vende vakante si edhe kalendari⁷¹. Megjithatë konstatohet se ky i fundit nuk është i përditësuar dhe nuk përmban informacion mbi pikat e rendit të ditës që do të shqyrtohen në seancat e ardhshme⁷². Po ashtu duhet theksuar se nuk ka asnjë dritare ku të merret informacion i plotë mbi mbledhjet pasardhëse apo të bëhet komunikim i agjendës së planifikuar⁷³. Vendimet e KLGJ-së publikohen të pashoqëruara nga relacionet përkatëse mbi të cilat është bazuar dhënia e tyre, duke ofruar transparencë të pamjaftueshme për publikun. Gjithashtu, është vënë re që përditësimi i procesverbaleve të shkruara nën titullin ‘Përmbledhja e Diskutimeve’ është më i ngadaltë në krahasim me regjistrimet audio të mbledhjeve nën rubrikën “Regjistrimi Audio”⁷⁴. Regjistrimet audio janë të një cilësie të mirë i cili mundëson kuptimin e diskutimit, përveç ndonjë rasti të veçantë dhe përjashtimor. Rubrika “Programi i Transparencës”⁷⁵ përmban ndër të tjerash seksionin me rëndësi “Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve”, ku ilustron në mënyrë të përmbledhur tërësia e kërkesave për informacion nga publiku, organi-

67 Akte normative nënligjore, akte administrative kolektive, akte administrative individuale, rregulla të brendshme dhe udhëzime

68 Për më shumë informacion, drejtohu te <http://klgj.al/dokumentimi-i-mbledhjes-plenare/>

69 Për më shumë, drejtohu te <https://kjp.al/category/seanca-plenare/>

70 Për më shumë: <https://kjp.al/category/seanca-plenare/#>

71 <http://klgj.al/njoftime/>

72 Nga periudha Janar - Gusht 2021, kalendari nuk ofron informacion në lidhje me seancat e ardhshme dhe motorri i kërkimit nuk është funksional

73 Agjenda ose rendi i ditës, zakonisht komunikohet nga Kryetarja e KLGJ-së në fillim të seancës dhe ndodh jo rrallë që në përputhje me Nenin 67.3 të Ligjit Nr. 115/2016, të paktën 6 anëtarë të pranishëm të vendosin përfshirjen e një çështjeje që nuk ka qenë e pjesë e agjendës

74 Në përfundim të muajit Gusht 2021 ishte publikuar në formatin audio seanca e fundit e këtij muaji (e datës 26 Gusht 2021), përmbledhja e diskutimeve kishte ndaluar deri në muajin qershor (konkretisht përmbledhja e seancës së datës 25 Qershor 2021). Pavarësisht se Ligji Nr 115/2016 në Nenin 69(3) parashikon që procesverballi i mbledhjes së KLGJ-së duhet të miratohet nga mbledhja pasardhëse e Këshillit, kjo procedurë nuk vihet re rregullisht në regjistrimet audio të mbledhjeve dhe nuk reflektohet në publikimin e përmbledhjeve të shkruara në datën e seancës pasardhëse.

75 <http://klgj.al/programi-i-transparences/>

zatave apo institucioneve dhe të dhëna në lidhje me kthimin e përgjigjes. Regjistri i kërkesave përditësohet here pas here. Deri në fund të Periudhës së Monitorimit, ky regjistër ofronte informacion lidhur me kërkesa për informacion deri në datën 26 Tetor 2021⁷⁶.

Mbledhjet e KLP-së dokumentohen dhe publikohen, në regjistrimin audio si edhe në formën e procesverbalit të shkruar dhe mund të akseohen në të njëjtën rubrikë, siç është përmendur dhe në krye të këtij kapitulli. Në raste të veçanta diskutimi zhvillohet i paregjistruar në audio dhe KLP publikon vetëm përfundimin e diskutimit dhe votimit. Megjithatë raste të tilla janë përjashtimore⁷⁷. Në faqen zyrtare të KLP-së, rubrika “Programi i Transparencës”⁷⁸ është e ngjashme me atë të KLGJ-së, ndërsa procesverbalet e mbledhjeve që gjenden në rubrikën “Seanca Plenare”⁷⁹, janë të shoqëruara me audion, çfarë e bën shumë praktike për përdoruesin që të ketë akses, në të njëjtën kohë në përmblidhjen me shkrim të seancës dhe në regjistrimin audio. Procesverbalet shpeshherë mungojnë tek regjistrimet audio më të reja, duke qenë se ato miratohen nga anëtarët gjatë seancave pasardhëse plenare⁸⁰. Diçka e tillë është bërë me e dukshme gjatë muajve të verës Korrik - Gusht 2021, duke qenë se deri në fillim Shtatori 2021, asnjë procesverbal i shkruar i mbledhjes nuk është publikuar përkrah regjistrimit audio. Si regjistrimet audio, ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të KLP-së ofrojnë mundësinë për t'u shkarkuar nga çdo anëtar i publikut, në ndryshim nga praktika e KLGJ-së, e cila mundëson shkarkimin e dokumentit të procesverbalit të mbledhjes, por jo regjistrimin audio. Vlen të theksohet se ndryshe nga KLGJ, njoftimet e mbledhjeve pasardhëse janë përgjithësisht të publikuara në faqen e internetit. Gjith, ashtu si në rastin e KLGJ-së, agjenda e mbledhjes parashtrohet në fillim të çdo mbledhjeje nga ana e Kryetarit. Po ashtu shtimi i çështjeve të reja të diskutimit përgjatë mbledhjeve është praktikë e zakonshme.

1.2.3 Arsyetimi dhe Publikimi i Vendimeve të Këshillave

Gjatë periudhës së monitorimit konstatohet se vendimmarrja e Këshillave karakterizohet nga shtjellimi dhe argumentimi i arsytimit, ku theks i veçantë vendoset te vendimet që lidhen me vlerësimin etik dhe profesional si edhe caktimin e masave disiplinore. Standarti i publikimit të vendimmarrjeve në seancë plenare të Këshillave, nuk aplikohet njëjloj dhe për vendimet e Komisioneve që funksionojnë pranë tyre. KSHH vlerëson se në faqet zyrtare të Këshillave, duhet të ketë rubrika të posaçme për vendimmarrjen e secilit komision.

76 <http://klgj.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-i-perditesuar-2021/>

77 Këtu mund të përmendim mbledhjen e datës 1 Prill 2021, në kuadër të procedimit disiplinor ndaj prokurorit B.M. me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë

78 Deri në fund të Periudhës së Monitorimit, ky regjistër përmban kërkesa që datojnë deri në Gusht 2021

79 <https://klp.al/2021/04/15/seanca-plenare-nr-94/>

80 Për shembull, për regjistrimet audio të mbledhjeve të KLP të datave 18.03.2021, 26.03.2021 dhe 29.03.2021, ende nuk është bashkëlidhur procesverbalet e mbledhjes (shënim i datës 30.03.2021).

A Këshilli i Lartë Gjyqësor

Vendimet e KLGJ-së kanë një gjuhë të qartë dhe me arsyeime relativisht të kuptueshme nga publiku, të cilat janë shoqëruar edhe me citimin e dispozitave ligjore ku mbështeten. Arsyet e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve janë argumentuar në mënyrë të detajuar nga relatorët, duke u ndalur gjerësisht tek secili nga kriteret ligjorë të vlerësimit. Rëndësia që i është atribuar procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve reflektohet edhe në kohëzgjatjen e diskutimeve lidhur me to. Një qasje e ngjashme vihet re në diskutimet lidhur me caktimin e masave disiplinore. Zakonisht seancat plenare që kanë patur në rendin e ditës këto çështje kanë një minutazh më të zgjatur në kohë (mbi 3 orë), në krahasim me seancat plenare ku nuk diskutohen këto çështje, të cilat mund të variojnë nga 30 minuta në rreth 1 orë⁸¹. Lidhur me kandidimet e magjistratëve për ngritje në detyrë, Këshilli në përgjithësi ka qenë i kujdesshëm të vlerësojë secilën prej kandidatave dhe të arsyetojë zgjedhjen e njëres prej tyre⁸².

Në dallim nga praktika e ndjekur nga ana e KLP-së, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka publikuar në faqen e tij zyrtare vendimmarrjet me nënshkrimin e anëtarëve. Për të kuptuar mënyrën e votimit të secilit anëtar, të interesuarit nga publiku duhet të lexojnë përmbajtjen e procesverbalit të seancës plenare. Kur sipas ligjit në fuqi⁸³, publikimi i emrave të anëtarëve të Këshillit vlerësohet i domosdoshëm në përmbajtjen e procesverbalit, vlerësohet e paqartë përse emrat dhe nënshkrimet respektive nuk reflektohen në vendimmarrjet e publikuara.

Me datë 14 Tetor 2021, KLGJ-ja reagoi me deklaratë për shtyp⁸⁴, në përgjigje të pretendimeve të një përfaqësuesi të medias për mungesë transparence në veprimtarinë e këtij Këshilli, në kuadër të procesit të verifikimit të kancelarëve të gjykatave, në detyrë⁸⁵. Mbledhja ku do të diskutohej kjo çështje u vendos nga Këshilli që të realizohej me dyer të mbyllura, me qëllim që të mund të shqyrtohen materiale që 'kanë përmbajtje të të dhënave personale, konfidenciale, apo në raste të veçanta të dhëna të klasifikuara'. KShH vlerëson se KLGJ-ja ka bazuar këtë vendimmarrje duke ju referuar një lex generalis, dhe jo një lex specialis, si Ligji Nr. 115/2016. Nga ana tjetër, KLGJ-ja justifikon qëndrimin e saj (ndër të tjera) me pamundësinë për të zbuluar një sekret shtetëror, por nuk jep detaje lidhur me natyrën e informacioneve të klasifikuara si të tilla dhe cilat janë organet që sipas ligjit ngarkohen për të bërë këtë klasifikim. Në vlerësimin e KShH-së, KLGJ

81 Vlerat e mësipërme bazohen në një përlllogaritje mesatare të kohëzgjatjes së seancave sipas temave të diskutuara. Mund të ketë raste përjashtimore

82 Për shembull, në Mbledhjen e datës 29.04.2021

83 Në analizë të nenit 66 pikat 8 dhe 9, si dhe 69 pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 115/2016, ligjvënësi i ka dhënë një rëndësi të veçantë transparencës kundrejt publikut nëpërmjet publikimit të procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve dhe regjistrimit audio, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

84 KLGJ referon në deklaratë se ka respektuar legjislacionin për infomacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror" dhe atë për mbrojtjen e të dhënave personale, Kodin e Procedurave Administrative si dhe nenin 10/2 të KEDNJ-së.

85 <http://klgj.al/deklarate-2/>

mund të kishte përdorur mënyra të parashikuara në ligj për mbrojtjen e këtij informacioni, si publikimi i këtyre materialeve duke fshirë referencat e emrave konkretë dhe informacioneve të tjera konfidenciale.

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Ashtu si KLGJ, edhe në vendimmarrjen e KLP-së vërehet përdorimi i një gjuhe të qartë dhe të kuptueshme, karakterizuar nga arsyetime të plota dhe veçanërisht të detajuara në rastet e procedimeve disiplinore të magjistratëve, si edhe në rastet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve. Vendimet për caktimin e masave disiplinore ndaj prokurorëve janë të elaboruar dhe arsytuar duke reflektuar një nivel më të madh transparence në raport me KLGJ-në. Për ilustrim, në rastin e vendimit për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit B.M, përmes një materiali tepër të elaboruar, KLP-ja ka arsytuar me detaje vendimet problematike të prokurorit, mangësitë e tij ligjore si edhe pretendimet e subjektit të procedimit.

Raportet e vlerësimit etiko – profesional të prokurorëve nuk publikohen si dokumente më vete nga KLP, por vetëm përmenden në procesverbalet e mbledhjeve. Nën rubrikën e “Vendimeve/Akteve Administrative” lidhur me miratimin e renditjes së kandidatëve për një vend vakant⁸⁶ relacionet shoqëruese pjesë përbërëse të vendimeve, gjithashtu rezultojnë se nuk janë publikuar.

1.2.4 Transparenca karshi publikut në drejtim të prioriteteve

Në lidhje me këtë çështje, rezulton se KLP-ja është një hap përpara duke qenë se Plani Strategjik për periudhën 2021 – 2024, i miratuar në Dhjetor të vitit 2020, gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit. Mospublikimi i këtij dokumenti nga KLGJ është një element që prek transparencën e Këshillit (konstatim ky që është vërejtur afër fundit të vitit 2021). Plani strategjik ka rëndësi për publikun dhe çdo të interesuar, pasi përmban programet dhe objektivat e Këshillit, çfarë është realizuar dhe çfarë mbetet për t’u realizuar, planin e veprimit, vlerësimin e riskut, indikatorët e performancës dhe shpenzimet.

⁸⁶ Psh, vendimet Nr. 83, 84, 85 etj. të datës 31.03.2021:
<https://klp.al/ep-content/uploads/2021/04/vendim-nr-83-date-31.03.2021.pdf>
<https://klp.al/ep-content/uploads/2021/04/vendim-nr-84-date-31.03.2021.pdf>
<https://klp.al/ep-content/uploads/2021/04/vendim-nr-85-date-31.03.2021.pdf>

1.3 Parimi i përgjegjshmërisë (Pjesëmarrja, Kuorumi dhe Debati i Brendshëm)

1.3.1 Pjesëmarrja e Anëtarëve në Mbledhjet e Këshillave

Në mbledhjet e Këshillave vihet re pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve dhe vetëm në raste përjashtimore ka patur mungesa të pakta nga ana e anëtarëve, për shkaqe shëndetësore ose arsye të tjera objektive. Në çdo rast, në mbledhjet e zhvilluara të cilat reflektohen në faqet përkatëse të internetit të Këshillave, nuk ka patur mungesë kuorumi të anëtarët.

1.3.2 Debati në mbledhje– Indikator i Demokracisë së Brendshme

A. Këshilli i Lartë Gjyqësor

Në mbledhjet e zhvilluara në seancat plenare të KLGJ-së, gjatë periudhës së monitorimit, vihet re një dakordësi dhe klimë e qetë diskutimi mes anëtarëve në lidhje me pikat e rendit të ditës. Kështu në mbledhjen plenare të datës 12 Mars 2021, mbi propozimin e Presidentit të Republikës të 4 kandidatëve për anëtare të Gjykatës së Lartë, nuk ka patur debat por një dakordësi unanime nga ana e anëtarëve të KLGJ-së. Pa dashur të minimizojmë rëndësinë e kësaj mbledhjeve dhe vendimmarrjes së KLGJ-së, në parim vlerësojmë se debati konstruktiv për cilësinë e kandidaturave në një prej organeve kyç të sistemit gjyqësor, do ishte shumë i vlefshëm.

Përgjithësisht vlerësimet etiko - profesionale të gjyqtarëve dhe magistratëve janë shoqëruar me diskutime dhe pyetje – përgjigje ndërmjet anëtarëve dhe subjekteve të procedimit. Në lidhje me procedimet disiplinore të magistratëve, këtyre të fundit ju është dhënë mundësia që të dëgjojnë dhe të marrin pjesë në diskutime. Diskutim me rëndësi dhe intensiv ka qenë ai i procedimit disiplinor ndaj nën-kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj të cilës rënduan akuza për shkelje disiplinore për shkak të publikimit në median sociale “Tik Tok”, të videove që cenonjë parimet e etikës së magistratit⁸⁷. Pas referimit nga ILD, seanca ka vazhduar me pyetje-përgjigje të shumta nga ana e anëtarëve të Këshillit në drejtim të magistrates subjekt procedimi⁸⁸. Tërheq vëmendjen fakti se diskutimet e anëtarëve pas largimit të palëve⁸⁹ nuk janë të dëgjueshme nga publiku. Regjistrimi ndërpritet në momentin e përfundimit të marrjes në pyetje dhe rikthehet në momentin e dhënies së vendimit nga ana e KLGJ-së. Lidhur me procedurat e ndjekura nga

87 Mbajtur në seancën e datës 7 Qershor 2021

88 Vihet re se këto materiale (apo përmbledhje të tyre) nuk janë të aksesueshme nga publiku

89 Rreth kohës 01:14:00

KLJGJ për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, vihen re diskutime të shkurt-ra dhe pas përcaktimit të kandidaturave të paraqitura, Këshilli procedon me verifikimin e kriterëve ligjorë të kandidimit për ngritjen në detyrë⁹⁰. KLJGJ ka reflektuar një dakordësi pothuajse absolute lidhur me çështje të një natyre më të shpeshtë apo rutinë, si vendimet për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përjashtimin nga shorti elektronik të gjyqtarëve për arsye objektive etj.

B. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Përkundrejt KLJGJ-së, në rastin e KLP-së vihet re një nivel më i pranishëm debati, në një numër të konsiderueshëm mbledhjesh. Ashtu si në rastin e KLJGJ-së, shumica e diskutimeve lidhen me procedimet disiplinore të magjistratëve. Për ta ilustruar, vëzhguesit e KSHH-së raportojnë se në mbledhjen e datës 22 Qershor 2021, gjatë procedimit disiplinor ndaj prokurorit S.H, midis anëtarëve të KLP-së ka patur diskutim për rregullat e njoftimit të vendimeve të KLP –së në rastet kur subjekti i procedimit është në kushte izolimi, në përputhje me nenin 190 të ligjit nr. 96/2016. Elementë të ngjashëm janë vërejtur edhe në debatin që ka paraprirë vendimin për pezullimin e prokurorëve M.S dhe E.K.⁹¹ Gjithashtu, për çështje si transferimi i prokurorëve nëpërmjet lëvizjeve paralele, vëzhguesit e KSHH-së raportojnë se ka patur diskutime në Këshill, si rasti i mbledhjes së datës 9 Qershor 2021⁹². Debati në raste përjashtimore zhvillohet në të njëjtën kohë nga dy ose më shumë anëtarë, gjë që e bën të vështirë ndjekjen e bisedës nga ana e dëgjuesve të audios⁹³. Megjithatë këto raste nuk janë të shpeshta, dhe nuk zgjasin në kohë.

Nga ana tjetër, vërehet se miratimi i raporteve për aftësitë etiko-profesionale të subjekteve të rivlerësimit (magjistratëve prokurorë), në shumicën e rasteve është votuar pa shumë debate nga ana e anëtarëve.

Lidhur me procesin e votimit për efekt të vendimmarrjeve, vihet re që Kryetari i KLP-së konstaton dakordësinë e Këshillit (në rastin e dakordësisë unanime apo jo unanime), dhe anëtarët nuk shprehin secili në mënyrë të dëgjueshme në audio për dakordësinë e tyre. Kjo është një praktikë e ndryshme nga ajo e KLJGJ-së, e cila garanton transparencë të mirë karshi publikut pasi në çdo rast, edhe në atë të vendimmarrjes unanime pro apo kundër, anëtarët e KLJGJ-së shprehin personalisht për vendimmarrjen e tyre.

90 Për shembull në mbledhjen e datës 29.04.2021

91 Në mbledhjen e datës 7 Korrik 2021.

92 Në këtë mbledhje, një pjesë e anëtarëve ka diskutuar efektivitetin e hapjes së vendeve vakante për lëvizje paralele, duke qënë se ende ka magjistratë që nuk kanë dy vlerësime pune ende për t'u bërë pjesë e lëvizjeve paralele, çka do të sillte vakanca të theksuara sidomos në rrethet e largëta.

93 Për shembull, debati në seancën plenare të datës 16 Shkurt 2021, nga minuta 06.00 e në vijim.

1.3.3 Monitorimi i kuorumit dhe aspekteve të lidhura me premiset e korporatizimit, bazuar në ndasitë midis anëtarëve nga gjyqësori dhe jashtë gjyqësorit në vendimmarrjet e KLGJ-së

Referuar procesverbaleve ku pasqyrohen diskutimet e anëtarëve të pranishëm për mbledhjet e zhvilluara gjatë periudhës objekt monitorimi, vërehet se të gjitha vendimet janë marrë në unanimitet të plotë të këtyre anëtarëve, ndërkohë që në asnjë rast nuk është vërejtur që anëtarët të kenë disponuar me votë kundër apo mendime paralele. Në pamje të parë, mungesa e ndasive në vendimmarrje, midis anëtarëve nga gjyqësori dhe atyre jashtëgjyqësorit, nuk krijon premisa për vendimmarrje të natyrës korporatiste, pra të favorizimit apo mbrojtjes nga gjyqësori për gjyqësorin. Gjith, unanimiteti në vendimmarrje sërisht është një element i diskutueshëm i demokracisë së brendshme që krijon premisa të një status quo-je që nëse vijon në terma afatgjatë, mund të mbartë potencialin e kapjes “capture”.

Këto vendime, sikurse do të analizohet në vijim, kategorizohen në shumicën e tyre si akte administrative individuale ose kolektive, ndërkohë që një numër më të ulët janë aktet me natyrë rregullatore, të ndjekura nga aktet normative.

Në disa raste, sikurse do të ilustruhet më poshtë, janë vërejtur mungesa të anëtarëve në mbledhjet e zhvilluara, të cilat janë relatuar në mbledhje. Në shumicën e rasteve kur ka patur mungesa në anëtarë, vihet re që janë pak a shumë të njëjtët anëtarë. Në raste sporadike, mungesa e një ose më shumë anëtarëve në radhët e gjyqësorit, ka bërë që vendimmarrjet të merren në praninë e anëtarëve të tjerë të gjyqësorit, të cilët ose kanë qenë në numër të barabartë me pjesën tjetër të anëtarëve jo magjistratë, por janë vërejtur edhe raste kur kanë qenë në pakicë. Në këtë drejtim, vlen të veçohet mbledhja e dt. 29 Dhjetor, ku rezulton se janë marrë 6 vendime⁹⁴ me unanimitet ndërmjet 5 anëtarëve jomagjistratë dhe 3 anëtarëve magjistratë, në mungesë të 3 anëtarëve në radhët e gjyqësorit. Gjith, unanimiteti në vendimmarrjet e evidentuara në këtë seksion, pavarësisht diskutimit mbi elementët e demokracisë së brendshme, nga ana tjetër, nuk e ka cenuar epërsinë e numrit të anëtarëve gjyqtarë karshi atyre jo gjyqtarë⁹⁵.


1.3.3.1 Akte administrative individuale dhe kolektive

Procesi i monitorimit të vendimmarrjeve të KLGJ-së u shtri në dy periudha respektive. Përkatësisht gjatë periudhës së parë të monitorimit 01.12.2020

94 Vendimet nr. 348-354

95 Kjo për arsye se edhe nëse do të prezumohej prezenca e anëtarëve të munguar, vendimmarrjet janë marrë me një shumicë të tillë të cilat do të ishin sërisht të vlefshme edhe në këto raste.

– 18.04.2021, KLGJ ka marrë 208 vendime, të cilat kategorizohen si akte administrative kolektive dhe individuale. Numri më i lartë i vendimmarrjeve në kategorinë e akteve administrative kolektive dhe individuale konstatohet në muajt Dhjetor 2020 (54 vendime ose rreth 26%) dhe 1-18 Prill 2021 (33 vendime ose rreth 25%).



Nga monitorimi i realizuar gjatë muajit Dhjetor 2020, u konstatua se pothuajse në të gjitha mbledhjet e zhvilluara ka pasur mungesa të anëtarëve. Përkatësisht, në datën 01.12.2020 është konstatuar vendimmarrja e vetme e votuar unanimisht ndërmjet 5 anëtarëve jomagjistratë dhe 4 anëtarëve magjistratë⁹⁶, për shkak të mungesës së deklaruar së dy anëtarëve të tjerë. Gjithashtu, në mbledhjet e realizuara gjatë datave 04.12.2020⁹⁷, 10.12.2020⁹⁸ dhe 16.12.2020⁹⁹ është konstatuar se një prej anëtarëve në radhët e gjyqësorit nuk ka qenë

pjesëmarrëse, duke bërë që kuorumi i anëtarëve të pranishëm në mbledhje të cilët kanë miratuar me unanimitet pro vendimmarrjet e marra të përbëhet prej 5 anëtarësh magjistratë dhe 5 anëtarë jomagjistratë. Mbetet e paqartë zbardhja e procesverbalit të mbledhjes së datës 16.12.2020, gjatë shqyrtimit të vendimmarrjeve nr. 634 dhe 635, ku krahas konstatimit dhe reflektimit me unanimitet pro të votave të anëtarëve pjesëmarrës, vëzhguesit e KShH-së referojnë se për 2 anëtarët jomagjistratë, si dhe 1 anëtar magjistrat, në procesverbalin audio të publikuar në faqen zyrtare të KLGJ-së, ka pamundësi të dëgjimit të votës. Edhe në dispozitivin e vendimit, nuk është pasqyruar miratimi me unanimitet ose me shumicë të anëtarëve pjesëmarrës. **Kjo formë e publikimit të përmbledhjes së diskutimeve vlerësojmë se duhet të ishte administruar me dilijencën e duhur nga KLGJ¹⁰⁰.** Në mbledhjen e dt.23 Dhjetor rezultojnë të jenë marrë dhe dy vendimmarrje individuale¹⁰¹ dhe tre akte administrative kolektive¹⁰², ndërkohë që diskutimet gjatë shqyrtimit të të cilave nuk gjenden të publikuara në asnjë procesverbal të transkriptuar, pavarësisht regjistrimit audio i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare¹⁰³.Ky fakt **bie ndesh me nenin 69**

96 Vendim nr. 596, dt. 01.12.2020 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2020/12/VENDIM-Nr.-596-dat%C3%AB-01-12-2020-P%C3%8BR-CAKTIMIN-E-GJYOTAR%C3%8BVE-P%C3%8BR-GJYKIMIN-E-%C3%87%C3%8BSHTJEVE-GJYO%C3%8BSORE-T%C3%8BVE%C3%87ANTA-N%C3%8B-GJYKATA-T%C3%8B-TJERA-T%C3%8B-NDRYSHME-NGA-AJO-KU-USHTROJN%C3%8B-FUNKSIONET-N%C3%8B-M%C3%8BNYR%C3%8B-T%C3%8B-P%C3%8BRHERSHME.pdf>

97 Vendimet nr. 600-608

98 Vendimet nr. 609-633

99 Vendimet nr. 634-639

100 Në respektim të pikave 4), 5) dhe 6) të nenit 69 të ligjit nr. 115/2016, anëtarët vota e të cilëve nuk është kuptuar në mënyrën e qartë kanë gëzuar të drejtën për të kërkuar korrigjimin e procesverbalit brenda afatit 5 ditor dhe evidentimin e saktë të rezultatit të votimit.

101 Vendimet nr. 644 dhe 642 dt. 23.12.2020

102 Vendimet nr. 645, 646 dhe 647 dt. 23.12.2020

103 <http://klgj.al/regjistrimi-audio/>

pika 3) të ligjit nr. 115/2016, për shkak se mbledhja plenare pasardhëse e KLGJ-së rezulton të jetë mbajtur më datë 29.12.2020¹⁰⁴, por as procesverballi me përmbledhjen e diskutimeve të realizuara në këtë mbledhje nuk është transkriptuar dhe publikuar në faqen zyrtare të KLGJ-së¹⁰⁵.

Në muajin Janar 2021, vërejmë se KLGJ ka marrë vendime për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme në 35 seanca plenare. Një nga anëtarët magjistrate të KLGJ-së nuk ka marrë pjesë në diskutimin e çështjeve dhe shqyrtimin e vendimmarrjeve gjatë dy mbledhjeve të datave 21.01.2021¹⁰⁶ dhe 25.01.2021¹⁰⁷, duke bërë që këto vendimmarrje të miratohen me unanimitet nga 10 anëtarët e pranishëm, me përfaqësim të barabartë midis atyre që përfaqësojnë gjyqësorin dhe jashtë gjyqësorit.

Muaji Shkurt 2021 numëron 25 vendimmarrje të disponuara nga ana e KLGJ-së gjatë shqyrtimit të çështjeve të ndryshme në seanca plenare. Mbledhja e parë e muajit Shkurt 2021, e mbajtur më dt. 04.02.2021, në të cilën janë marrë 5 vendime¹⁰⁸ është zhvilluar me prezencën e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, ndërkohë që në vendimmarrjet e disponuara në mbledhjet vijuese është konstatuar mungesë e prezencës së anëtares jomagjistrate, në cilësinë e Kryetares së KLGJ-së. Mundësia e realizimit të mbledhjeve nëpërmjet video-konferencës ka ofruar fleksibilitet edhe për anëtarët që nuk kanë mundur të ndjekin mbledhjet fizikisht.

Në muajin Mars 2021 është vërejtur se KLGJ ka marrë 42 vendime. Dy mbledhjet e para dhe mbledhja e fundit nuk ka patur mungesa të anëtarëve të KLGJ-së, ndërkohë që mungesa të anëtarëve janë konstatuar në disa prej mbledhjeve vijuese. Për ta ilustruar me disa shembuj, në mbledhjen e datës 03.03.2021, në të cilën është disponuar me dy vendimmarrje¹⁰⁹ rezulton të mos kenë marrë pjesë një anëtare jomagjistrate dhe dy anëtarët magjistratë, duke zbritur kuorumin e vlefshëm të vendimmarrjes me 4 anëtarë jomagjistratë dhe 4 anëtarë magjistratë. Në procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura në datat 04.03.2021¹¹⁰, 05.03.2021¹¹¹, 09.03.2021¹¹², 11.03.2021¹¹³, 12.03.2021¹¹⁴, 17.03.2021¹¹⁵, 18.03.2021¹¹⁶, rezulton se anëtarja mag-

104 Njoftim për shtyp dt 29.12.2020 <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-29-dhjetor-2020/>

105 Nëpërmjet vendimit nr. 46, dt. 11.02.2021, KLGJ ka miratuar procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura në datat 23.12.2020 dhe 29.12.2020. <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/02/VENDIM-NR.-46-DAT%C3%8B-11.02.2021P%C3%8B-MIRATIMIN-E-PROCES-VERBALEVE-T%C3%8B-MBLEDHJEVE-T%C3%8B-K%C3%8B-BSHILLIT-T%C3%8B-LART%C3%8B-GJYQ%C3%8B-SOR-1.pdf>

106 Vendimet nr. 13-17

107 Vendimet nr. 18-32

108 Vendimet nr. 38, 39, 40, 41 dhe 42

109 Vendimet nr. 72 dhe 73 datë 03.03.2021

110 Vendimet nr. 74-78

111 Vendimet nr. 79

112 Vendimet nr. 80-83

113 Vendimet nr. 84-87

114 Vendimet nr. 88-91

115 Vendimet nr. 92-98


116 Vendimet nr. 99-103

jistrate nuk ka marrë pjesë për arsye objektive shëndetësore, duke bërë që kuorumi i anëtarëve që kanë votuar pro vendimmarrjet respektive të përbëhet nga 5 anëtarë magjistratë dhe 5 anëtarë jomagjistratë.


Gjatë periudhës 1 Prill 2021 - 18 Prill 2021, në faqen zyrtare të KLGJ-së u monitoruan 52 vendimmarrje. Në pjesën më të madhe të vendimmarrjeve konstatohet prezenca e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, por ka patur edhe përjashtime. Në mbledhjen e datës 02.04.2021 rezultoi se ka munguar anëtari magjistrat, ndërkohë që vendimet janë marrë me unanimitet ndërmjet 5 anëtarëve magjistratë dhe 5 anëtarëve jomagjistratë, prezentë në mbledhje. Mungesa e dy anëtarëve magjistratë si dhe kryetares së KLGJ-së në cilësinë e anëtares jomagjistratë gjatë mbledhjes së datës 08.04.2021, ka bërë që pesë vendime¹¹⁷ të miratohen unanimisht nga ana e 8 anëtarëve të KLGJ-së, konkretisht 4 anëtarëve magjistratë dhe 4 anëtarëve jomagjistratë.

Gjatë periudhës së dytë të monitorimit 19.04.2021 - 30.10.2021, KLGJ ka disponuar nëpërmjet 286 vendimmarrjeve, me anë të të cilave ka miratuar akte administrative individuale dhe kolektive. Sa i përket akteve administrative, vërejmë se KLGJ ka disponuar numrin më të lartë të vendimmarrjeve në muajt Shtator 2021 (53 vendime ose rreth 26.2%) dhe Tetor 2021 (50 vendime ose rreth 24.8%).

Nr. Vendimeve



117 Vendimet nr. 138-142



Nisur nga numri i vendimarrjeve, përgjatë kësaj periudhe, vërehet se KLGJ ka përmbushur detyrimin ligjor sipas nenit 66 të ligjit nr. 115/2016, për shkak se mbledhjet e realizuara brenda një harku kohor 1 muaj janë më tepër se 1 në muaj¹¹⁸. Gjithashtu, vërehet se numri më i lartë i vendimarrjeve i

korrespondon akteve administrative individuale, më konkretisht 202 vendime të dhëna, ndërkohë që 84 vendime konsistojnë në akte administrative kolektive.

Nga procesverbalet e verifikuara, për shkak se nga leximi i vendimarrjeve nuk reflektohet kuorumi i anëtarëve të pranishëm dhe mungesat respektive, konstatohet se të gjitha vendimarrjet objekt monitorimi janë disponuar në mënyrë unanime, pra me votën pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Të gjitha vendimarrjet rezultojnë të jenë marrë në përputhje me kuorumin e vlefshëm të anëtarëve të pranishëm, bazuar në nenin 68 pika 1 të ligjit nr. 115/2016.

Përgjatë periudhës 19-30 Prill 2021, KLGJ ka disponuar në mbledhjet plenare nëpërmjet 11 vendimarrjeve, duke miratuar 6 akte administrative kolektive dhe 5 akte administrative individuale. Gjatë kësaj periudhe konstatohet se vetëm në 2 mbledhje ka pasur mungesa të anëtarëve, përkatësisht zv/Kryetarit të KLGJ-së, në cilësinë e anëtarit jo magjistrat në mbledhjen e datës 22.04.2021¹¹⁹ ndërkohë në mbledhjen e datës 26.04.2021 vërehet se mbledhja është realizuar me prezencën e 8 anëtarëve, më konkretisht 4 anëtarëve jo magjistratë dhe 4 anëtarëve magjistratë.

Në muajin Maj 2021, KLGJ ka disponuar me 33 vendimarrje, duke miratuar 10 akte administrative kolektive dhe 23 akte administrative individuale. Shumica dërrmuese e vendimarrjeve janë marrë me kuorum të plotë anëtarësh, përkatësisht 6 anëtarë magjistratë dhe 5 anëtarë jomagjistratë, ndërkohë që vetëm në seancën plenare të datës rezultojnë të jetë relatuar mungesa objektive e anëtarës magjistratë, duke sjellë miratimin e vendimit nga 10 anëtarët prezent, 5 prej të cilëve anëtarë magjistratë dhe 5 anëtarë jomagjistratë¹²⁰.

118 Përjashtim vërehet vetëm në muajin Gusht 2021, ku rezultojnë se KLGJ të ketë realizuar vetëm mbledhjet e datave 04/08/2021 dhe 05/08/2021, në të cilat ka disponuar ndërmjet 1 vendimarrje kolektive "Për caktimin e një gjyqtari për shqyrtimin e çështjes nëpërmjet skemës së delegimit" dhe 3 vendimarrje individuale "Për caktimin e seancave dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj dy magjistratëve me detyrë gjyqtarë, përkatësisht në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Elbasan dhe Vlorë, si dhe "Mbarimin e statusit të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status".

119 Në këtë mbledhje u disponuan 4 vendimarrje, konkretisht vendimet nr. 168, 169, 170, 173. <http://klgj.al/akte-administrative-indivduale-2/>

120 Vendim nr. 221, dt. 28.05.2021 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/07/221-vendim-caktim-gjyqtari-delegime-28.05.2021-KL-GJ-1.pdf>

Gjatë muajit Qershor 2021, KLGJ ka miratuar 49 vendime, prej të cilave, 37 akte administrative individuale dhe 12 akte administrative kolektive. Edhe gjatë këtij muaji janë vërejtur mungesa të disa anëtarëve që nuk e kanë cenuar kuorumin për vlefshmërinë e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve. Për ta ilustruar me disa shembuj, në mbledhjen e datës 02.06.2021, rreth 9 vendime janë marrë në mungesë të anëtares jo magjistrate, njëkohësisht kryetares së KLGJ-së¹²¹. Gjithashtu, mungesa e Kryetares dhe 2 anëtarëve magjistratë, ka bërë që vendimarrja e datës 10.06.2021 të disponohet me unanimitetin e 4 anëtarëve magjistratë dhe 4 anëtarëve jomagjistratë¹²². Një numër i lartë vendimesh, përkatësisht 8, janë marrë në seancën plenare datë 17.06.2021¹²³, në prezencën e 10 anëtarëve, gjatë të cilës votuan pro tyre 5 anëtarë magjistratë, dhe 5 anëtarë jomagjistratë.

Gjatë muajit Korrik 2021, KLGJ ka disponuar me 58 vendimarrje, nga të cilat 2 vendime paraprake¹²⁴ dhe 1 projekt-vendim¹²⁵. Në pjesën më të madhe të seancave plenare të mbajtura gjatë këtij muaji vërehet mungesë e kryetares së KLGJ-së, përkatësisht në mbledhjen e datës 22.07.2021, në të cilën janë marrë 8 vendime¹²⁶, në unanimitet ndërmjet 4 anëtarëve jomagjistratë dhe 6 anëtarëve magjistratë. I njëjti konstatim vlen edhe për mbledhjet e datave 26.07.2021¹²⁷, 27.07.2021¹²⁸ dhe 28.07.2021¹²⁹. Në mbledhjen e datës 23.07.2021, konstatohet mungesa e Kryetares, një tjetër anëtar i jo magjistrat dhe anëtarit magjistrat¹³⁰, etj.

Në muajin Gusht 2021 që pjesërisht ka qenë edhe muaji i pushimeve vjetore të anëtarëve, janë zhvilluar 2 mbledhje përkatësisht në dt. 4 dhe 5 Gusht, në të cilat është disponuar me 4 vendime, 3 prej të cilave janë marrë në mungesë të një anëtareje magjistrate¹³¹.

Gjatë muajit Shtator 2021, në faqen zyrtare të KLGJ-së u verifikuan 69 vendimarrje. Në tre prej mbledhjeve ka patur mungesa. Mungesa e

121 Në këtë mbledhje janë marrë vendimet nr. 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 210

122 Vendim nr. 252, dt. 10.06.2021

123 Vendimet nr. 255, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262.

124 Vendim paraprak nr. 314, dt. 16.07.2021, <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/09/VENDIM-PARAPRAK-Nr-314-dat%C3%AB-16.07.2021-P%C3%8BR-PROPOZIMIN-P%C3%8BR-EM%C3%8BRIM-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-E-LART%C3%8B-N%C3%8B-POZICIONIN-E-LIR%C3%8B-N%C3%8B-FUSH%C3%8BN-E-T%C3%8B-DREJT%C3%8BS-ADMINISTRATIVET%C3%8B-SHPALLUR-ME-VENDIMIN-NR-245-DAT%C3%8B-09.07.pdf>

Vendim paraprak nr. 304, dt. 13.07.2021 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/07/VENDIM-PARAPRAK-Nr-304-dat%C3%AB-13.07.2021-P%C3%8BR-PROPOZIMIN-P%C3%8BR-EM%C3%8BRIM-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-E-LART%C3%8B-N%C3%8B-POZICIONIN-E-LIR%C3%8B-N%C3%8B-FUSH%C3%8BN-E-T%C3%8B-DREJT%C3%8BS-CIVILE.pdf>

125 Projektvendim nr. 322, dt. 22.07.2021, <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/09/PROJEKTVENDIM-Nr-dat%C3%AB-22.07.2021-P%C3%8BR-PROPOZIMIN-P%C3%8BR-EM%C3%8BRIM-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-E-LART%C3%8B-T%C3%8B-KANDIDATIT-Z-%E2%80%A6.pdf>

126 Vendime me nr. 317, 318, 320, 321, 315, 316, 319, 328

127 Vendim nr. 330

128 Vendimet nr. 331 dhe 332.

129 Vendimet nr. 333 dhe 334.


130 Në këtë mbledhje është marrë vendimi nr. 239

131 Vendimet nr. 338, 339, 341

anëtarëve magjistratë është vërejtur në mbledhjet e dt. 02.09.2021¹³² dhe 16.09.2021¹³³, duke bërë që vetëm 5 anëtarë magjistratë dhe 5 anëtarë jomagjistratë të jenë pro vendimmarrjeve të marra. Mungesa e kryetares në cilësinë e anëtares jomagjistrate dhe një anëtareje magjistrate është konstatuar në mbledhjen e datës 23.09.2021, dhe vendimmarrja është miratuar nga 4 anëtarë jomagjistratë dhe 5 anëtarë magjistratë.

Gjatë muajit Tetor, KLGJ ka disponuar me 62 vendimmarrje. Mungesa e 2 anëtarëve jomagjistratë, ka sjellë që 10 vendime¹³⁴ të marra në mbledhjen e datës 04.10.2021 të votohen pro nga 3 anëtarë jomagjistratë dhe 6 anëtarë magjistratë. Gjithashtu, mungesa e një anëtari jomagjistratë është relatuar edhe në mbledhjet e datave 05.10.2021 dhe në mbledhjen e datës 13.10.2021. Në këtë të fundit është relatuar edhe mungesa e një anëtareje magjistrate, duke bërë që kuorumi i anëtarëve të pranishëm që ka votuar pro 6 vendime¹³⁵ të kësaj séance plenare të përbehet nga 4 anëtarë jomagjistratë dhe 5 anëtarë magjistratë.

1.3.3.2 Aktet Normative



Në fazën e parë të monitorimit, 1 Dhjetor 2020 – 18 Prill 2021, KLGJ ka disponuar me vendimmarrje për një numër të kufizuar aktesh normative nënligjore, përkatësisht për 3 akte, 2 prej të cilave të miratuara në muajin Dhjetor 2020¹³⁶ dhe 1 i miratuar¹³⁷ në muajin Shkurt 2021.

Nëpërmjet akteve normative nënligjore të miratuara KLGJ miratoi udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave¹³⁸; rregullat standarde për organi gramën dhe përshkrimin e detyrave¹³⁹, si dhe rregullat për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor¹⁴⁰. Në mbledhjen e datës 11.02.2021 konstatojmë se udhëzuesi është miratuar me kuorumin e 4 anëtarëve jomagjistratë dhe 5

132 Në këtë mbledhje mungoi anëtari z. Bici, ndërkohë që vendimi i marrë është ai nr. 344

133 Në këtë mbledhje mungoi anëtarja znj. Ukperaj, ndërkohë që u morën vendimet nr. 345, 346, 347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356

134 Vendimet nr. 430, 431, 432, 433, 434, 436, 437, 438, 439, 440

135 Vendimet nr. 465, 469, 471, 472, 473, 474

136 Vendim nr. 622, dt. 10.12.2020 dhe nr. 643, dt. 23.12.2020

137 Vendim nr. 47, datë 11.02.2021 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/03/VENDIM-Nr.-47-dat%C3%AB-11.02.2021-P%C3%8BR-MIRATIMIN-E-%E2%80%9CCUDH%C3%8BZUESI-%E2%80%9CPE-C3%8BR-MBAJTJEN-DHE-PLOT%C3%8BSIMIN-E-TABELAVE-ME-T%C3%8B-DH%C3%8BNA-STATISTIKORE-P%C3%8BR-EFEKT-T%C3%8B-MATJES-DHE-MONITORIMIT-T%C3%8B-PRODUKTIVITETIT-DHE-EFI%C3%87ENC%C3%8BS-S%C3%8B-GJYKATAVE%E2%80%9D%E2%80%9D.pdf>

138 Vendim nr. 47, dt. 11.02.2021

139 Vendim nr. 643, dt. 23.12.2020


140 Vendim nr. 622, dt. 10.12.2020

anëtarëve magjistratë, në mungesë të kryetares së KLGJ-së dhe 1 anëtari magjistrat. **Procesverbali i diskutimeve të realizuara në mbledhjen e dt. 23.12.2020, gjatë të cilës është miratuar një prej akteve me vendimin nr.643 nuk është publikuar ende, duke e bërë të pamundur verifikimin e mënyrës së votimit nga ana e anëtarëve të pranishëm në mbledhje**¹⁴¹.

Gjatë fazës së dytë të periudhës objekt monitorimi, 19 Prill 2021 – 30 Tetor 2021, KLGJ ka disponuar me 10 vendime që kategorizohen si akte normative nënligjore, numri më i lartë i të cilave është miratuar në muajin Maj 2021.

Në muajin Prill 2021, KLGJ ka miratuar një nga aktet më të rëndësishme normative, Kodin e Etikës Gjyqësore. Në mbledhjen e dt. 22.04.2021, rezulton se vendimmarrja është miratuar në unanimitet nga 4 anëtarë jomagjistratë dhe 6 anëtarë magjistratë, në mungesë të zv/Kryetarit¹⁴².

Aktet normative të miratuara në muajt Maj dhe Korrik 2021 janë aprovuar nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhjet e datave 12.05.2021¹⁴³, 26.05.2021¹⁴⁴ dhe 01.07.2021¹⁴⁵. Gjatë Tetorit, KLGJ ka miratuar 3 akte nënligjore normative. Mbledhja e realizuar në datën 05.10.2021 është zhvilluar në prani të shumicës së anëtarëve, në mungesë të anëtarit jomagjistrat, duke bërë që 3 vendimmarrje të jenë marrë me votat pro të 4 anëtarëve jomagjistratë dhe 6 anëtarëve magjistratë¹⁴⁶.



1.3.3.3 Aktet Rregullatorë

Gjatë periudhës objekt monitorimi, KLGJ ka disponuar nëpërmjet 25 vendimmarrjeve, mbi rregullat e brendshme, të cilat konsistojnë në miratimin e kërkesave të ndryshme buxhetore, procesverbalet e mbledhjeve, pakësim apo shtim fondesh, raporte vjetore të sistemit gjyqësor si dhe ndryshime vendimesh. Këto vendimmarrje janë marrë me unanimitet të plotë ose të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, ose të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje, ndërkohë që në asnjë rast nuk është konstatuar citim i mendimit/opinionit në pakicë të anëtarit, vota e të cilit ka qenë kundër.

141 Njoftim për shtyp dt. 23.12.2020 <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-23-dhjetor-2020/>

142 Vendimi nr. 171, Datë 22.04.2021 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/04/VENDIM-NR.-171-DAT%C3%8B-22.04.2021-P%C3%8BR-MIRATIMIN-E-%E2%80%9CKODI-I-ETIK%C3%8BS-GJYQ%C3%8BSORE%E2%80%9D.pdf>

143 Vendimet nr. 193, 194, 195

144 Vendimet nr. 214 dhe 215

145 Vendim nr. 277 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/07/VENDIM-Nr.-277-dat%C3%AB-01.07.2021-P%C3%8BR-MIRATIMIN-E-FORMULARIT-N%C3%8B-ZBATIM-T%C3%8B-NENIT-IO-T%C3%8B-LIGJIT.pdf>


146 Vendimet nr. 441, 442 dhe 443

1.3.4 Monitorimi i kuorunit dhe aspekteve të lidhura me premisat e korporatizimit, bazuar në ndasitë midis anëtarëve nga prokuroria dhe jashtë prokurorisë, në vendimmarrjet e KLP-së

Në ndryshim nga KLGJ, në faqen zyrtare të KLP është e vështirë të evidentohej natyra e vendimmarrjeve të këtij institucioni, nëse janë akte administrative të natyrës kolektive, akte për miratimin e brendshëm të rregullave procedurale dhe udhëzime jodetyruese¹⁴⁷. Praktikrat e ndeshura për nënshkrimin e vendimeve të publikuara rezultojnë se janë të ndryshme, pasi janë vërejtur vendime për të cilat e drejta e firmës i është deleguar kryetarit dhe në mungesë të tij zv.kryetarit, ndërkohë që në disa vendime të tjera (sikurse do të përshkruhet në vijim), vërehen raste të mungesës së firmave, kryesisht nga një ose dy anëtarë. Në disa raste, këta anëtarë kanë munguar plotësisht ose pjesërisht për pika të caktuara të rendit të ditës, gjatë diskutimeve dhe vendimmarrjeve të realizuara në mbledhje. Arsytet e mungesës së tyre nuk janë dokumentuar në procesverbal.

Në ndryshim nga KLGJ, në vendimet e KLP-së vihen raste sporadike të vendimeve që nuk janë marrë me unanimitet. Në disa raste, vendimet janë firmosur edhe nga anëtarë që kanë votuar kundër, por në faqen zyrtare të KLP nuk është publikuar mendimi i tyre në pakicë. Është e paqartë nëse mendime apo opinione të tilla në pakicë janë hartuar ose jo nga anëtarët respektivë. Gjith, në tërësi, edhe për KLP vlen i njëjti konkluzion si për KLGJ-në, pasi në pamje të parë, nuk ka ndasi të ndjeshme në vendimmarrje, midis anëtarëve nga prokuroria dhe atyre jashtë prokurorisë, çka nuk krijon premisa për vendimmarrje të natyrës korporatiste, por nuk shmang nga ana tjetër në terma afatgjatë, premisa për status quo apo kapjeje “capture”.

Faza e parë e monitorimit të veprimtarisë vendimmarrëse së KLP-së u shtri në periudhën 01.12.2020-13.04.2021. Gjatë kësaj periudhe KLP mori 172 vendime, numri më i lartë i të cilave u disponua më dt. 29.12.2020, me 38 vendime, ndjekur nga mbledhja e dt. 27.01.2021, me 24 vendime.




Ndërkohë, gjatë periudhës së dytë të monitorimit 14.04.2021 – 18.11.2021, KLP ka disponuar nëpërmjet vendimmarrjeve në 268 raste, ku numrin më të lartë të ven-

147 Neni 189 i ligjit nr. 115/2016.

Rrjedhimisht, analiza e kryer në këtë seksion, nuk ndjek të njëjtën logjikë strukturore si në rastin e vendimmarrjeve të KLGJ-së

dimarrjeve e konstatojmë më dt. 27 Prill 2021, me 39 vendime, ndjekur nga mbledhja e dt. 23 Shtator 2021, ku janë marrë 33 vendime.



Nga vendimmarrjet objekt studimi vërehet se pjesa më e madhe e tyre janë marrë me unanimitet ndërmjet 11 anëtarëve të KLP-së, përkatësisht me nënshkrimin e 6 anëtarëve magjistratë dhe 5 anëtarëve jomagjistratë, ndërkohë që nga ky rregull janë vërejtur disa raste përjashtuese.

Gjatë kësaj periudhe, 38 vendimmarrje rezultojnë të nënshkuara nga ana e Kryetarit të KLP-së¹⁴⁸, bazuar në kompetencën ligjore që i është njohur në nenin 164 pika 8 të ligjit nr. 115/2016. Ndërkohë janë konstatuar edhe 14 vendimmarrje të nënshkuara vetëm nga zv/kryetari i KLP-së, 3 prej të cilave të marra në Janar 2021¹⁴⁹; 1 vendim i miratuar në Shkurt 2021¹⁵⁰ dhe 10 prej të cilave të disponuara në Maj 2021¹⁵¹. Vendimmarrja rezulton e marrë nga shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, më konkretisht 5 magjistratë dhe 5 jo magjistratë.

Mungesë të nënshkrimeve nga anëtari jomagjistrat z. Bazaj dhe anëtari magjistrat z. Staka është konstatuar në vendimmarrjet e datave 10.12.2020¹⁵² dhe 10.02.2021¹⁵³. Këta dy anëtarë rezultojnë se kanë nënshkruar kundër vendimmarrjen e disponuar në mbledhjen e datës 14.01.2021¹⁵⁴. Gjithashtu, anëtarja jomagjistrate znj. Seiti, ka nënshkruar kundër edhe dy vendimmarrje të disponuara në mbledhjen e datës 27.01.2021¹⁵⁵. Këto vendimmarrje janë miratuar nga shumica e përbërë prej 10 anëtarësh, prej të cilëve 4 anëtarë jomagjistratë dhe 6 anëtarë magjistratë.

148 Vendimet nr. 284, dt. 17.12.2020; nr. 294, dt. 17.12.2020; nr. 17, dt. 27.01.2021; nr. 38, dt. 02.02.2021; nr. 41, dt. 03.02.2021; nr. 58, dt. 12.03.2021; nr. 60, dt. 18.03.2021; nr. 67, dt. 26.03.2021; nr. 82, dt. 31.03.2021; nr. 150, dt. 27.04.2021; nr. 152, dt. 11.05.2021; nr. 157, dt. 18.05.2021; nr. 163, dt. 18.05.2021; nr. 170, dt. 25.05.2021; nr. 173, dt. 25.05.2021; nr. 183, dt. 03.06.2021; nr. 184, dt. 03.06.2021; nr. 185, dt. 03.06.2021; nr. 186, dt. 25.05.2021; nr. 187, dt. 25.05.2021; nr. 188, dt. 25.05.2021; nr. 189, dt. 25.05.2021; nr. 190, dt. 25.05.2021; nr. 191, dt. 25.05.2021; nr. 204, dt. 18.06.2021; nr. 207, dt. 18.06.2021; nr. 228, dt. 13.07.2021; nr. 241, dt. 13.07.2021; nr. 250, dt. 23.07.2021; nr. 255, dt. 23.07.2021; nr. 305, dt. 23.09.2021; nr. 319, dt. 04.10.2021; nr. 326, dt. 25.10.2021; nr. 327, dt. 25.10.2021; nr. 328, dt. 25.10.2021; nr. 329, dt. 25.10.2021; nr. 351, dt. 25.10.2021; nr. 352, dt. 25.10.2021.

149 Vendimet nr. 31, 32 dhe 33 dt. 27.01.2021

150 Vendim nr. 42, dt. 10.02.2021

151 Vendimet nr. 164 – 173 <https://klp.al/2021/05/27/vendime-date-25-05-2021/>

152 Vendim nr. 273, dt. 10.12.2020 <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/12/vendim-10.12.2020.pdf>

153 Vendim nr. 42, dt. 10.02.2021 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/02/vendim-nr-42.pdf>

154 Gjatë së cilës shqyrtohej ndërprerja e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së magjistrates kandidate për t'u komanduar inspektore pranë ILD-së. Shih vendimin nr. 8, dt. 14.01.2021 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/01/vendimi-nr-8.pdf>

155 Vendimet që konsistojnë në verifikimin e pasurisë dhe figurës së dy kandidatëve për t'u pranuar në programin fillestar të Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Shih Vendim nr. 32, dt. 27.01.2021 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/02/Vendim-nr-32-date-27.01.2021.pdf>

Shih Vendimin nr. 33, dt. 27.01.2021 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/02/Vendim-nr-33-date-27.01.2021.pdf>

10 vendimmarrjet e dt.16 Shkurt 2021, janë marrë në mungesë të një anëtareje magjistrate dhe një anëtareje magjistrate, por janë miratuar me unanimitet ndërmjet 4 anëtarëve jomagjistratë dhe 5 anëtarëve magjistratë, me përjashtim të njëres prej vendimmarrjeve në të cilën përveç anëtarëve të sipërcituar është konstatuar mungesë edhe e një anëtari tjetër magjistrat¹⁵⁶.

Ndër 51 vendimmarrjet e marra në muajin Mars 2021 janë konstatuar mungesë të herë pas hershme të anëtarëve, në disa prej mbledhjeve të seancave plenare, Mungesa e anëtarit magjistrat, përfaqësues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka bërë që 4 nga 5 vendimet e marra në seancën plenare të datës 12.03.2021¹⁵⁷ të nënshkruhen nga ana e 5 anëtarëve magjistratë dhe 5 anëtarët jo magjistratë, ndërkohë që njëri prej vendimmarrje në mungesë të nënshkrimit të anëtares jomagjistrate znj. Seiti¹⁵⁸.

Nënshkrim kundër i anëtares jomagjistrate, znj. Seiti është vërejtur edhe në vendimmarrjen e dt. 31.03.2021, gjatë së cilës është shqyrtuar caktimi i masës disiplinore ndaj prokurorit B.M¹⁵⁹. **Në faqen zyrtare të KLP-së nuk është publikuar opinioni në pakicë i kësaj anëtareje, çka bie ndesh me nenin 164 pika 9 e ligjit nr. 115/2016.** Është konstatuar gjithashtu mungesë e nënshkrimit nga kjo anëtare e 14 vendimeve të datës 13.07.2021¹⁶⁰, të cilat janë nënshkruar nga 6 anëtarë magjistratë dhe 4 anëtarë jomagjistratë.

Mungesë e nënshkrimit të anëtares magjistrate, znj. Keshi është vërejtur në 4 vendimet e marra në dt. 05.07.2021¹⁶¹, të cilat janë nënshkruar nga 5 anëtarë magjistratë dhe 5 anëtarë jomagjistratë, të pranishëm në mbledhje. Dy prej këtyre vendimeve kanë qenë për pezullimin nga detyra të dy prokurorëve, në zbatim të masave të sigurimit personal të dhënë ndaj tyre. Më dt. 23.07.2021, në 15 vendimet e miratuara nga KLP mungojnë nënshkrimet e 3 anëtarëve të KLP-së ndërkohë që ato janë marrë në unanimitet nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, 4 prej të cilëve magjistratë dhe 4 jo magjistratë.

Nga 33 vendimet e marra në seancën plenare të KLP-së datë 23.09.2021, konstatojmë se në 4 prej tyre konstatohet mungesë e nënshkrimit nga ana e anëtarit jomagjistrat Z. Sandër Beci, përfaqësues i trupës së pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës¹⁶². Këto vendimmarrje konsistojnë në verifikimin e pasurisë dhe figurës së 4 kandidatëve për t'u pranuar në programin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për periudhën 2021-2022. Gjithashtu, gjatë kësaj seance në njërin prej vendimmarrjeve, për shkak të mungesës së prezencës gjatë kohës së

156 Vendim nr. 47, dt. 16.02.2021 është miratuar nga 8 anëtarë, prej të cilëve 4 në radhët e prokurorisë dhe 4 të tjerë jo magjistrat.

157 Vendimet nr. 53-57, dt. 12.03.2021 <https://klp.al/2021/03/12/vendime-date-12-03-2021/>

158 Vendim nr. 54, dt. 12.03.2021

159 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/04/Vendimi%20perfundimtar%20Bujar%20Memia%20per%20publikim.pdf>

160 Vendimet nr. 228-241, dt. 13.07.2021 <https://klp.al/2021/07/14/vendime-date-13-07-2021/>

161 Vendimet nr. 224-227 dt. 05.07.2021 <https://klp.al/2021/07/08/vendime-date-05-07-2021/>

162 Vendimet nr. 292, 293, 294, 295 dt. 23.09.2021

shqyrtimit të çështjes, është konstatuar mos nënshkrim i vendimmarrjes nga 2 anëtarë magjistratë dhe anëtari jomagjistrat, kryetarit i KLP-së¹⁶³.

Mungesë e nënshkrimit nga ana e anëtarit jo magjistrat z. Sandër Beci, përfaqësues i trupës së pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës është konstatuar në 3 vendimmarrjet e datës 20.10.2021¹⁶⁴. Anëtarët prezentë në këtë mbledhje plenare kanë votuar pro këtyre vendimmarrjeve, më konkretisht konstatohet nënshkrimet e 6 anëtarëve magjistratë dhe 4 anëtarëve jomagjistratë.

Në 4 vendimmarrjet e miratuara në mbledhjen e dt. 03.11.2021 rezultoi se anëtarët prezentë në mbledhje, përkatësisht 6 anëtarët magjistratë dhe 4 anëtarët jo magjistratë janë dakordësuar në unanimitet dhe kanë nënshkruar vendimmarrjet¹⁶⁵. Ndërkohë në këtë seancë plenare vërehet mungesa e anëtares jo magjistrate znj. Seiti, përfaqësuese nga radhët e avokatëve. Gjithashtu, në njërin prej vendimmarrjeve vërehet mungesë e nënshkrimit nga ana e anëtarit magjistrat, përfaqësuesit të Prokurorisë së Përgjithshme z. Beluri¹⁶⁶.

Më dt. 17.11.2021, në dhomë këshillimi, KLP ka mbajtur seancën plenare në prani të ILD-së, me objekt shqyrtimin e kërkesës së këtij institucioni për procedimin disiplinor ndaj një magjistrati prokuror. Në përfundim të kësaj seance u vendos pranimi i kërkesës dhe caktimi i masës disiplinore “vërejtje publike”, për shkeljet disiplinore të parashikuara në nenin 102 pika 1 germa d) e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar. Vendimi është publikuar i anonimizuar dhe nuk përmban asnjë prej nënshkrimeve të anëtarëve pjesë e mbledhjes¹⁶⁷ **Sa i përket mungesës së evidentimit të nënshkrimeve në vendim, nga anëtarët prezentë, KShH vëren në analizë të nenit 190 të ligjit nr. 115/2016, se ligjvënësi nuk ka parashikuar dhe nuk ka pasur si qëllim që të evidentojë mundësinë e shtrirjes së anonimatit edhe për sa i përket elementit të nënshkrimit nga ana e anëtarëve të Këshillit.**

Seanca plenare e datës 16.11.2021 është përmbyllur me 15 vendimmarrje nga ana e anëtarëve prezentë të KLP-së, ku serish, në disa prej tyre vërehet mungesë e nënshkrimit nga ana e anëtarëve¹⁶⁸¹⁶⁹. Mungesë e prezencës dhe e nënshkrimit nga ana e anëtarit jo magjistrat, kryetar-

163 Vendim nr. 308, dt. 23.09.2021

164 Vendimet nr. 320, 321 dhe 322 dt. 20.10.2021 <https://klp.al/2021/10/20/vendime-date-20-10-2021/>

165 Vendimet nr. 353-365 dt. 03.11.2021 <https://klp.al/2021/11/04/vendime-date-03-11-2021/>

166 Vendim nr. 354, dt. 03.11.2021 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/11/vendim-nr-354-date-03.11.2021.pdf>

167 Procesverbali i kësaj seance pavarësisht se kanë kaluar 15 ditë nga data e shpalljes së dispozitivit të vendimit nuk rezultoi të jetë publikuar në faqen zyrtare të KLP. Bëhet fjalë për vendimin nr. 372, dt. 17.11.2021 i aksesueshëm në këtë link <https://klp.al/2021/11/17/vendim-date-17-11-2021/>

168 Në 7 vendime konstatohet mungesa e nënshkrimit të anëtarit magjistrat z. Staka, përfaqësues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, konkretisht vendimet nr. 357, 358, 359, 360, 361, 362, 363 dt. 16.11.2021 <https://klp.al/2021/11/18/vendime-date-16-11-2021/>

169 Në 4 vendime konstatohet mungesë prezence dhe nënshkrimi edhe nga ana e anëtarit magjistrat z. Sheshi. Ky anëtar i nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e disa çështjeve të rendit të ditës të mbledhjes që ka rezultuar me 11 vendimmarrje nga KLP, Vendimet nr. 360 – 370.

it të KLP-së është konstatuar në 6 prej këtyre vendimeve¹⁷⁰, ndërkohë që në 1 prej tyre rezulton e panënshkruar nga 2 anëtarë, përkatësisht anëtarja magjistrate znj. Keshi (Cami), përfaqësuese e Prokurorisë dhe anëtari jo magjistrat, përfaqësues i avokatëve z. Bazaj¹⁷¹.

Duke marrë shkas nga numri i rasteve të shqyrtimit të çështjeve të ndryshme, pjesë e rendit të ditës, në të cilat disa prej anëtarëve nuk kanë marrë pjesë gjatë shqyrtimit të tyre, por më pas janë rikthyer, KShH do të sugjeronte që drejtuesi i seancës plenare të relatojë në mbledhje arsyet e mungesave spontane të anëtarëve. Nga analiza e regjistrimeve audio dhe procesverbaleve të disa prej mbledhjeve, mbetet e paqartë arsyeja e mos prezencës dhe nëse lidhet me mosdakordësinë e tyre për çështje dhe vendime të caktuara. Debati në Këshill, kur janë reflektuar qëndrime të ndryshme, mbizotërohet nga narrativa e anëtarëve jo magjistratë.

Gjatë periudhës objekt monitorimi, KLP ka disponuar me vendimmarrje për Takt nënligjor, me të cilin miratohet Rregullorja për mënyrën e kompensimit për orët shtesë të punës të kryera nga nëpunësit civilë të prokurorisë¹⁷². Në dallim nga KLGJ, KLP ka publikuar aktet nënligjore nën seksionin legjislacion “Akte nënligjore KLP”.

170 Vendimet nr. 364, 365, 366, 367, 368, 370.

171 Vendim nr. 370 dt. 16.11.2021 <https://klp.al/ep-content/uploads/2021/11/Vendim-Nr.370-dt.-16.11.2021.pdf>

172 Vendim nr. 284, dt. 17.12.2020 <https://klp.al/ep-content/uploads/2020/12/284.pdf>

PJESA E DYTË

2.1 ADMINISTRIMI I DHJETË GJYKATAVE ME NGARKESËN MË TË LARTË NË VEND

KShH, në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së KLGJ-së dhe KLP-së, identifikoi nevojën për hartëzimin e 10 gjykatave me ngarkesën më të lartë në vend si dhe për të analizuar pjesërisht problematikat e krijuara në këto gjykata pas reformës në sistemin e drejtësisë, në termat e efijencës dhe menaxhimit të tyre të brendshëm.

Nga pikëpamja metodologjike, KShH, pasi mori informacionin nga KLGJ për 10 gjykatat me ngarkesën më të lartë, ju drejtua më pas këtyre gjykatave me kërkesa zyrtare për informacion.

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga këto gjykata nuk kanë qenë të plota, për shkak të mungesës së një sistemi të standartizuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Mgjth, KShH ka realizuar përpunimin e tyre, dhe më pas i ka analizuar konform legjislacionit në fuqi, duke synuar që gjetjet dhe rekomandimet e përcjella ti shërbejnë KLGJ-së, gjykatave por edhe studiuesve të fushës dhe mbi të gjitha publikut të gjerë.

10 gjykatat me ngarkesën më të lartë në vend përgjatë periudhës objekt monitorimi, rezultuan Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Shkodër (të juridiksionit të përgjithshëm), Gjykata Administrative e Apelit, Gjykatat e Shkallës së Parë Tiranë, Elbasan dhe Shkodër (të juridiksionit të përgjithshëm) dhe Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës.

2.1.1 Gjykata e Lartë e RSH¹⁷³

2.1.1.1 Vakancat dhe Stoku i dosjeve

Gjatë periudhës objekt monitorimi, Gjykata e Lartë ka patur në përbërje të trupës së saj 9 nga 19 gjyqtarë që duhet të ketë sipas strukturës së saj. Gjatë vitit 2021 u emëruan 6 gjyqtarë të rinj çka bëri të mundur që të formohen 9 trupa gjyqësore, me nga tre gjyqtarë secila, për të gjykuar sipas kolegjeve respektive. Mgjth, vlen të theksohet se gjatë katër muajve të parë të vitit që lamë pas (2021), Gjykata e Lartë ka funksionuar me 3 gjyqtarë, ndërkohë që në periudhën prill-shtator 2021 ka funksionuar me 7 gjyqtarë, Prej muajit shtator 2021 e në vijim, funksionimi i saj është bërë i mundur në kuadër të përfshirjes së 9 gjyqtarëve.

173 Të dhënat e pasqyruara në këtë seksion janë marrë pas komunikimeve zyrtare nga KShH konkretisht shkresa e Gjykatës së Lartë me nr. prot. 3724/1 datë 04.11.2021. Administruar pranë KShH me nr. prot. 751 datë 05.11.2021

Teksa në fund të vitit 2020 numri total i çështjeve në pritje për t'u gjykuar në Gjykatën e Lartë ka qenë 36,288 çështje¹⁷⁴, të dhënat e bëra publike nga vetë Gjykata e Lartë, gjatë vitit 2021 evidentojnë një ulje të stokut. Për vitin 2021, Gjykata e Lartë ka dhënë 3,609 vendime, duke sjellë një trend ulës të stokut të çështjeve pas shumë kohësh, ku ngarkesa në një vit, e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë, gjatë vitit 2021 ishte mbi 500 çështje¹⁷⁵. Pavarësisht se ritmet e evadimit kanë qenë shumë të mira, vlen të theksohet se numrit të mbetur të stokut të dosjeve të krijuar ndër vite, i shtohen edhe çështjet e reja që janë regjistruar gjatë vitit 2021, përkatësisht në masën 2,847 çështje të reja, duke bërë që numri total i çështjeve në pritje për t'u gjykuar nga kjo Gjykatë të shkojë në 35,837.



2.1.1.2 Njësia e Shërbimit Ligjor (NjShL)



Gjatë periudhës 2020 – 2021, në Gjykatën e Lartë janë emëruar gjithsej 11 këshilltarë ligjorë të rinj prej të cilëve 4 janë ndihmës magjistratë të komanduar dhe 7 janë këshilltarë ligjorë jo-magjistratë, të cilët kanë përfunduar formimin profesional në Shkollën e Magjistraturës. Sipas organikës të miratuar nga KLGJ, numri i këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor duhet të jetë 34, ndërkohë që kjo organikë rezulton e plotësuar vetëm me 1/3 e burimeve. KShH reko-

174 Raporti Vjetor i KLGJ-së për vitin 2020. Faqe 56. <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Vjetor-KLGJ-2020.pdf>

175 Të dhënat e mësipërme statistikore janë marrë nga komunikimi me median i Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë Z. Sokol Sadushi në datë 30.12.2021

mandon marrjen e masave të mëtejshme për plotësimin e kësaj organike, pasi kjo do të kontribuonte pozitivisht për mbështetjen e trupave gjyqësore në evadimin e çështjeve që janë në listë pritjeje.

2.1.1.3 Masat për rritjen e efikasitetit në këtë gjykatë

Referuar komunikimit zyrtar¹⁷⁶ rezulton se masat e marra nga Gjykata e Lartë dhe KLGJ-ja për rritjen e efikasitetit në këtë gjykatë kanë shkuar në të njëjtën linjë, duke mundur rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës së gjykatës, përmirësimin e proceseve të punës apo edhe rritjen e shpejtësisë së përcjelljes së informacionit gjyqësor. Gjykata e Lartë referon një bashkëpunim efektiv me KLGJ-në, në favor të identifikimit të zgjidhjeve për problematika të ndryshme me të cilat ajo është përballur. Kërkesat që i janë drejtuar KLGJ kanë konsistuar në domosdoshmërinë për shtim fondesh me qëllim realizimin e veprimtarisë së gjykatës dhe shtim i numrit të stafit administrativ. Vlen të theksohet se qëndrimi i KLGJ për këto kërkesa ka qenë mbështetës dhe miratues. Gjithashtu partneriteti në kuadër të zbatimit të projekteve të ndryshme mbështetur nga misionet e asistencës ndërkombëtare¹⁷⁷ ka mundur shtimin e kapaciteteve profesionale dhe organizative për përballimin e numrit të lartë të çështjeve që presin për gjykim.

Në mënyrë të veçantë, masat për përballimin e stokut të çështjeve mund të përmbliidhen në formë tabelore si vijon:

Masat me natyrë administrativo-organizative të marra nga Gjykata e Lartë për përshpejtimin e trajtimit të çështjeve			
Rritja e kapaciteteve profesionale të administratës	Përmirësimi i proceseve të punës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore	Përcjellja e shpejtë e informacionit gjyqësor	Rritja e transparencës me publikun

Masat e marra nga KLGJ për rritjen e efikasitetit së Gjykatës së Lartë		
Shtimi i numrit të stafit administrativ	Miratimi i marrëveshjes me Projektin “Drejtësi për të Gjithë” në Shqipëri	Komandimin e Gjyqtarëve nga gjykatat mw tw ulwta, për gjykimin e çështjeve të veçanta

176 Shkresë nr. 3724/1 prot., dt. 04.11.2021 “Kthim përgjigje” ndaj KSHH-së, adresuar nga Gjykata e Lartë

177 Miratimi i Marrëveshjes me Projektin “Drejtësi për të Gjithë” në Shqipëri, i financuar nga USAID

Impaktin më të rëndësishëm në menaxhimin efiçent të stokut të çështjeve e ka dhe do vijojë ta ketë, plotësimi organikës së kësaj Gjykate me gjyqtarë të tjerë, ku deri në fund të periudhës së monitorimit, është bërë plotësimi i saj me 9 gjyqtarë, të cilët, mbulojnë një volum të lartë të çështjeve gjyqësore.

Në datën 23 Mars 2021, Kuvendi i RSH miratoi ndër të tjerash, me ligjin nr.46/2021, disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”¹⁷⁸. Përmes ndryshimeve të propozuara rregullohen disa aspekte që kanë të bëjnë me organizimin, funksionimin, kompetencat e organizimin e brendshëm të gjykatave, si dhe parashikohet që sistemi i ndihmësve ligjor, të shtrihet edhe në gjykatat e shkallës së parë¹⁷⁹. Vlen të theksohet se lidhur me ndryshimin e këtij ligji dhe 9 ligjeve të tjera pjesë e paketës së reformës në drejtësi, u realizuan rreth 154 ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal, Kodet e Procedurës Penale dhe Civile, ligjet organike të Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë, ligjet për organizimin e sistemit gjyqësor dhe institucionet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kështu, me anë të ligjit nr.44/2021 të miratuar në të njëjtën datë, u realizuan disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të RSH, të cilat konsistonin ndër të tjerash në uljen e numrit të gjyqtarëve në trupat gjyqësore, për çështje civile të caktuara apo në gjykata të caktuara, sikurse është ajo e Apelit të përgjithshëm dhe Gjykata e Lartë¹⁸⁰. Pak a shumë në të njëjtën linjë, shkojnë edhe ndryshimet për uljen e numrit apo qartësimin e numrit të trupave të gjykimit për çështjet penale, të cilat u realizuan me anë të ligjit nr. 41/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”¹⁸¹.

Lidhur me këto ndryshime, 71 organizata të shoqërisë civile reagues duke shprehur shqetësimin se procesi i ndjekur për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre projektligjeve përbën një precedent negativ, pasi është realizuar me procedurë të përsheptuar dhe bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe Rregulloren e Kuvendit¹⁸². Gjithashtu, e gjithë procedura parlamentare e shqyrtimit të këtyre projekt ligjeve, është kryer në mungesë të transparencës me publikun dhe konsultimit me shoqërinë civile, si dhe në kushte urgjence, në më pak se 30 ditë nga depozitimi në Kuvend më 25 shkurt 2021¹⁸³.

178 <https://www.parlament.al/Files/Akte/20210326115714ligj%20nr.%2046,%20dt.%2023.3.2021.pdf>

179 https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/202103221647522021_%20Raporti%20i%20projektligjit%20per%20disa%20shtesa%20dhe%20ndryshimeve%20ne%20ligjin%20per%20org%20e%20pusht%20gjyq%20ne%20RSH_seance%20plenare.pdf

180 <https://www.parlament.al/Files/Akte/20210401122912ligj%20nr.%2044,%20dt.%2023.3.2021.pdf>

181 <https://qbz.gov.al/preview/b4819f4d-c246-49b3-87a9-2e6c8512c975>

182 Neni 83, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndalon zbatimin e procedurës së përsheptuar në shqyrtimin e projektligjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

183 <https://ahc.org.al/deklarate-per-media-kuvendi-miratton-ndryshime-te-rendesishme-te-reformes-ne-drejttesi-ne-mungese-te-nje-procesi-konsultimi-dhe-transparence/>

Por pavarësisht nga ky qëndrim, KShH do ti rekomandonte Gjykatës së Lartë, por edhe Gjykatave të tjera, veçanërisht atyre të Apelit, që të vlerësojnë në vijimësi, impaktin e rezultuar nga zbatimi i këtyre ndryshimeve nga hyrja në fuqi e tyre, në raport me rritjen e efikasitetit të veprimtarisë gjyqësore, përmirësimin e aksesit të publikut, thjeshtimin dhe përsheptimin e procedurave gjyqësore.

Vlen të theksohet gjithashtu se sipas qëndrimit të Gjykatës së Lartë, pavarësisht se ndryshimet e fundit ligjore kanë pasur një ndikim pozitiv në punën e saj, “nuk mund të përjashtohet mundësia për të bërë amendime të mëtejshme ligjore për këtë qëllim”. KShH vlerëson se gjykatat si pjesë e pushtetit gjyqësor, duhet të luajë një rol më pro aktiv dhe të mirë-koordinuar me njëra tjetrën (në varësi edhe të kompetencave të tyre lëndore), duke përcjellë propozime konkrete për ndryshime të kuadrit ligjor në fuqi, në funksion të përmirësimit të aksesit të publikut, si dhe rritjes së efikasitetit të veprimtarisë gjyqësore. Vlen gjithashtu të theksohet se në përputhje me nenin 93 të ligjit nr. 115/2016, KLGJ si organi qeverisës i pushtetit gjyqësor, mund të bashkërendojë këto iniciativa dhe të ushtrojë kompetencën për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin, që mund të ndikojnë në punën e gjyqësorit.

Gjithashtu, pavarësisht ritmeve shumë të mira të evadimit, referuar numrit të lartë të çështjeve në listën e pritjes për t'u gjykuar në fund të vitit 2021, në Gjykatën e Lartë, i sugjerojmë KLGJ-së të vijojë me ritme më dinamike procesin e ngritjes në detyrë në këtë gjykatë dhe po kështu edhe në Gjykatat e Apelit ku janë krijuar vakancat që vijnë nga promovimi i gjyqtarëve në nivel apeli në Gj.Lartë. Ngritja në detyrë, duhet vlerësuar me kujdesin e duhur nga KLGJ, me një qasje strategjike që të mos krijojë vakanca të konsiderueshme dhe bllokim të gjykatave më të larta, përfshi ato të Apelit.

2.1.1.4 Drejtësia pa Vonesa

Në legjislacionin tonë procedural civil janë përcaktuar në mënyrë eksplicite afatet e arsyeshme që duhet të përmbushen për përfundimin e hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të vendimit (referuar nenit 399/2 K.Pr.Civile). Nisur nga vakancat në Gjykatën e Lartë, stokun e dosjeve të trashëguar ndër vite por edhe vakancat e konsiderueshme në Njësinë e Shërbimit Ligjor evidentohet pamundësia objektive të kësaj gjykate për garantimin e respektimit të afateve të arsyeshme të gjykimit.

Gjykata e Lartë nënvizon në korrespondencën e saj me KShH-në se: “Respektimi i afateve të arsyeshme, të parashikuar në K.Pr. Civile, si një element i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, siç është interpretuar edhe nga GJEDNJ në jurisprudencën e saj, nuk është e mundur të garantohet në situatën aktuale në të cilën ndodhet Gjykata e Lartë”.

Bazuar në nenin 89 të ligjit nr. 115/2016, KShH vlerëson se KLGJ duhet vijojë me hapa të mëtejshëm, më pro-dinamikë, sa i përket menaxhimit gjyqësor, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë. Në kushtet e mbështetjes së ofruar nga Misionet Ndërkombëtare të Asistencës (siç është USAID), i sugjerojmë KLGJ-së hartimin e një dokumenti politik, shoqëruar me një plan konkret zbatimi që synon nxitjen dhe rekrutimin e sa më shumë juristëve të kualifikuar dhe me integritet, në rolin e ndihmësave ligjorë, të cilët do të kontribuonin në rritjen e ritmeve për uljen e numrit të çështjeve në pritje për t'u gjykuar.

Sa i përket kriterëve për marrjen në shqyrtim të dosjeve, rezulton se shqyrtimi i dosjeve në Gjykatën e Lartë bëhet sipas një rendi kronologjik duke marrë parasysh kohën e regjistrimit të tyre në gjykatë dhe në raste të veçanta, çështja gjykohet me procedurë të përsheptuar, sipas rregullimeve të parashikuara nga KLGJ, dhe sipas urdhrit të Kryetarit të Gjykatës, si një element i brendshëm rregullimi.

2.1.1.5 Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve

Sa i përket organizimit të brendshëm të Gjykatës së Lartë, vlen të evidentohet se mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë janë zhvilluar rregullisht duke diskutuar mbi mënyrën e ndarjes së gjyqtarëve në kolegje, e më pas këto qëndrime janë konsideruar edhe nga Këshilli i Gjykatës në vendime përkatëse.

2.1.2. Gjykatat e Apelit¹⁸⁴

Në këtë pjesë të raportit do të analizohet ngarkesa e katër gjykatave të apelit, prej të cilave 3 të juridiksionit të përgjithshëm, përkatësisht në Tiranë, Durrës dhe Shkodër, si dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

2.1.2.1. Vakancat dhe Stoku i Dosjeve (përfshi situatën gjatë pandemisë)

Procesi i vettingut, sikurse dihet ka patur efekteve pozitive në drejtim të pastrimit të sistemit gjyqësor, nga gjyqtarë dhe prokurorë të cilët janë gjetur me probleme, më së shumti me pasurinë, por edhe me integritetin dhe aftësitë e tyre profesionale. Megjithatë, si rezultat i këtij procesi janë krijuar vakanca të konsiderueshme, kryesisht në shkallët më të larta të sistemit gjyqësor në vendin tonë, përfshi ato të Apelit. Vlen të theksohet, këtyre vakancave ju shtohen edhe ato që kanë patur gjykatat para reformës në sistemin e drejtësisë, ndërkohë që përgjatë zbatimit të reformës, vakanca të tjera janë krijuar si rezultat i dorëheqjeve, daljes në pension, apo shkaqeve të tjera ligjore.

Sa i përket krijimit të vakancave nga procesi i vettingut, KShH ri konfirmon qëndrimin e shprehur në raportin e ndërmjetëm të monitorimit, se nevojitet një koordinim dhe bashkëpunim reciprok më i mirë midis Këshillave dhe organeve të vettingut.

Për shkak të pandemisë globale SARS Covid-19, më dt. 10.03.2020, KLGJ vendosi pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit deri më datë 22.04.2020. Duke mbajtur në konsideratë backlog-un në disa prej gjykatave të vendit, ky pezullim ndikoi pjesërisht në rritjen e stokut, vonesat në gjykimin e çështjeve dhe ngadalësimin e punës së gjykatave, i cili do të analizohet paralelisht për secilën gjykatë apeli përgjatë këtij seksioni¹⁸⁵. Mgjth, vlen të theksohet se vetëm Gjykata e Apelit Shkodër ka përcjellë të dhëna statistikore të përpunuara gjatë periudhës së përhapjes së pandemisë globale Covid-19. Marrja dhe analiza e të dhënave për stokun e dosjeve dhe efiçencën e gjykatave gjatë pandemisë, vlerësojmë se do t'i vinte në ndihmë bashkërendimit reciprok ndërmjet sistemit gjyqësor dhe KLGJ-së. Kjo e fundit, në përputhje me nenet 89 germa b) dhe 90 pika 2 të ligjit nr. 115/2016, do të kishte të mundur të monitoronte në mënyrë efikase dhe të mirë-menaxhonte ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave.


¹⁸⁴ Informacioni i përpunuar në këtë seksion është marrë në mënyrë zyrtare nga KShH nëpërmjet shkresave zyrtare, konkretisht. Shkresa e Gjykatës së Apelit Durrës administruar pranë KShH me nr. 780 datë 11.11.2021. Shkresa e Gjykatës e Apelit Shkodër administruar pranë KShH me nr. 756 datë 08.11.2021. Shkresa e Gjykatës e Apelit Tiranë administruar pranë KShH me nr. 794 datë 15.11.2021. Shkresa e Gjykatës Administrative e Apelit administruar pranë KShH me nr. 795 datë 16.11.2021.

¹⁸⁵ E cila përkon me periudhën kohore 10.03.2020 deri më 23.06.2020.

• Gjykata Administrative e Apelit

Gjykata Administrative e Apelit ka në organikën e saj të miratuar 13 gjyqtarë. Si rezultat i procesit të vettingut, gjatë periudhës objekt monitorimi, 6 gjyqtarë kanë kaluar vettingun me vendim të KPK, prej të cilëve, 4 disponojnë vendime të formës së prerë.


Nga kjo gjykatë nuk janë vendosur në dispozicion të KShH-së të dhëna për numrin e çështjeve të prapambetura përpara se vendi ynë të përballej me pandeminë globale Covid-19.



Gjatë vitit 2020, i cilësuar si viti i parë i pandemisë kjo Gjykatë ka disponuar me 1379 vendime, numër që është cilësuar nga vetë gjykata si “ndjeshëm më i ulët sesa vitet e tjera”¹⁸⁶. KShH vëren me shqetësim se gjatë periudhës objekt monitorimi, nga ana e trupës gjyqësore të kësaj Gjykate janë duke u gjykuar

çështjet e regjistruara 5 vite më parë, përkatësisht në vitin 2016.

• Gjykata e Apelit Tiranë (juridiksioni i përgjithshëm)



Gjykata e Apelit Tiranë ka në organikën e saj 31 gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave të referuara nga kjo Gjykatë të datës 29 shtator 2021, janë 6 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë¹⁸⁷. Teksa mesatarja e ponderuar e ngarkesës së punës në rang kombëtar e Gjykatave të Apelit është 217 çështje për gjyqtar¹⁸⁸, për këtë gjykatë, ngarkesa aktualisht është e jashtëzakonshme, me 160% më shumë, ose 3500 çështje për gjyqtar. Si rezultat i vettingut nuk janë konfirmuar në de-

tjërë 13 gjyqtarë nga të cilët 3 janë shkarkuar me vendim të formës së prerë, kanë kaluar procesin e vettingut 9 gjyqtarë, nga të cilët 3 janë ankimuar

¹⁸⁶ Shkresë nr. 438 prot., dt. 15.11.2021, “Kthim përgjigje” lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit

¹⁸⁷ Informacion i marrë nga Faqe 107. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>


¹⁸⁸ Informacion i marrë nga Faqe 107. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

në KPA dhe me dorëheqje janë larguar nga sistemi 6 gjyqtarë.

Në komunikimin me gjykatat e apelit, u vërejt mungesë e të dhënave statistikore lidhur me numrin e stokut të çështjeve të prapambetura gjatë periudhës së pandemisë nga Gjykata e Apelit Tiranë. Në këtë periudhë, kjo Gjykatë ka shqyrtuar rreth 109 çështje, 85 prej të cilave kanë qenë dosjet e masave të sigurimit. Edhe pse rreth 13.869 çështje janë të mbartura nga vitet e mëparshme, gjatë vitit të parë që etiketohet si viti i Pandemisë (janar – dhjetor 2020), janë gjykuar vetëm 1847 çështje, ndërkohë që në muajin nëntor 2021 rezulton se 18.814 çështje janë në shqyrtim. KSHH konstaton se disproporcionaliteti ndërmjet trendit të çështjeve që regjistrohen¹⁸⁹ dhe aktualisht në shqyrtim pranë kësaj Gjykate është i papërfillshëm në raport me çështjet e gjykuara.

• Gjykata e Apelit Durrës (juridiksioni i përgjithshëm)

Kjo Gjykatë ka në organikën e saj 13 gjyqtarë, ndërkohë që, sipas të dhënave deri më 29 shtator 2021, 5 gjyqtarë ushtrojnë funksionin efektivisht në këtë gjykatë, duke konstatuar vakanca të konsiderueshme përkatësisht në 8 gjyqtarë, të cilat nuk janë krijuar vetëm si rezultat i procesit të vettingut¹⁹⁰. Si rezultat i këtij procesi, 1 gjyqtar e ka kaluar këtë proces me vendim të formës së prerë, 1 gjyqtar është konfirmuar në detyrë me vendim të KPK dhe është në pritje të procesit në KPA, 2 gjyqtarë janë shkarkuar me vendim përfundimtar nga KPA, 4 gjyqtarë janë shkarkuar nga KPK dhe janë në pritje të vendimit nga KPA.




189 Nga data 1 Janar 2020 deri më Nëntor 2021, 6792 çështje të reja janë regjistruar në Gjykatë

190 Informacion i marrë nga Faqe 109. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

Gjykata e Apelit Durrës ka referuar se nuk ka regjistruar të dhëna statistike zyrtare sa i përket numrit të çështjeve të prapambetura, gjatë pezullimit të veprimtarisë gjyqësore në periudhën e pandemisë, ndërkohë në këtë periudhë ka shqyrtuar rreth 70 çështje.¹⁹¹

- **Gjykata e Apelit Shkodër (juridiksioni i përgjithshëm)**



Kjo Gjykatë ka në organikën e saj 10 gjyqtarë, ndërkohë që, sipas të dhënave të referuara, nga data 29 shtator 2021, 5 gjyqtarë ushtrojnë funksionin efektivisht në këtë gjykatë¹⁹². Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme për të justifikuar numrin minimal prej 10 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj¹⁹³ duke mbajtur parasysh se mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit. Si rezultat i zhvillimit të procesit të vetingut 1 gjyqtar është dorëhequr, 1 gjyqtar është deleguar me vendim të KLGJ-së, 1 gjyqtar është shkarkuar, 4 gjyqtarë janë të pezulluar dhe në proces vetingu, ndërsa 4 gjyqtarë kanë kaluar vettingun me vendim përfundimtar.

Nga të dhënat e përcjella nga Gjykata e Apelit Shkodër, rezulton se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, stoku i çështjeve të regjistruara dhe në pritje për gjykim pranë saj, kapi shifrën 1852 çështje. Mgjth, nuk përcaktohet qartazi nëse ky trend rritës i stokut është krijuar gjatë pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, apo edhe pas kësaj date.

¹⁹¹ Shkresë nr. 4/1 prot., dt. 09.11.2021 "Dërgim informacioni dhe dokumentacioni" lëshuar nga Gjykata e Apelit Durrës

¹⁹² Informacion i marrë nga Faqe 115. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

¹⁹³ Informacion i marrë nga Faqe 116. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

2.1.2.2 Njësitë e Shërbimit Ligjor (NJSHL)

• Gjykata e Apelit Administrativ

Kjo gjykatë referon se pranë saj nuk është krijuar ende NJSHL-ja. Në zbatim të ligjit nr. 49/2012 dhe në përputhje me nenin 165 të ligjit nr. 96/2016, pranë kësaj gjykate janë emëruar 8 ndihmës ligjorë nga 13 të tillë që duhet të ushtrjnë funksionin sipas organikës së miratuar për këtë institucion. Ndërkohë, afro 1/3 e ndihmësve ose 5 prej tyre janë larguar nga pozicioni me dorëheqje. Pranë kësaj gjykate nuk është emëruar asnjë ndihmës ligjor gjatë periudhës 2020-2021. Duke qenë se ndihmësit ligjorë luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin e përgatitjes së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes, vlerësojmë se KLGJ duhet të kishte marrë masat e nevojshme për ngritjen e kësaj njësie, e cila është në kompetencën e saj¹⁹⁴.

• Gjykata e Apelit Tiranë (juridiksioni i përgjithshëm)

Në ndryshim nga Gjykata e Apelit Administrativ, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se është krijuar NJSHL-ja, në nëntor të vitit 2020. Gjatë periudhës 2020-2021 pranë kësaj gjykate janë emëruar në mënyrë të përkohshme 10 ndihmës ligjorë, ndërkohë që në organikën prej 15 ndihmësish të miratuar nga KLGJ, 5 vende janë vakante. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke qenë se ndihmësi ligjor ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me gjyqtarin për përgatitjen e relacionit në lidhje me çështjen e ngarkuar nga gjyqtari, pritet një rritje e performancës së tyre¹⁹⁵. Mbështetur në parashikimin ligjor të nenit 52 pika 2 e ligjit 98/2016, rezulton se është Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me KLGJ, Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat dhe institucione të tjera, që kryejnë formimin fillestar dhe vazhdues të kancelarëve, këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësve të tjerë ligjorë.

• Gjykata e Apelit Durrës (juridiksioni i përgjithshëm)

Gjithashtu, pranë kësaj Gjykate është ngritur NjShL, e cila, sipas organikës së miratuar nga KLGJ në dt. 21.10.2020 duhet të jetë e plotësuar me 6 ndihmës ligjorë. Gjatë muajit Dhjetor të vitit 2020 pranë kësaj Gjykate janë emëruar 3 ndihmës ligjorë, ndërkohë që në muajin Mars 2021 është miratuar nga ana e KLGJ-së shtimi në organikë me 1 (një) ndihmës ligjorë.

¹⁹⁴ Neni 42 pika 1 i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"


¹⁹⁵ Referuar nenit 42 pika 10 të ligjit 98/2016, KLGJ krahas miratimit të rregullave të detajuara mbi kushtet dhe kriteret profesionale që duhet të përmbushin ndihmësit ligjorë në gjykatat e apelit, cakton edhe llojin dhe natyrën e detyrave të tyre, llojin dhe natyrën e çështjeve për t'u përpunuar dhe përgatitur nga ata, si dhe vlerëson rregullisht ngarkesën e punës së ndihmësve ligjorë.

• Gjykata e Apelit Shkodër (juridiksioni i përgjithshëm)

Edhe pse NjShL është ngritur pranë kësaj gjykate, me një organikë të përbërë nga 5 punonjës (3 ndihmës + 2 këshilltarë ligjorë), aktualisht pranë saj ushtron funksionin vetëm 1 ndihmës ligjor¹⁹⁶. Kjo situatë e reflektuar me shqetësim edhe nga ana e Gjykatës, nuk ofron kushte optimale pune për trupat gjyquese dhe ndikon negativisht në raport me përgatitjen për shqyrtimin e çështjeve në mënyrë cilësore dhe brenda afateve të arsyeshme kundrejt publikut.

Sa më sipër, duke mbajtur parasysh organikën e NjShL të miratuar nga KLGJ¹⁹⁷ për të tre Gjykatat e Apelit, rezulton një numër prej 22 ndihmësish ligjorë të atashuar pranë tyre, nga 34 që duhet të kishin, pra me 12 vakanca ose afro 1/3 e vendeve totale për këtë pozicion. Duke u mbështetur në kompetencat ligjore që ka KLGJ, vlerësojmë se ky institucion duhet të kishte qenë prioritet plotësimin e këtyre vakancave, me fokus të veçantë ato me ngarkesën më të madhe të çështjeve nën shqyrtim. Plotësimi i vakancave për pozicionin e ndihmësve ligjorë, shtimi i numrit të tyre si dhe rritja e efikasitetit, vijnë si rekomandime të vetë gjykatave që do të kontribuonin pozitivisht në uljen e ngarkesës me të cilën po përballen gjyqtarët në detyrë në këto gjykata. Gjithashtu, KSHH sugjeron përkrahjen e masave bashkërenduese të institucioneve përgjegjëse si KLGJ, Shkolla e Magjistraturës dhe Ministria e Drejtësisë për rritjen e efikasitetit të ndihmësve ligjorë, nëpërmjet përfshirjes së tyre në trajnime periodike dhe vazhduese.


Raporti midis organikës së miratuar dhe situatës konkrete për Ndhmësit Ligjorë në Gjykatat e Apelit



¹⁹⁶ Shkresë nr. 2016/1 prot., dt. 04.11.2021 "Kthim përgjigje kërkesës për informacion" drejtuar nga Gjykata e Apelit Durrës

¹⁹⁷ Vendim nr. 495, dt. 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor

2.1.2.3 Drejtësia pa vonesa



Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit, janë organet e pushtetit gjyqësor, të cilat për shkak të ngarkesës dhe numrit të vakancave, e reflektojnë të pamundur respektimin e afatit të arsyeshëm ligjor për gjykimin e çështjeve. Nga ana tjetër Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Durrës rezultojnë eficiente në shqyrtimin e çështjeve dhe dhënien e vendimeve brenda afateve ligjore.

• Gjykata Administrative e Apelit

Kjo gjykatë ka referuar se përcaktimi i çështjeve për gjykim bëhet nga gjyqtari relator në bazë të parashikimeve të nenit 49 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Gjatë periudhës në fjalë, kjo gjykatë po shqyrtonte çështjet gjyqësore të regjistruara pranë saj në vitin 2016, të cilat janë në numër të vogël, drejt përfundimit. Amendimet e miratuara me ligjin nr.46/2021 në ligjin nr. 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor pavarësisht se kanë synuar krijimin e mekanizmave lehtësues për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore¹⁹⁸, kjo Gjykatë referon se nuk ka përpunuar të dhëna analitike lidhur me impaktin e tyre në përsheptimin e shqyrtimit të dosjeve. Një faktor ndikues në këtë situatë referohet se është edhe periudha e shkurtër kohore nga momenti i hyrjes në fuqi të amendimeve.

• Gjykata e Apelit Tiranë (juridiksioni i përgjithshëm)

Me përjashtim të çështjeve penale emergjente, masave të sigurimit, apo çështjeve gjyqësore me afat, kjo gjykatë referon se është gjyqtari relator që ka diskrecionin për realizimin e planifikimit për shqyrtimin e dosjeve gjyqësore. Aktualisht pranë kësaj Gjykate janë duke u shqyrtuar në masë çështjet e vitit 2017. Një ndër kriteret e marra në konsideratë në këtë planifikim, është data e regjistrimit të çështjes në gjykatë. Për shkak të volumit të lartë të çështjeve në shqyrtim, një tregues ky disproporcional në raport me numrin e ulët të gjyqtarëve që aktualisht ushtrojnë funksionin në sistem, është shndërruar në pamundësi garantimi i shqyrtimit të çështjeve brenda afateve ligjore, duke krijuar premisa për cënim të procesit të rregullt ligjor¹⁹⁹.

198 Me anë të trupave gjykes të përbërë nga një gjyqtar, ose me trup gjykes të përbërë nga tre gjyqtare, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

199 Garanci ligjore e parashikuar në nenin 399/2 K.Pr.Civile

- **Gjykatat e Apelit Durrës (juridiksioni i përgjithshëm)**

Kjo gjykatë ka shqyrtuar çështje civile të viteve 2018, 2020, 2021 dhe çështje penale të viteve 2019, 2020, 2021. Gjykata referon se ligji nr.46/2021, ka lehtësuar procesin e menaxhimit të çështjeve të mbartura pranë saj. Mgjth, fakti që kjo gjykatë vijon të shqyrtojë çështje të rreth 3-4 viteve më parë, krijon pasoja ndaj palëve ndërgjyqëse sa i takon drejtësisë pa vonesa dhe të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor.

- **Gjykata e Apelit Shkodër (juridiksioni i përgjithshëm)**

Kjo gjykatë, pavarësisht vakancave të referuara në pozicionin e ndihmësve ligjorë, sekretarëve dhe nëpunësve ligjorë, referon se ka mirë-menaxhuar sistemin e brendshëm të referimit të çështjeve, duke i dhënë prioritet çështjeve penale që lidhen me paraburgimin e masat e sigurimit personal, dhunën në familje, urdhërat e menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe çështjet civile mbi pensionet, përfshirë dhe ato që kanë të përcaktuar afate prekluzive parashkrimi kanë prioritet. Referuar përcaktimit kohor të nenit 399/2 K.Pr.Civ., në këtë Gjykatë aktualisht po shqyrtohet stoku i çështjeve të mbartura në vitin 2020, si dhe ato të vitit 2021.


Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë afatet kohore të përcaktuara në nenin 399/2 K.Pr.Civile, në mbështetje të nenit 94, pika 4, germa “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 115/2016, KShH i sugjeron KLGJ-së të marrë masa për monitorimin sistematik të zbatimit të tyre, me qëllim identifikimin edhe të masave me karakter zhblokues, në bashkërendim dhe konsultim intensiv me vetë gjykatat në fjalë, për ato raste kur shqyrtimi i çështjeve i tejkalon afatet ligjore të parashikuara në legjislacionin procedural. Ky do të ishte edhe një reagim konkret ndaj gjetjeve të bëra nga vetë KLGJ në Raportin Vjetor 2020²⁰⁰ në të cilin theksohet se “gjyqtarët e Gjykatës së Lartë rezultojnë se kanë rendiment më të lartë se kolegët e tyre në gjykatat e apelit e po ashtu i njëjti konstatim vlen edhe për gjykatat e shkallëve të para të cilat kanë më tepër efikasitet në gjykimin e çështjeve krahasuar me gjykatat e apelit”.

2.1.2.4. Masat e tjera për rritjen e efikasitetit në këto Gjykata

Si masa të tjera për rritjen e efikasitetit së gjykatave të apelit, vlerësohen gjithashtu investimet dhe përmirësimet në infrastrukturë, trajnimet vazhduese të magjistratëve, plotësimi i vakancave të stafit të nëpunësve gjyqësor, trajnimet me ta, administrimi gjyqësor i sistemit të arkivës dhe modet standarde elektronike për draftimin e vendimeve.

200 Për më tepër shiko Raporti Vjetor KLGJ 2020. Faqe 59 <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/06/Raporti-Vjetor-KLGJ-2020.pdf>

Infrastruktura



Sipas vlerësimeve të CEPEJ në nivel evropian, infrastruktura është një element i rëndësishëm për garantimin e vijueshmërisë së punës dhe funksionalitetit të Gjykatës, por dhe ofrimin të mundësisë për komunikim ndërmjet ofruesve të shërbimeve gjyqësore dhe qytetarëve, si aksesues e përfitues të drejtpërdrejtë. Të dhënat e administruara nga Gjykatat e Apelit objekt monitorimi, evidentojnë se vetëm 1 prej këtyre gjykatave ka patur përmirësime infrastrukturore. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë referon se nuk ka pasur nevojë të kërkojë nga KLGJ fonde për rikonstruksion

godine, për shkak se godina funksionale e kësaj gjykate është restauruar rreth 3 vite më parë²⁰¹. Mungesë të nevojës për përmirësime infrastrukturore ka përcjellë edhe Gjykata e Apelit Tiranë. Nga informacionet e bëra publike nëpërmjet Hartës së Re Gjyqësore, rezultojnë se ndërtesa e Gjykatës së Apelit Tiranë ka 28 zyra gjyqarësh dhe 19 zyra të administratës, si dhe 7 salla gjyqi. Grupi i punës i ngritur nga KLGJ, ka vlerësuar se numri i sallave të gjyqit nuk është i mjaftueshëm për të përballuar ngarkesën e punës që kjo gjykatë ka. Sa i përket ndërtesës së Gjykatës së Apelit Durrës ajo ka 13 zyra gjyqarësh dhe 5 zyra të administratës, si dhe 4 salla gjyqi, krahasuar me ndërtesën e Gjykatës së Apelit Shkodër e cila ka 9 zyra gjyqarësh dhe 11 zyra të administratës, si dhe 5 salla gjyqi²⁰². Në drejtim të infrastrukturës, kjo gjykatë referon se godina e saj është e ndërtuar pas realizimit të një procedure prokurimi publik, me fondet e KLGJ-së, si dhe përmbush të gjitha domosdoshmëritë për një shërbim gjyqësor cilësor ndaj qytetarëve. Gjykata e Apelit Durrës rezultojnë e vetmja instancë ndër gjykatat e monitoruara, e cila ka përfituar fonde për të përmirësuar infrastrukturën e saj²⁰³.

Prej vitit 2014²⁰⁴, Këshilli i Ministrave ka miratuar ngritjen e arkivit shtetëror të sistemit gjyqësor, por ky vendim, si rrjedhojë e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore në kuadër të reformës në drejtësi u shfuqizua, po me vendim të Këshillit të Ministrave, të vitit 2019²⁰⁵. Nga përgjigjet e dhëna nga disa prej gjykatave, është e paqartë se kur është ngritur arkivi shtetëror i sistemit gjyqësor pranë tyre, cilat kanë qenë nevojat dhe si është përshtatur ky arkiv

201 Gjykata Administrative e Apelit, në Korrik të vitit 2018, nisi funksionimin e saj në një godinë të restauruar dhe përshtatur për nevojat e gjykatës.

202 Informacion i marrë nga Faqe107, 110,117. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

203 Për shkak të tërmetit të Nëntorit 2019, godina e këtij institucioni pësoi dëmtime të rëndësishme ç'ka pamundësuan vijimin e aktivitetit të gjykatës në ato kushte. Në përgjigje të kësaj situatë, me vendim të KLGJ-së u bë e mundur zhvendosja e veprimtarisë së kësaj gjykate, në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë. Në Korrik të vitit 2020 kjo gjykatë u rikthye në funksionalitet të plotë, për ofrimin e shërbimeve gjyqësore.


204 VKM nr. 903, datë 17.12.2014 "Për krijimin e arkivit shtetëror të sistemit gjyqësor".

205 VKM nr. 888, dt. 31.12.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e arkivit shtetëror të sistemit gjyqësor"

me kërkesat e vendimit të vitit 2019 të Këshillit të Ministrave (konstatim që vlen më së shumti për Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm).

Trajnimi i personelit të shërbimit civil gjyqësor dhe ndihmësve ligjorë

- Gjykatat ku janë zhvilluar normalisht trajnimet
- Gjykatat ku nuk janë zhvilluar normalisht trajnimet, ose nuk janë për gjithë stafin



Bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 96/2016, magjistratët kanë të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në programin e formimit vazhdues që realizohen Shkolla e Magjistraturës. Gjykatat e Apelit nuk kanë statistika rreth pjesëmarrësve së magjistratëve (gjyqtarëve) në këto trajnime, duke u justifikuar me faktin se këto cikle të trajnimeve realizohen nga Shkolla e Magjistraturës. Pavarësisht kompetencës së drejtpërdrejtë të Shkollës lidhur formimin vazhdues të magjistratëve në detyrë, të avokatëve të shtetit në detyrë dhe ndihmësve ligjorë e kancelarëve që punojnë në gjykata

dhe prokurori, KSHH vlerëson se bashkëpunimi ndërmjet Gjykatave dhe Shkollës së Magjistraturës duhet të forcohet në kontekstin e periodicitetit dhe angazhimit dypalësh për të analizuar të dhëna statistikore dhe cilësore lidhur me pjesëmarrjen e magjistratëve dhe shërbimit civil gjyqësor civil në aktivitete të ndryshme të cilat kanë në fokus rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre. Sa i takon trajnimeve të personelit të shërbimit civil gjyqësor dhe ndihmësve ligjorë, të dhënat reflektojnë një numër relativisht të ulët trajnimesh të zhvilluara me ta, të cilat, mund të kontribuonin pozitivisht në drejtim të efijencës.

Nga informacioni i përcjellë nga Gjykatat e Apelit rezulton se prej tyre nuk respektohet ndonjë format standard dhe i unifikuar për draftimin e vendimmarrjeve gjyqësore. Vetë Gjykata e Apelit Tiranë krahas referimit të mungesës së përdorimit të këtyre modeleve standarde, bën me dije se “gjyqtarët janë të mendimit që nëse do i përdornin këto modele standarde do të kishte evadim më të lartë të numrit të çështjeve gjyqësore të gjykuara”²⁰⁶.

• Gjykata Administrative e Apelit

Si një ndër Gjykatat me ngarkesën më të lartë të stokut në vendin tonë, kjo gjykatë i është drejtuar KLGJ-së me kërkesa për marrjen e masave në kuadër të plotësimin të vendeve vakante, në lidhje me punonjësit e shërbimit civil gjyqësor, për të cilat procedurat e rekrutimit hapen nga ana e Këshillit të Gjykatës²⁰⁷. Gjithashtu, referohet se kancelari dhe ndihmësit ligjorë janë përfshirë në programin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës,

206 Shkresë nr. 5206/1 prot., dt. 15.11.2021 “Kthim përgjigje” e Gjykatës së Apelit Tiranë

207 Gjatë periudhës 2020-2021, më konkretisht më dt. 12.11.2021, pranë kësaj gjykate është punësuar vetëm një punonjës me procedurën e lëvizjes paralele.

ndërsa pranë KLGJ po kryejnë trajnimin aktualisht disa sekretarë gjyqësorë, Krye sekretarja dhe Kryetarja e degës së buxhetit.

Kjo gjykatë, referon se qysh në fillimet e saj ka ngritur sistemin e arkivimit gjyqësor, në të cilin ruhen vendimet e dhëna prej saj, regjistrat themeltarë të krijuar ndër vite, procedurat e prokurimit, si dhe dosjet gjyqësore të cilat kjo gjykatë i gjykon si gjykatë e shkallës së parë.

• Gjkata e Apelit Tiranë (juridiksioni i zakonshëm)

Sipas të dhënave të kësaj gjykate nuk rezulton të jenë adresuar kërkesa drejt KLGJ-së, në raport me vakancat e konstatuara në shërbimin civil²⁰⁸. Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa trajnime për kancelarin, ndihmësit ligjorë dhe nëpunësit civilë gjyqësorë. Në lidhje me këta të fundit, gjykata i është drejtuar me kërkesa KLGJ-së dhe Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë marrë në konsideratë.

Kjo gjykatë referon se në muajin Tetor 2021 ka ngritur Komisionin e Ekspertizës për Arkivën Gjyqësore²⁰⁹. Funkcionaliteti dhe roli i Komisionit të Ekspertizës në secilën Gjykatë është përcaktuar nëpërmjet Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor” të miratuar nga Ministri i Drejtësisë²¹⁰. Megjithatë, ngritja e këtij Komisioni nuk nënkupton ngritjen e sistemit të arkivimit gjyqësor, për shkak se Komisioni ka si funksion vetëm shqyrtimin dhe përcaktimin e vlerës së ruajtjes së dokumenteve që prodhohen, ruhen e administrohen në rrjetin arkivor të sistemit gjyqësor.

• Gjkata e Apelit Durrës (juridiksioni i zakonshëm)

Mungesë e adresimit të kërkesave sa i përket vakancave dhe vështirësive të hasura nga ana e shërbimit civil, konstatohet edhe në raport me Gjykatën e Apelit Durrës²¹¹. Kjo gjykatë referon se kancelari, ndihmësit ligjorë dhe nëpunësit civilë i janë nënshtruar një sërë trajnimesh periodike të realizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

208 Sa i përket lëvizjeve paralele në këtë shërbim ka pasur 1 lëvizje paralele në pozicionin e kryetares së degës së buxhetit, ndërsa në vitin 2021 janë regjistruar 6 lëvizje paralele në pozicionin e sekretarit gjyqësor.

209 Vendim i Këshillit të Gjykatës dt. 15.10.2021, e cila nuk rezulton të jetë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë: <http://ëëë.gjkata.gov.al/apel-tiranë/C3%AB/gjkata-e-apelit-tiranë/C3%AB/mbledhja-e-kë/C3%ABshillit-të/C3%AB-gjykatë/C3%ABs/>

210 Miratuar nëpërmjet Urdhërit nr. 4643/1 prot., dt. 31.01.2017 i Ministrisë të Drejtësisë: <http://ashsgi.gov.al/ëp-content/uploads/2018/05/Urdhë/C3%ABr-Nr.-4643-1-datë/C3%AB-31.01.2017-Pë/C3%ABr-Miratimin-e-Rregullores-së/C3%AB-Brendshme-%E2%80%9CPë/C3%ABr-Organizimin-dhe-Funksionimin-e-Arkivit-Shtetë/C3%ABror-të/C3%AB-Sistemit-Gjyqë/C3%AB-sorë/E2%80%9D.pdf>

211 Në mars të vitit 2021 me lëvizje paralele ka përfunduar procedura e rekrutimit për 1 nëpunës në pozicionin ekzekutiv si sekretar gjyqësor dhe në muajin Tetor 2021 është pranuar në shërbimin civil gjyqësor 1 punonjës në kategorinë ekzekutive specialist të teknologjisë dhe informacionit.

• Gjykata e Apelit Shkodër (juridiksioni i zakonshëm)

Gjatë periudhës 2020-2021 rezulton se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka pasur asnjë procedurë të pranimit në shërbimin civil, por vetëm lëvizje paralele të nëpunësve në funksionin e sekretares gjyqësore. Kancelari i kësaj gjykate është përfshirë në mënyrë periodike në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë trajnimet për ndihmësit ligjorë dhe nëpunësit e shërbimit civil gjyqësor nuk janë realizuar.

2.1.2.5 Bashkëpunimi i Gjykatave të Apelit me KLGJ-në

Gjatë monitorimit i është kushtuar vëmendje e veçantë bashkëpunimit ndërmjet gjykatave objekt i monitorimit dhe institucionit përgjegjës për qeverisjen e sistemit gjyqësor, KLGJ-së.



Gjykatat e Apelit referojnë se i janë drejtuar në mënyrë periodike KLGJ-së lidhur me transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve²¹², ose delegimin e gjyqtarëve²¹³ nëpërmjet skemave të ngritur nga KLGJ. Këto kërkesa pas trajtimit nga ana e KLGJ-së, rezulton se në disa raste janë vlerësuar pozitivisht, duke tejkaluar pengesat e krijuara si shkak i vakancave, ose kushteve të papajtueshmërisë së gjyqtarëve aktualisht në funksion në çështje të caktuara. Mgjth ka patur edhe raste sikurse është kërkesa e adresuar KLGJ-së nga

Gjykata e Apelit Tiranë, në muajin Shkurt 2021, me anë të së cilës kërkohej delegimi i gjyqtarëve për nevoja të gjykimit në dy trupat gjyqësore, për një periudhë 6 mujore/1 vjeçare. Për këtë kërkesë, KLGJ nuk ka disponuar me vendimarrje brenda afateve ligjore dhe më tej, as gjatë periudhës objekt monitorimi prej KSHH-së²¹⁴.

Pavarësisht se Gjykata e Apelit Shkodër e ka konsideruar në parim, si lehtësues procesin bashkëpunues të ofruar nga KLGJ mbi problematika të ndryshme, në informacionin zyrtar nuk jep të dhëna konkrete mbi kërkesat më të shpeshta që i janë adresuar KLGJ-së²¹⁵.

212 Gjykata e Apelit Durrës, nëpërmjet shkresës nr. 4/1 prot., dt. 09.11.2021 "Dërgim informacioni dhe dokumentacioni"

213 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 438 prot., dt. 15.11.2021 "Kthim përgjigje" Gjykata e Apelit Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 5206/1 prot., dt. 15.11.2021 "Kthim përgjigje"


214 Shkresë nr. 5206/1 prot., dt. 15.11.2021 "Kthim përgjigje", e Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë shkresë, vetë Gjykata e Apelit Tiranë citon shkresën nr. 860 prot datë 17.02.2021.

Referuar nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, kryetari i gjykatës ose i drejtuesi i prokurorisë ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit (KLP ose KLGJ) caktimin për një çështje ose për një periudhë të caktuar të magjistratit nga skema e delegimit në gjykatën ose prokurorinë përkatëse, duke paraqitur arsyet e nevojës për caktimin e magjistratit dhe të periudhës kohore të kërkuar. Bazuar në pikën 7 të po kësaj dispozite, Këshilli vlerëson kërkesën brenda 3 ditëve nga marrja e saj, si dhe vendos mbi pranueshmërinë e kësaj kërkesë duke sjellë si pasojë caktimin e magjistratit nëpërmjet skemës së delegimit.

215 Shkresë nr. 2016/1 prot., dt. 04.11.2021 "Kthim përgjigje kërkesë për informacion"

2.1.2.6 Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, mbledhja e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve, duhet të zhvillohet të paktën një herë në muaj, me regjistrim audio dhe diskutimet e zhvilluara të transkriptohen e të zbardhen në një procesverbal. Rëndësia e ruajtjes së këtij procesverbali për 10 vite dhe vënia në dispozicion gjyqtarëve të gjykatës, anëtarëve të KLGJ-së dhe ILD-së është e parashikuar nga neni 29 pika 2 e ligjit nr. 98/2016.



Nga të dhënat zyrtare të vëna në dispozicion nga ana e Gjykatave të Apelit konstatohet se mbledhjet nuk zhvillohen rregullisht dhe në mënyrë periodike, ndërkohë që në disa raste është i pamundur verifikimi online i mbajtjes së këtyre mbledhjeve, për shkak të mos publikimit të procesverbaleve të transkriptuara e të zbardhura të diskutimeve të mbledhjeve.

Konkretisht, KShH vëren se pranë

Gjykatës së Apelit Durrës mbledhjet e gjyqtarëve nuk janë mbajtur rregullisht. Për tre vite me radhë, ato janë mbajtur vetëm 2 nga 36 herë që duhet sipas ligjit, përkatësisht në janar të vitit 2019 dhe shtator të vitit 2021²¹⁶. Në Gjykatën e Apelit Tiranë evidentohet se për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve, mbledhjet e gjyqtarëve zhvillohen shpesh për problematika të ndryshme, por jo të formalizuara. Nga ana tjetër, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër konfirmojnë se mbledhjet i mbajnë rregullisht 1 herë në muaj, ndërkohë që kjo e fundit referon se dokumentimi i mbledhjeve realizohet vetëm me regjistrim audio. KShH vëren se mos dërgimi i informacionit konkret nga ana e tyre konkretisht regjistrimit audio nëpërmjet CD dhe procesverbalin e mbledhjes së anonimizuar të zbardhur, të cilët vërtetojnë realizimin e mbledhjeve të përgjithshme të gjyqtarëve, bie në kundërshtim me garancinë e parashikuar në nenin 29 pika 2 të ligjit nr. 98/2016.

2.1.3. Gjykatat e Shkallës së Parë

Në këtë pjesë të raportit do të analizohet ngarkesa e pesë gjykatave të shkallës së parë, prej të cilave 3 të juridiksionit të përgjithshëm, përkatësisht në Tiranë, Durrës dhe Elbasan, si dhe 2 gjykatat administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Durrës.

216 Urdhër nr. 3, dt. 08.01.2019 "Për thirrjen e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës për zgjedhjen e zëvendëskryetarit"

Urdhër nr. 85, dt. 28.09.2021, "Për thirrjen e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës për zgjedhjen e zëvendëskryetarit"

2.1.3.1. Vakancat dhe Stoku i Dosjeve (përfshi situatën gjatë pandemisë)

Vakancat në radhët e gjyqtarëve, si dhe stoku i konsiderueshëm i çështjeve mbeten tregues shqetësues, të cilat dobësojnë efikasitetin gjyqësor dhe nevojën për të dhënë drejtësi pa vonesa, edhe në 5 gjykatat e shkallës së parë, të kategorizuara me ngarkesën më të lartë sipas KLGJ-së. Pavarësisht se efekti i këtij procesi nuk është ndjerë me të njëjtën peshë si në gjykatat e nivelit më të lartë (për shkak të rendit të fillimit të tij dhe subjekteve prioritare), serish, për aq sa ky proces është shtrirë pranë këtyre gjykatave, vakancat kanë qenë prezentë. Ashtu si për gjykatat e apelit, vlen të theksohet, se këtyre vakancave ju shtohen edhe ato që kanë patur gjykatat para reformës në sistemin e drejtësisë, ndërkohë që përgjatë zbatimit të reformës, vakanca të tjera janë krijuar si rezultat i dorëheqjeve, daljes në pension, apo shkaqeve të tjera ligjore. Në një pjesë të këtyre gjykatave, grupi i punës së ngritur nga KLGJ ka vlerësuar se numri i gjyqtarëve në organikë duhet të jetë më i lartë, për t'ju përgjigjur efektivisht ngarkesës dhe ritmit të shqyrtimit të çështjeve.


Sa i përket emërimeve të reja, në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër, ka patur dy të tilla gjatë vitit 2020-2021, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka patur vetëm një emërim gjatë vitit 2021, ndërsa në tre gjykatat e tjera, nuk rezultojnë të jenë emëruar magjistratë të rinj. Pavarësisht masave të marra nga Shkolla e Magjistraturës për miratimin e kuotave të shtuara, në kuadër të zbatimit të legjislacionit të reformës në drejtësi, KSHH konstaton se ky mekanizëm nuk po i shërben plotësisht reduktimit të ndjeshëm të vakancave të magjistratëve. Në respektim të nenit 85 pika 1 të ligjit nr. 115/2016 dhe nenit 29 të ligjit nr. 96/2016, nëse vërehet se procesi i kandidimit të juristëve për formim fillestar të hapur nga Shkolla e Magjistraturës, nuk siguron zgjidhje optimale dhe afatshkurtër në plotësimin e vakancave të krijuara në sistemin gjyqësor, KLGJ duhet të marrë seriozisht në vlerësim nevojën për studimin e hapësirave të tjera për plotësimin e këtyre vakancave, duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme të cilat mund të formulohen edhe si opinione për ndryshime në kuadrin ligjor në fuqi.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë gjatë kësaj periudhe ka patur 2 lëvizje paralele të gjyqtarëve. Në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, rezultojnë se një prej gjyqtarëve është transferuar me lëvizje paralele në GJKK.

Në raportin vjetor të vitit 2020 të KLGJ, evidentohet se për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, "koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) është rritur me 47.6 ditë"²¹⁷. Ndërsa në rastet e Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë konstatohet se

217 Faqe 95, raporti_vjetor_klgj_2020_6578.pdf (gjykataelarte.gov.al)

Viti 2020 - 2021



krahas rritjes së backlog në masën 24% krahasuar me vitin 2019, koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) është rritur nga 119 ditë që ishte në vitin 2019 në 163 ditë në 2020²¹⁸. Referuar nenit 94 të Ligjit 115/2016

pika 4 germa “a”, “b” dhe “c” KLGJ ka mundësinë të përcaktojë afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, përfshirë, kur është e mundur, edhe afatet për fazat kryesore të procedurës, por edhe veprimet standarde që duhet të ndërmerren në rastet kur shqyrtimi i çështjeve i tejkalon afatet²¹⁹. KShH ka konstatuar se KLGJ nuk ka miratuar asnjë akt normativ për vënien në jetë të kësaj dispozite.

Ndryshimet ligjore të miratuara nëpërmjet ligjit nr. 46/2021 të cilat propozuan disa zgjidhje të natyrës zhblllokuese, për uljen e numrit të gjyqtarëve në trupat gjykues për shqyrtimin e çështjeve, me synim garantimin e efikasitetit në dhënien e drejtësisë, nuk rezultojnë të kenë sjellë ndryshime të ndjeshme në gjykatat e shkallës së parë me ngarkesën më të lartë, objekt i këtij monitorimi. Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës, referojnë se nuk kanë zbatuar këto parashikime, pasi përbërja e trupave gjykues për këto instance përcaktohet nga ligji i posaçëm për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative nr. 49/2012.

Sa më sipër dhe referuar të dhënave që do të analizohen në vijimësi të këtij seksioni, KShH vlerëson se vakancat e krijuara në këto gjykata dhe pamundësia e tyre për të garantuar dhënien e drejtësisë brenda afateve të arsyeshme ligjore, duhet të ndikojë në prioritizimin e çështjeve nga KLGJ. Gjithashtu, KShH vendos theksin tek nevoja e grumbullimit të të dhënave statistikore dhe hartimit të analizave cilësore e statistikore bazuar në to, një kompetencë e parashikuar në nenet 89 germa b) dhe 90, pika 2 të ligjit nr. 115/2016, që do të shërbente si një pikënisje pozitive e hartimit të strategjive në terma afatgjatë dhe afatshkurtër, për adresimin e problematikave, menaxhimin e risqeve dhe evadimin me ritme të shtuara të stokut të krijuar.


218 Faqe 104, raporti_vjetor_klgj_2020_6578.pdf (gjykataelarte.gov.al)

219 Kjo do të shërbejë si një bazë e mirë rregullatore, për gjykimin brenda afateve të arsyeshme. Një element i tillë nëse organizohet në mënyrë cilësore gjithashtu mund të ndikojë edhe në performancën e gjyqtarëve në sistem.

• Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Procesi i vettingut dhe vakancat në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë


- Ndërruar jetë
- Shkarkuar nga KLGJ
- Shkarkuar me vendim të KPK
- Shkarkuar me vendim të KPA
- Dorëhequr
- Komanduar pranë institucioneve të tjera



Kjo është gjykata e identifikuar me ngarkesën më të lartë në vend, në raport me gjykatat e tjera të të njëjtit juridiksion. Në organikën e saj duhet të kishte në funksion 75 gjyqtarë. Aktualisht pranë kësaj gjykate ushtrojnë funksionin afro 60% e tyre, rreth 44 gjyqtarë, ose 32 gjyqtarë më pak. Sipas vlerësimit të KLGJ, kjo gjykatë ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 68 pozicione gjyqtarësh²²⁰, për të bërë të mundur shqyrtimin e çështjeve. Vakancat në përbërjen e trupës gjyqësore të kësaj gjykate vijnë për arsye të ndryshme, si: 27% janë shkarkuar me vendim të formës së prerë nga

organet e vettingut, 23 % janë dorëhequr, 23% kanë ndërruar jetë, 2% janë shkarkuar nga KLGJ, dhe 9% janë komanduar pranë institucioneve të tjera të drejtësisë. Konkretisht nga procesi i vettingut rezulton se 12 gjyqtarë janë shkarkuar me vendimmarrje të KPK-së, 16 gjyqtarë janë shkarkuar me vendim të shkallës së dytë të vettingut (KPA-së).

Gj.Shkallës së Parë Tiranë
Çështjet e mbartura




Gjatë vitit kalendarik 2020, që prej Marsit përkoi edhe me përhapjen e pandemisë globale, në dhomën civile të kësaj gjykate janë mbartur 6149 çështje dhe në dhomën penale 949 çështje. Për vitin 2021, në dhomën civile rezultojnë 9574 dosje të mbartura dhe në dhomën penale 940 çështje. Të dhënat reflektojnë situatë

shqetësuese të stokut të dosjeve në seksionin civil. Nga analiza e realizuar nga vetë kjo gjykatë, faktorët ndikues në këtë ngarkesë të konsiderueshme raportohen pezullimi i veprimtarisë së gjykatave gjatë përhapjes së pandemisë globale Covid-19, vendimmarrjet e organeve të vettingut që kanë sjellë shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe dorëheqjet e vetë gjyqtarëve.

Referuar të dhënave statistikore të përcjella zyrtarisht pranë KShH-së nga kjo gjykatë, rezulton se, sa i përket çështjeve civile, 5990 prej tyre janë për-

220 Të dhënat për numrin optimal të gjyqtarëve që duhet të kishte kjo gjykatë janë referuar nga Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. Faqe 33. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8B-SORE-.pdf>

funduar për një periudhë kohore mbi 6-muaj. Nëse i referohemi çështjeve penale periudha mesatare e përfundimit të tyre është 2-6 muaj për 911 çështje, ndërsa periudha nga 6 muaj në 1 vit i korrespondon vetëm 221 çështjeve.




Referuar të dhënave të mësipërme, KSHH vëren se kjo Gjykatë funksionon në kushte sakrifikuuese, ndërkohë që KLGJ është munduar që në mënyrë periodike të plotësojë kërkesat e Gjykatës për shtesë në organikën e personelit administrativ të gjykatës.

• Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan


Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ushtrojnë funksionin 6 gjyqtarë, të cilët janë në proces vettingu. Nga periudha e zbatimit të reformës në drejtësi rezulton se 6 gjyqtarë që kanë ushtruar më parë, funksionin pranë kësaj gjykate janë pezulluar/shkarkuar për shkak të vendimmarrjes së vettingut, ose procesi ndaj tyre është ndërprerë për shkak të dhënies së dorëheqjes.

Nisur nga analiza e realizuar nga grupi i punës në kuadër të Hartës së Re Gjyqësore, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka një ngarkesë pune

të mjaftueshme për të justifikuar 20 pozicione gjyqtarësh pranë kësaj gjykate, duke mbajtur parasysh se mesatarja në rang kombëtar e ngarkesës së punës në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020 ishte 429 çështje për gjyqtar. Në organikën e planifikuar pranë kësaj gjykate duhet të ushtronin funksionin 14 gjyqtarë, ndërkohë që vetëm 6 prej tyre ushtrojnë efektivisht funksionin. Kjo gjykatë referon një trend rritës të stokut të dosjeve për periudhën 2019 – 2021, ku një ndër faktorët kryesorë ndikues është edhe numri i reduktuar i magjistratëve gjyqtarë, përkatësisht 6 prej tyre.



Gj.Rrethit Gjyqësor Elbasan




Sa i takon situatës së krijuar për shkak të pandemisë, kjo gjykatë referon se vendimi i KLGJ-së për pezullimin e veprimtarisë së gjykatave, nuk ka dobësuar apo vonuar shqyrtimin e çështjeve gjyqësore. Në ndryshim nga gjykatat e tjera, pranë kësaj gjykate janë krijuar salla të gjykimeve online të cilat ndihmuan në respektimin e afateve dhe procedurave gjyqësore duke mundësuar gjykime brenda afateve të arsyeshme,

për çështje të konsideruara të ngutshme sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, referohet se çështjet gjyqësore shqyrtohen nga trupa e gjyqtarëve, brenda afateve ligjore.

• Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Gj.Rrethit Gjyqësor Shkodër

- Gjyqtarë të shkarkuar me vendim të formës së prerë të KPA
- Gjyqtarë të cilët janë shkarkuar me vendim të K.P.K
- Gjyqtarë që kanë kaluar vettingun




Organika e kësaj gjykate parashikon 14 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 11 gjyqtarë që ushtrojnë detyrën pranë saj²²¹. Pavarësisht nga gjendja aktuale, Gjykata vlerësohet se ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 17 pozicione gjyqtarësh²²². Për shkak të vettingut, rezulton se,

Kryetari i Gjykatës është shkarkuar me vendim të formës së prerë nga KPA, 2 gjyqtarë të tjerë janë shkarkuar me vendim të KPK-së, vendimmarrje këto të ankimuara, ndërkohë që procesin e vettingut e kanë kaluar me sukses vetëm 2 gjyqtarë.

KShH konstaton se në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër, stoku i çështjeve përgjatë viteve 2019 – 2021 ka një trend zbritës.

Gj. Rrethit Gjyqësor Shkodër




Kategoria	2019	2020	2021
Çështje të regjistruara të reja + mbartje	7886	6865	5746
Çështje të Gjykuara	6678	5671	4658
Çështje në Shqyrtim	1208	1194	1088
Gjyqtari	12	14	13

221 Statistika të marra nga Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. Faqe 92. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

222 Statistika të marra nga Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. Faqe 93. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

Gj.Rr.Gjyqësor Shkodër Statistikat e Vitit 2020



Referuar të dhënave statistikore të kësaj gjykate për vitin 2020, që përkoi me fillimin e periudhës vërehet se për 49 çështje penale dhe 10 çështje civile, afati i gjykimeve e ka tejkaluar standardin minimum procedural të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

• Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

GJAD Tiranë (Vakancat)




- Kaluar vetingun me vendim të formës së prerë
- Kaluar vetingun me vendim të KPP
- Shkarkuar me vendim të KPP
- Gjyqtarë për të cilët ende nuk është marrë vendim

Organika e kësaj gjykate parashikon 16 pozicione gjyqtarësh²²³. Nga 16 gjyqtarë të parashikuar në organikën e kësaj gjykate, deri tani 2 gjyqtarë kanë kaluar me sukses vetingun me vendim të formës së prerë, 1 gjyqtar e ka kaluar procesin e vetingut me vendim të KPK-së si dhe një gjyqtar tjetër është shkarkuar me vendim të KPK-së. Gjykata, duke u referuar tek numri mesatar i çështjeve për një gjyqtar ka ngarkesë pune të mjaftueshme

për të justifikuar 18 gjyqtarë²²⁴. Kjo gjykatë referon një trend zbritës të stokut të çështjeve përgjatë viteve 2019 – 2021, por prej saj nuk ofrohet informacion statistikor zyrtar që të mundësojë përpunimin statistikor të të dhënave nga KShH, duke referuar se përlllogaritja e çështjes së mbartura (stokut) realizohet në fund të çdo viti kalendarik. Nga informacioni i bërë zyrtar nga vetë KLGJ në Raportin Vjetor të vitit 2020, KShH konstaton se backlog i raportuar nga kjo Gjykatë për vitin 2019 numëron 1020 çështje, kurse

GJAD Tiranë (kohëzgjatja)





223 Statistika të marra nga Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. Faqe 128. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

224 Statistika të marra nga Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. Faqe 129. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

për vitin 2020 e nis me një ngarkesë të shtuar me 54% në krahasim me çështjet e mbartura në vitin paraardhës (ose rreth 342 çështje)²²⁵. Pranë kësaj Gjykate, vërehet se në 67 raste, gjykimi ka zgjatur 6 muaj deri në 1 vit, ndërkohë, në përputhje me standartin procedural të afateve të parashi-kuara nga neni 399/2, gërma a) K.Pr.C., 1 vit nga fillimi i gjykimit.

• Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës

Kjo gjykatë ka një ngarkesë të mjaftueshme pune që justifikohet nga 5 gjyqtarë, numër i barabartë me numrin e gjyqtarëve aktualisht në funksion. Kujtojmë se mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës për gjyqtar në gjykatat administrative të shkallës së parë, përgjatë periudhës 2018-20 është 378 çështje²²⁶. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës ka kaluar procesin e vettingut 1 gjyqtar me vendim përfundimtar, 2 gjyqtarë të tjerë janë dorëhequr, ndërkohë 1 prej gjyqtarëve vendimmarrjen e



KPK-së nëpërmjet të cilës është vendosur shkarkimi i tij, e ka ankimuar pranë KPA-së.

Për periudhën 2019 – 2021, kjo gjykatë referon se çështjet e mbartura (stok) janë shënojnë një trend rritës. Mgjth, kohëzgjatja e proceseve gjyqësore të mbartura nga vitet e kaluara, për vitin 2020 rezulton në një numër të konsiderueshëm për një periudhë 1-2 vjet, e ndjekur me çështjet që zgjasin 2-3 vjet dhe ato mbi 3 vjet.

225 raporti_vjetor_klgj_2020_6578.pdf (gjykataelarte.gov.al)

226 Statistika të marra nga Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. Faqe 131. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

2.1.3.2 Njësitë e Shërbimit Ligjor

Në vitin 2016 kur është miratuar paketa bazë e ligjeve të reformimit në sistemin e drejtësisë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 98/2016, ligjvënësi parashikonte mundësinë e ngritjes së Njësisë (NjShL) pranë Gjykatave të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë²²⁷. Rreth pesë vite më vonë, me ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 46/2021, u parashikua ngritja dhe funksionimi i NjShL-ve edhe pranë gjykatave të shkallës së parë²²⁸. Por pavarësisht nga fakti se ky ligj ka hyrë në fuqi në Maj të 2021-shit, KShH ka konstatuar se gjatë periudhës së monitorimit në asnjë prej këtyre gjykatave nuk rezultoi të jetë ngritur kjo njësi²²⁹.

KShH sugjeron marrjen e masave konkrete nga ana e KLGJ-së për ngritjen e kësaj njësie dhe garantimin e numrit të përshtatshëm të ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë, me synim menaxhimin e mbarëvajtjes së punës dhe efijencës së gjykatave. KShH vlerëson se kontributi i ndihmësve ligjorë pranë këtyre njësive do të ndihej edhe në drejtim të evadimit të stokut të çështjeve shqetësues për disa prej gjykatave të shkallës së parë.

2.1.3.3 Masat e tjera për rritjen e efijencës në këto Gjykata

Si masa të tjera për rritjen e efijencës së gjykatave të shkallës së parë, objekt monitorimi, vlerësohen gjithashtu investimet dhe përmirësimet në infrastrukturë, trajnimet vazhduese të magjistratëve, plotësimi i vakancave të stafit të nëpunësve gjyqësor, trajnimet me ta, administrimi gjyqësor i sistemit të arkivës dhe modelet standarde elektronike për draftimin e vendimeve.

Nga korrespondenca me këto gjykata, duke patur në konsideratë, vështirësitë dhe sfidat me të cilat po përballen instancat e shkallëve të para të gjykimit në rang vendi, KShH vlerëson se ato duhet të luajnë një rol më pro aktiv, në kontekstin e adresimit të rekomandimeve, sugjerimeve, analizave dhe raportimeve studimore në adresë të KLGJ-së, me synim vlerësimin e risqeve aktuale dhe evidentimin e planifikimeve për reduktimin e impaktit që vakancat krijojnë dhe rritjen e efijencës së tyre.

Në të njëjtën linjë konstatuese si në rastin e Gjykatave të Apelit, KShH vëren se edhe gjykatat e shkallës së parë nuk disponojnë të dhëna statistikore për trajnimet vazhduese të gjyqtarëve zhvilluar dhe zbatuar nga Shkolla e Magjistraturës. Kjo e fundit përgatit çdo vit për një periudhë kohore 2 vjeçare programin e trajnimeve në të cilën gjyqtarët marrin pjesë rregull-

227 Nenet 34 dhe 42 të ligjit nr. 98/2016

228 Neni 9, pika 2 i ligjit nr. 46/2021

229 Shkresë nr. 754 prot., dt. 08.11.2021 (GJAD Durrës); Përgjigje e përcjellë me anë të postës elektronike (GJAD Tiranë), Shkresë nr. 779 prot., dt. 11.11.2021 (Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër), Shkresë nr. 796 prot., datë 16.11.2021 (Gj.Shkallës së Parë Elbasan), Shkresë nr. 865 prot., datë 15.12.2021 (Gj. Shkallës së Parë, Tiranë)

isht në mënyrë individuale si një mundësi për zhvillimin e kapaciteteve të tyre. KShH vlerëson nevojën e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit të gjykatave, KLGJ dhe Shkollës së Magjistraturës, për inkurajimin e magjistratëve për përfshirjen e tyre proaktive dhe periodike në këto programe trajnimi, si një mundësi për të forcuar profesionalizmin dhe eficiencën e tyre.

Kërkesave që shumica e këtyre gjykatave ka përcjellë për sa i përket nevojës për burime financiare shtesë dhe burime njerëzore, KLGJ referohet se i ka dhënë prioritet, duke marrë vendime në favor të tyre. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rezultoi i vetmi organ i pushtetit gjyqësor që nuk ka dërguar kërkesa mbi këtë objekt, ndërkohë gjatë vitit 2021.

Formimi profesional i nëpunësve civilë gjyqësorë garantohet nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet e formimit fillestar, mbi bazën e të cilin ata pranohen në shërbimin civil gjyqësor trajnohen brenda periudhës së provës së tyre, si dhe programin e formimit vazhdues, i cili ndiqet nga nëpunësit në detyrë të shërbimit civil gjyqësor. Nga të dhënat e referuara nga institucionet objekt monitorimi, KShH konstaton se kancelarët e gjykatave të shkallës së parë janë përfshirë në trajnime/seminare të ofruara nga KLGJ, USAID ose Shkolla e Magjistraturës. Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Shkollës së Magjistraturës, KLGJ, Ministrisë së Drejtësisë, gjykatave dhe institucioneve të tjera, përfshirë dhe shoqërinë civile, KShH sugjeron marrjen e masave për përfshirjen e nëpunësve gjyqësorë civilë në formimin profesional fillestar dhe atë vazhdues, si një mundësi për të rritur eficiencën e tyre në sistem.

Sa i takon infrastrukturës, informacioni i përcjellë nga këto gjykata është i natyrës së përgjithshme, ndërkohë që të dhëna të detajuara janë evidentuar pas njohjes me draftin e Hartës së Re Gjyqësore, të reflektuara në vijimësi të këtij seksioni²³⁰. Evidentohet se ndërtesat e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, kanë nevojë për rikonstruksion, pasi këto gjykata ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambientin e përbashkët me Zyrat Përmbarimore Shtetërore të qarqeve si dhe Shërbimin e Provës Durrës (për gjykatën e Durrësit). Nevoja dhe domosdoshmëria për akordimin e një fondi financiar për problemet infrastrukturale të godinave ekzistuese i është adresuar KLGJ-së nga ana e të gjykatat. KLGJ ka alo kuar një fond të posaçëm për Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër, por përdorimi i këtij fondi është pezulluar për shkak të problematikave administrative të mbartura prej vitesh me truallin mbi të cilin kjo gjykatë është ngritur²³¹.

230 Ky draft është përcjellë për njohjen e KShH-së më dt. 28.12.2021, në një periudhë që përkon me procesin e rishikimit të këtij raporti monitorimi, dhe jo gjatë fazës së hartimit apo konsultimit të tij me palët e interesuara, përfshirë KLGJ dhe përfaqësuesit e gjykatave objekt monitorimi

231 Gjithashtu një tjetër shkak i cituar në shkresën nr. 1162/1 prot., dt. 09.11.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, konsiston në "veprimtarinë e ndërmarrë nga KLGJ mbi hartimin e hartës së re gjyqësore, në mënyrë që pas përfundimit të hartës së re gjyqësore të jenë më të qarta nevojat hapësinore dhe strukturore (të reja tashmë) që mund të ketë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër".

• Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Kjo gjykatë ka dy ndërtesa, atë të seksionit civil dhe penal. Ndërtesa e seksionit civil ka 43 zyra gjyqarësh, 12 zyra administrate, si dhe 20 salla gjyqi. Ndërtesa e seksionit penal ka 24 zyra gjyqarësh, 2 zyra administrate, si dhe 7 salla gjyqi. Asnjë nga dy ndërtesat e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe shmangien e komunikimit. Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Së fundmi pas kërkesës drejtuar KLGJ është bërë i mundur rikonstrukcioni i zyrave të arkivës, e cila ka sjellë krijimin e hapësirave të reja brenda gjykatës si dhe mundësi më të mira shërbimi.

• Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Kjo gjykatë është e vendosur në një godinë 4 katëshe, ndërtuar në vitin 2017, e cila ka 10 salla gjykimi në total me një hapësirë të përshtatshme, 20 zyra gjyqarësh, 19 zyra të administratës. Gjykata i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe ka edhe hapësira shërbimi për publikun të realizuar sipas standardeve të kërkuara.

• Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Godina e kësaj gjykate përfshin ndër të tjerash 14 zyra gjyqarësh dhe 10 zyra të administratës, si dhe 7 salla gjyqi, 3 penale dhe 4 civile. Ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe shmangien e komunikimit *ex-parte*, pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe të paraburgosurit. Gjithashtu hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve përkatëse²³².

• Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Godina e kësaj gjykate është e organizuar në 16 zyra gjyqarësh dhe 9 zyra të administratës, si dhe 7 salla gjyqi. Kjo gjykatë përmbush standardet e projektimit, si dhe ka një hapësirë shërbimi për publikun që është e realizuar sipas standardeve të kërkuara²³³. Avokatët e KSHH-së në cilësinë e palës ndërgjyqëse, në çështje të ndryshme pranë kësaj gjykate, kanë konstatuar se shpesh herë seancat gjyqësore zhvillohen në zyrat e gjyqarëve, në pamjaftueshmëri të aksesit në sallat e gjykimit²³⁴.

232 Informacion i marrë nga Faqe 93. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

233 Informacion i marrë nga Faqe 129. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

234 Një problematikë e tillë është konstatuar edhe më herët nga KSHH, e cila në mënyrë zyrtare e ka referuar shqetësimin e saj pranë Kryetarit të kësaj Gjykate, duke bërë me dije se përballë synimit të realizimit të proceseve gjyqësore brenda një kohe të shkurtër, mund të cënohen parimet themelore të solemnitetit dhe ligjshmërisë së shqyrtimit gjyqësor, pasi një praktikë e tillë nuk siguron dot regjistrimin audio të seancave gjyqësore. Shkresa e KSHH-së nr. 731 prot datë 28 Tetor 2021

• Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka një ndërtesë e cila përfshin 4 zyra gjyqtarësh dhe 3 zyra të administratës, si dhe 1 sallë gjyqi. Kjo gjykatë nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe shmangien e komunikimit ex-parte²³⁵. Funkcionaliteti i vetëm 1 sale të gjykimit kërkon ndërhyrjen e menjëhershme nga ana e KLGJ-së për planifikimin dhe gjetjen e zgjidhjeve oportune, me qëllim garantimin e realizimit të seancave gjyqësore në ambiente të përshtatshme, që ofrojnë solemnitet gjykimi dhe transparencë ndaj palëve dhe publikut.


• Sistemi i arkivimit gjyqësor

Në secilën prej gjykatave objekt monitorimi ka rezultuar se është ngritur një sistem arkivimi gjyqësor. Pranë 2 prej këtyre gjykatave, përkatësisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, rezulton se janë ngritur Komisionet e Ekspertizës sipas udhëzimeve të dala për Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor. Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë aktualisht funksionojnë 3 arkiva, ndërkohë që Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë krahas funksionalitetit të plotë të sistemit të brendshëm arkivor realizon përcjelljen e dosjeve pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor. Në tërësi, informacioni i përcjellë sa i takon arkivimit gjyqësor, është i pamjaftueshëm për të bërë një analizë të mangësive dhe nevojave që këto gjykata kanë në këtë drejtim.

• Modelet standarte për zbardhjen e vendimeve gjyqësore

Të dhënat e përcjella evidentojnë se Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan përdor modele standarte elektronike për draftimin e vendimeve gjyqësore, ndërsa katër gjykatat e tjera nuk përdorin modele të kësaj natyre.

2.1.3.1 Mbledhjet e Përgjithshme të Gjyqtarëve



Mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan, Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës realizohen rregullisht një herë në muaj. Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër referon se në raste emergjente thërret më shpesh këtë organ të brendshëm të gjykatës. Nga ana tjetër, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë referon se mbledhjet nuk janë mbajtur

235 Informacion i marrë nga Faqe 131. Drafti i Hartës së Re Gjyqësore. <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

rregullisht sipas parashikimeve ligjore në fuqi, gjatë periudhës Mars 2020 - Djetor 2021, për shkak të masave kufizuese të vendosura nga KLGJ ndaj përhapjes së Covid-19. I njëjti konstatim vlen edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila referon se mbledhjet janë zhvilluar vetëm në raste urgjente.

Nga informacioni i përcjellë nga gjykatat objekt monitorimi nuk janë vënë në dispozicion të KShH-së të dhëna statistikore mbi numrin e mbledhjeve që janë mbajtur gjatë periudhës objekt monitorimi, ndërkohë që as regjistrime audio dhe as procesverbale të zbardhura e të anonimizuara të këtyre mbledhjeve nuk janë përcjellë, çka krijon pikëpyetje për zhvillimin real të tyre në praktikë. Gjithashtu, mos përmbushja e këtij detyrimi nga dy prej gjykatave, me argumentin e masave anti-covid dhe pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimit gjyqësor nga KLGJ nuk qëndron, pasi kjo është shtrirë në një kohë shumë të kufizuar, ndërkohë që vetë KLGJ ka dhënë shembullin pozitiv të zhvillimit periodik të mbledhjeve plenare.

Duke qenë se kjo situatë e konstatuar bie ndesh me nenin 29 pika 3 të ligjit nr. 98/2016, KShH sugjeron marrjen e masave konkrete nga ana e KLGJ-së për të ushtruar rol mbikëqyrës sistematik, me synim garantimin e respektimit të dispozitave normuese të ligjit nr. 98/2016.

REKOMANDIME KYÇE

Disa nga rekomandimet më të rëndësishme të monitorimit të KShH-së ndaj veprimtarisë së Këshillave dhe gjykatave me ngarkesën më të lartë në vend, evidentojnë veçanërisht nevojën për:

- a. Vijueshmërinë nga KLGJ e ritmit të procesit të plotësimit të kuorumit të nevojshëm të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, çka do të kontribuonte për zhbllokimin e procesit të emërimeve në Gjykatën Kushtetuese, për 3 anëtarët që zgjidhen nga Gjykata e Lartë dhe rritjen e mëtejshme të efikasitetit të kësaj gjykate për evadimin e çështjeve.
- b. Bashkërendimin sistematik të veprimtarisë së Këshillave me atë të Institucioneve të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për të realizuar me përparësi dhe ritme më të shpejta, vettingun për kandidatët që kanë shprehur interesin për të qenë pjesë e Gjykatave të Apelit si dhe në pozicionet drejtuese në prokurori apo gjykata.
- c. KLGJ duhet të marrë seriozisht në vlerësim nevojën për studimin e hapësirave të tjera për plotësimin e vakancave të krijuara në Gjykatat e Apelit dhe ato të shkallës së parë, duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme të cilat mund të formulohen edhe si opinione për ndryshime në kuadrin ligjor në fuqi dhe që garantojnë një trupë gjyqësore profesionale dhe me integritet, të pavarur dhe të paanshme.
- d. Sfidat madhore në luftën kundër korrupsionit kërkon plotësimin e vakancave në GJKKO, burime njerëzore të specializuara, hetime pro-aktive në afate të arsyeshme, në të kundërt të gjithë këto faktorë vështirësojnë ndëshkueshmërinë e veprave të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ndikojnë tek besimi i qytetarëve në organet e reja të drejtësisë.
- e. Realizimin e transparencës në faqen zyrtare të KLGJ-së për mbledhjet dhe diskutimet e grupit ndërinstitucional të punës për hartën e re gjyqësore, si dhe reflektimin e nivelit të pranueshmërisë ose refuzimit të argumentuar të opinioneve/komenteve apo sugjerimeve të cilat janë ofruar nga palë të treta të interesuara gjatë tryezave konsultative të realizuara nga KLGJ.
- f. Përmirësimin e mëtejshëm të transparencës së Këshillave, për të publikuar në kohë vendimet dhe procesverbalet (audio dhe të transkriptuara) e mbledhjeve plenare dhe Komisioneve të Përhershme, si dhe për të organizuar më mirë seksione të caktuara të faqes zyrtare të internetit, duke krijuar lehtësitë e nevojshme të aksesit të publikut të informacionin dhe dokumentacionin e Këshillave.

- g. Forcimin e bashkëpunimit periodik ndërmjet KLGJ-së dhe gjykatave objekt monitorimi, me synim nxitjen e rolit propozues të nismave ligjvënëse për amendime të ndryshme ligjore, të cilat mund t'i shërbejnë pozitivisht administrimit efikas të sistemit gjyqësor, rritjes së efijencës dhe garantimit të të drejtave e lirive të konsumatorëve të shërbimeve gjyqësore.
- h. Shfaqjen e një trendi më të hapur për të dëgjuar këndvështrimet apo kritikën e studiuesve dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe për të paraqitur argumentet dhe kundër argumentet që i mundësojnë palëve zhvillimin e një dialogu të hapur demokratik, duke kontribuar në forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së Këshillave.
- i. I rekomandojmë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të RSH-së, ofrimin e mbështetjes së nevojshme buxhetore për ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi të përmirësuar elektronik, bashkëkohor dhe të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, me kapacitet statistikor të shëndetshëm të mbështetur në metodologjinë e CEPEJ-it.
- j. Respektimin nga shumica e gjykatave të monitoruara, të detyrimit për zhvillimin e rregullt të mbledhjeve të një organi të rëndësishëm të administrimit gjyqësor (sikurse është mbledhja e gjyqtarëve), duke realizuar regjistrimin audio të tyre si dhe zbardhjen e procesverbalit të mbledhjes.
- k. Përdorimin me efikasitet të mjeteve të njohura nga kuadri i ri ligjor, për zgjidhjen në kohë të shpejtë të çështjeve gjyqësore, bazuar në konstatimin se shpesh gjykatat i mbeten “besnike” parashikimeve të mëparshme të Kodeve të Procedurave, duke krijuar vonesa në gjykimin e çështjeve.
- l. Marrjen e masave konkrete për reduktimin e vakancave ekzistente në radhët e administratës gjyqësore civile, nëpërmjet nxitjes së pranimave në shërbimin civil ose emërimet e përkohshme të nëpunësve gjyqësore, me qëllim ngritjen e njësive të shërbimeve ligjore pranë Gjykatave të shkallës së Parë, si dhe funksionalitetin me organikë të plotë të atyre ekzistuese në Gjykatat e Apelit objekt monitorimi, si dhe Gjykatën e Lartë. Ngritjen e sistemit që mundëson trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve gjyqësorë civilë.
- m. Luajtjen e një roli pro aktiv nga ana e Gjykatave objekt monitorimi, në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave statistikore mbi impaktin e situatave të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore (si ajo e shkaktuar nga Covid-19) në mirë-administrimin e brendshëm, si dhe garantimin e një procesi ligjor efektiv dhe efijent.

